
Parapagimi për revistën.....	2
Islami, feja më e praktikuar në ishullin britanik.....	3
Thënia e së vërtetës është rruga drejt Xhenetit	9
Pse Islami?	11
Ejani në shpëtim!.....	14
Drejtësi, për gjithmonë.....	16
Defektet në rrugën e dijes.....	19
Enciklopedizmi i shkenctarëve muslimanë	32
Zemërimi dhe shkaktarët e tij.....	36
Relativizmi	39
Ndikimet në shtëpitë tona	43
Po, u bëra një myslimane.....	44
Të drejtat themelore të bashkëshortëve.....	45
Usame ibën Munkidh	47
Esed ibën Furat	50
Imam Muxhahid ibën Xhebr.....	53
Muaji Xhumadel Ahire.....	54
Dëshmia e rrejtshme	56

Parapagimi për revistën

Parapagimi kushton gjithsej **10** euro (dhjetë) për Europë, (përfshirë edhe Shqipërinë, Kosovën, Turqinë dhe ish republikat Jugosllave), **20** euro për Kanada dhe Amerikë dhe vetëm **310** denarë për parapaguesit nga Maqedonia. Me këtë parapagim brenda një viti juve ju dërgojmë 12 numra të revistës, prej numrit aktual kur ju parapaguheni. Në këtë çmim janë të përfshiera edhe harxhimet postare për dërgim të thjeshtë.

Për parapagim mjafton që të dërgoni pajtimin tuaj me emrin dhe adresën e plotë në:

email: albislam@albislam.com

sms: +389 75 436 718

fax: +389 2 3230 827

tel: +389 2 3230 827 (çdo ditë, përveç të xhumasë dhe të dielës, prej 9 deri 16)

ose me postë në: rr: 110 nr: 5 1000 Shkup, Maqedoni

viti IV nr: 36

albislam@albislam.com

redaksia: Ramadan Ramadani (kryeredaktor),
Bekir Halimi, Talha Kurtishi, Alajdin Idriz,
Fatmir Zaimi, Ali Shabani, Agim Bekiri,
Metush Memedi, Omer Berisha

rr: 110 nr: 5
Çarshija e vjetër
1000 Shkup
fax: +389 2 3230827

Del në fillim të muajit, kalendari i hixhretit, takvimi i Türkiye Diyanet Vakfi. Numri i ardhshëm: 26 07 2006

Boton: NUN-R DOOEL

Xhirollogaria: 300000001759616 Komercijalna Banka A.D. - Skopje (denar)

Xhirollogaria: 0270100209184 Komercijalna Banka A.D. - Skopje (euro)

rr. "Kej Dimitar Vlahov" 4

S.W.I.F.T. : KOB5MK2X

IBAN MK07300701002091869

Numri tatimor: 4030003487017

Revista është e regjistruar pranë Agjencisë për Informata të Maqedonisë nr. 02-124/2.

Shtypur në: Cetus Print -Shkup Tirazhi: 1000 kopje ISSN: 1409-6250

Islami, feja më e praktikuar në ishullin britanik

Islami në Europë është bërë një nga çështjet më të debatueshme në qarqet mediatike dhe akademike përsa i takon rolin dhe pozicionin që kanë muslimanët në shoqëritë perëndimore, apo identitetin të tyre. Ideja e një shkrimi të tillë më lindi nga një artikull që lexova në gazetën "Telegraph" sipas së cilës Islami është feja më e praktikuar në ishullin britanik. (1) Gazeta i referohet një studimi të bërë nga një organizatë e quajtur "E ardhmja e kishës" e cila parashikon që në vitin 2040 numri i muslimanëve që marrin pjesë në faljen e ditës së premtë do të jetë dyfish më i madh sesa numri i të krishtetërve që marrin pjesë në shërbimet e ditës së diel. Sipas raporteve të paraqitura nga qeveria britanike dhe burimeve akademike, statistikave të vitit 2004 tregojnë që rreth 930000 muslimanë shkuan në xhami të paktën një herë në javë, krahasuar me 916000 ndjekës të kishës së Anglisë. Sipas studimeve të bëra nga organizata tepër prestigjioze, Islami është tashmë feja më ritjen më të shpejtë në Europë. Me tepër së 53 milion muslimanë jetojnë në Europë, 14 prej të cilëve në BE. Franca ka numrin më të madh me 5.5 milionë, ndjekur nga Gjermania me 3.2 milionë dhe pastaj Mbretëria e Bashkuar me 1.8 milionë, Italia me 1 milion etj.

Eksperiencat dhe kënaqësia që unë kam përjetuar në të jetuarit në një komunitet të tillë është diversiteti që reflektohet në një shtrirje të gjerë etnike që mund të jetë si një lloj paradigëm i universalitetit që ofron Islami. Një karakteristikë e muslimanëve që jetojnë në Britaninë e Madhe është arritja e

një "modus vivendi" në menyrë që grupet etnike të veçanta si arabët, persianët, turqit, pakistanezët etj, të krijojnë një komunitet musliman dhe jo të vazhdojnë në linjat e përkatësisë kombëtare apo etnike. Askush nuk mund ta kishte parashikuar përpara 100 viteve një përhapje dhe shtrirje të tillë të islamit në ditët e sotme dhe menjëherë më kujtohet poeti dhe mendimtari më i njohur i klasikës gjermane Gete. Në janar të vitit 1814 ai mori pjesë në një falje kongregacionale të së premtës bashkë me muslimanët e ushtrisë ruse të car Aleksandrit në gjimnazin protestant të Vajmarit. Në letrën për Treban me 5.1.1814 ai shkruan: "Kur bëj fjalë për profeci më duhet të vërej së në kohën tonë po ndodhin gjëra për të cilat asnjë profet nuk do ta kishin lejuar të fliste. Kush do lejohej përpara disa vitesh që të bënte të ditur se në auditorin e gjimnazit tonë protestant do të mbahej shërbesë hyjnore muhamedane dhe se suret e Kuranit do të murmuriteshin në te, por ja që kjo po ndodh, dhe në marrëmbajtje pjesë në shërbesën bashkë, pamë mullain e tyre dhe u uruam mireseardhjen princërve të tyre në teatër. Mu bë një nderim i veçantë duke mu dhuruar një hark dhe shigjetë, të cilat në kujtim të përjetshëm do ti var mbi oxhakun tim sapo Zoti tu ketë dhuruar këtyre mysafirëve të dashur një kthim të mbarë."

Përsa i takon rrënjëve historike të Islamit njerëzit në Angli kishin dijeni për Islamin, kryesisht për shkak të inkursioneve muslimane në Europë, dhe gjatë asaj periudhe arabët iu ofruan Anglisë deri në Portre në Francë në vitin 732.

Përgjithësisht besohet që i pari anglez që ishte zotëruar i gjuhës arabe ishte mësuesi i Henrit të dytë, Adelorat of Bath (1125), i cili udhëtoi në Siri dhe në Spanjen muslimane dhe përktheu një sërë tekste arabe në latinisht. Në anen tjetër i pari anglez që ka pranuar Islamin, emri i të cilit ka mbijetuar në burimet angleze (Udhetimi i bere në Tripoli 1583) ishte një shërbëtor, djali i një oficeri në gardën e mbretëreshës. Emri i tij është John Nelson.

Pasi muslimanet kishin themeluar hegjemoninë e tyre mbi Spanjën dhe Sicilinë, ata ishin perceptuar si një rrezik kryesor i krishterimit në Europë. Kryqëzatat e fillimit të mesjetës ishin përgjigje ndaj një armiku ushtarak dhe ideologjik, dhe një ndër këto kryqëzata u udheheq nga Richardi i parë i Anglisë. Ka vetëm prova sporadike të vizitave të muslimaneve në këtë periudhë siç ishte ajo e Al Tabini (1100-1166) apo ndërhyrjeve të piratëve afrikanë në ujerat angleze. Një e dhënë tjetër historike është mbërritja e përfaqësuesit persian në Angli në vitin 1238 për të kërkuar ndihmë ndaj kërcënimit mongol por që nuk gjeti asnjë lloj mbështetjeje nga Henri i tretë.

Përparimi i muslimanëve në Europë vazhonte me humbjen e perandorisë bizantine ndaj otomanëve të cilët e shtrinë perandorinë e tyre në gjithë Ballkanin duke rrethuar Vienën më 1529. Njohja e fuqisë otomane arriti zenitin e vet me ofertën e bërë nga Elisabeta e parë më 1588 për të hyrë në aleancë me Sulltan Muratin e tretë, një shok monoteist siç e quante ajo për të shkatërruar mbretërinë papiste dhe idhujtare të Spanjës. (3) Paralelizma të tilla historike kemi në shekullin e dymbëdhjetë kur King John u shkishërua nga papa Innocent i tretë. Mathew Paris një murg i asaj kohe na përshkruan detaje të një përfaqësuesi

që mbreti John i dërgoi emirit të Afrikes së Veriut për tu ofruar ndihme muslimaneve në luftën e tyre në Spanje kundër mbretit katolik Aragon.

Prova të prezencës muslimane në këtë periudhë mund të përmendim skllëvërit e liruuar apo tregtarët. Një dokument i vitit 1641 vërteton prezencën e një "sekti të çmendur të Muhamedit" sic përshkruhet në te. (4)

Një numër i konsiderueshëm muslimanësh otomanë udhëtuan në Angli nga fundi i shekullit të gjashtëmbëdhjetë.

Ahmet Efendi me profesion tregtar besohet që të jetë turku i parë që ka mbërritur në Angli. (5) Gjithashtu në këtë periudhë kemi edhe shkëmbime diplomatike ndërmjet Anglisë dhe Portës së Lartë. Një grup tjetër muslimanësh të asaj periudhe ishin të ashtuquajturit renegatë. Fjala spanjolle renegade është përdorur për herë të parë në anglisht në vitin 1581 dhe nënkuptonte një të konvertuar nga krishterimi në islam. Numri i renegatëve sipas dokumenteve historike në këtë periudhë filloi të shtohet sepse në mes muslimanve nuk kishte diskriminim që bazohej në pozitën sociale apo origjinën etnike të të konvertuarit. Pavarësisht nëse një person vinte nga Anglia apo Irlanda, ishte i lindur musliman apo ishte i konvertuar nga krishterimi apo judaizmi, apo nga raca dhe prejardhja e tij familjare, ai mund të ngrihej në pozitën me të lartë në pushtet.

Egalitarianizmi i mundësive në perandorinë muslimane ishte fakt tepër i njohur në Angli, lista e udhëheqësve në perandorinë osmane që paraqiten në publikimet angleze shpesh përfshin referenca të statusit të tyre si renegatë. Në shekullin e shtatëmbëdhjetë 17 bejlerë në Afrikën e Veriut njiheshin që ishin me origjinë krishtere. (6) Të gjitha konvertimet e britanikeve në këtë periudhë u kryen në vendet muslimane dhe nuk ka

ndonje të dhënë që ndonjëri prej tyre pasi të ketë përqafuar islamin të jetë pranuar si renegat në vendin e tij.

Duhej pritur gjer në shekullin e tetëmbëdhjetë që një britanik që kishte përqafuar islamin të mos shihej si një renegat por si një subjekt që kishte pranuar një fe tjetër.

Çështja shtrohet së si u pasqyruan rene-gatët të tillë në shoqërinë apo kishën brita-nike të asaj kohe. Shkrimtarët dhe artistet u vune në garë me njëri tjetrin për ti pasqyru-ar bashkëkombasit e tyre si të pushtuar nga djalli, si kriminelë makiavelian, apo ateist faustian. Në shekullin e 21 ka ende në Shqip-erinë time, pseudointelektualë me mentalitet mesjetar që tmerrohen së shohin vajza të mbuluara me mbulesë islame apo djem që kanë leshuar mjekrat. Me të vertetë e pyes veten se drejt cilës Europë duan që të na shpien njerëz me mentalitet të tillë kur në shoqërinë angleze këto janë fenomene më se të përhapura dhe të pranueshme.

Në maj të vitit 1649 për herë të pare në historine angleze përkthehet teksti i plotë i Kuranit nga Aleksander Ros (1592-1654). Megjithëse përkthimi ishte tepër i varfër, një version i tillë do të mbetej për 85 vitet e ardhshme deri në përkthimin tjetër nga George Sole me 1734. (7) Përpara kësaj peri-udhe Kurani nuk i ishte bërë i njohur publi-kut anglez. Deri në vitin 1631 universiteti i Cambridge nuk kishte asnjë doreshkrim të Kuranit dhe vetëm në tetor të vitit 1630, Abraham Wheelock (1593-1653) i cili u bë professor i arabishtes në këtë universitet, i shkruante Bedwellit duke i kërkuar atij që ti dhuronte një kopje të Kuranit librarisë së universitetit. Bedwell i premtoi duke i shkru-ajtur inshallah në arabisht dhe e mbajti premtimin duke i dhuruar librarisë së uni-versitetit të parin dorëshkrim të Kuranit. (8)

Vlera e kulturës, qytetërimit dhe shken-cës islame ishte tepër e rëndësishme dhe ishte elementi kryesor në "priscia sapienta" apo urtësia fillestare që i dha shkak revolucionit kulturor në Europë.

Raportet e Islamit dhe Britanisë gjatë periudhes së mesjetës dhe gjeri në sheku-llin e tetëmbëdhjetë kur filloi rënia e peran-dorisë osmane ishin raporte ku fuqia e pe-randorise osmane shihej si e pathyeshme dhe as që bëhej fjalë për kolonizimin dhe dominimin e tokave të islamit. Edward Said argumenton së krijimi i termit orientalizëm u shfaq vetëm pas shekullit të tetëmbë-dhjetë kur europianet mund të pikturonin dhe të portretizonin muslimanët në çfarëdo lloj forme që u pelqente atyre dhe tokat e islamit u bënë pre e kolonizimit britanik. (9)

Duke filluar që nga shekulli i tetëmbë-dhjetë filloi periudha e ideologjisë kolonizu-ese të Britanisë së Madhe ndaj botës isla-me, dhe në mënyrë që të siguronte domini-min, ushtria dhe misionarët bashkpunuan për të krijuar një hegjemoni politike, eko-nomike dhe fetare. Një ideologji e tillë ishte e frymëzuar nga eskatologjia e krishtere që pretendonin që e kishte burimin në Bibël, sipas së cilës pritej rikthimi i Krishtit dhe e gjithë bota do të shëndrrohej në protes-tantë. Një fakt tjetër që vlen të përmenden në eskatologjiine britanike është përdorimi i termave saracenë dhe arabe duke përfshi-rë në të parin pejgamberin dhe përkrahësit e tij, ndërsa në të dytin arabët e asaj pe-riudhe të cilët pershkruehen si të qytetëruar, të pasur dhe ekzotikë nga shkrimtarët e asaj kohe si Shakespeare, Marlow, Fletcher etj. Saracenët pershkrueshin si genjeshta-rë dhe mashtrues dhe teologet që u kthyen në filologe e gjurmonin një emërtim të tillë tek Sara gruaja e Ibrahimit. (10)

Eskatologjia e shkrimtarëve anglezë dhe skocezë të asaj kohe së bashku me qëllimet evanjeliste që shihnin kthimin e hebrejve në Palestinë dhe konvertimin e tyre në të krishterë me qëllim që të zhduknin muslimanët, ishte fabrikim i mendjeve apoliptike të cilët kishin një urrejtje të fortë dhe të pandryshueshme ndaj islamit. Por fabrikime të tilla kanë krijuar një demonizim dhe urrejtje për muslimanet që ka dominuar paraqitjen e islamit edhe në periudhem moderne. Edward Said është shprehur që një eskatologji e tillë e paraqitjes së islamit që e justifikonte kolonizimin perendimor të botës islame kishte rrënjë të thella në iluzionet dhe imazhet biblike. (11)

Komuniteti më i njohur musliman në fund të shekullit të nëntëmbëdhjetë u themelua nga një avokat nga "Isle of Man". Quillam i cili pranoi islamit në vitin 1887 pas një udhëtimi në Marok. Ai filloi të botonte pikëpamjet e tij fetare në një fletushkë të quajtur "Besimi Islam". Më vonë instituti i xhamisë së Liverpulit filloi të botonte gazetën "Bota Islame" që trajtonte problemet e muslimanëve në të gjithë globin. Një qendër tjetër e rëndësishme islame që u formua në fillim të shekullit të njëzetë ishte xhamia e ndërtuar në Woking në Londër.

Nje organizatë tjetër muslimane u formua në dhjetor të vitit 1914 nga Lord Headley një tjetër i konvertuar dhe me influencë të madhe në shoqërinë britanike. Organizata "British Muslim Society" u krijua me qëllimin e përhapjes së islamit tek jomuslimanët. Në këtë periudhë një ndikim tepër të madh në përhapjen e islamit dhanë figura tepër të njohura në shoqërinë britanike që u kthyen në thirrës islamë, ndër të cilët mund të përmendim: Lord Headley, Pickthall, Archibald Hamilton apo Lady Evelyn Colbold

ndoshta e para grua angleze që ka kryer haxhin (pelegrinazh) në Mekë. (12)

Influksi i parë i refugjatëve politikë që mbërriti në Angli ishte gjatë sundimit të Sulltan Abdulmexhit (1832-1876) të cilët filluan botimin në Londër të gazetave të ndryshme si Hurrijet (liria) që protestonin ndaj tiranisë së Sulltanit. një valë e dytë ishte gjatë sundimit të Sulltan Abdul Hamitit të dytë, i cili paraqitej nga turqit e rinj si një shtypës politik. Gjithashtu një numër emigrantesh muslimanë mbërriten edhe nga Qiproja pasi Britania e Madhe kishte marre ishullin nën kontroll në vitin 1878.

Në fillim të shekullit të nëntëmbëdhjetë muslimanet indianë filluan që të vinin në numër relativisht të vogël dhe kryesisht prej elitës së shoqërisë indiane që ishin të lidhur me perandorinë britanike. Gjithashtu kjo periudhë u karakterizua nga një fluks i studentëve indianë që erdhën për të studiuar në universitetet britanike. Muhamed Ali Jinnah, i cili u bë udhëheqës i Muslim League dhe babai i themelimit të Pakistanit, erdhi si student në vitin 1897. Një numër i konsiderueshëm muslimanësh në këtë periudhë erdhën që të punonon si marinarë në anijet britanike.

Lufta e parë botërore solli si pasojë një kërkesë për fuqi punëtore për të zëvendësuar meshkujt që ishin thirrur për shërbim ushtarak. Një pjesë e madhe e kësaj fuqie punëtore u importua nga vendet koloniale. Deri në vitin 1962 hyrja e qytetarëve nga kolonitë britanike dhe shtetet anëtare të Commonwealthit ishte e pakufizuar. Që nga lufta e dytë botërore muslimanët kane emigruar në numër shumë më të madh sesa përpara 1945 dhe shumica kryesisht vinte nga Azia jugore, vendet e Lindjes së Mesme, Afrika dhe Qiproja. Pas vitit 1945 emigrimi i muslimanëve mund të ndahet në dy

faza kryesore: nga 1945 e deri në fillim të vitit 1970 dhe faza tjetër nga viti 1973 e deri në ditët e sotme. Në fazën e parë rindërtimi i ekonomisë pas luftes dhe zgjerimi i investimeve dhe kapitaleve kishin nevojë për fuqi punëtore dhe shumica e tyre u rekrutuan nga vendet muslimane. Fluksi i madh i emigrantëve e detyruan qeverinë që të ndryshonte legjislacionin dhe të kufizonte hyrjen e qytetareve nga vendet e Commonwealth dhe në mënyrë të veçantë "Commonwealth Immigration Act" ishte si përgjigje ndaj shkallës në rritje të pakënaqësisë të popullsisë vendase ndaj një fluksi kaq të madh të ardhjes së emigrantëve. (13)

Faza e dytë fillon me rritjen e çmimit të naftës në vitin 1973, dhe kjo sollti si pasojë ardhjen e një grupi elit arabësh, të cilët për shkak të pasigurisë politike në vendet e tyre menduan që ti investojnë kapitalet e tyre në një vend ku u jepte garanci dhe siguri me të plotë. Deri në vitin 1988 kuvajtianet kane investuar rreth 55 bilione dollare ndërsa sauditet i kishin derdhur pasuritë e tyre në banka, spitale dhe në fushën e ndertimeve.

Përsa i përket përbërjes dhe ndërtimit të komunitetit musliman në ditët e sotme nuk ka të dhëna të sakta dhe ka qenë gjithmone objekt diskutimi. Sipas të dhënave të zyres për statistika kombëtare popullsia muslimane është 1.6 milionë prej të cilëve 1.54 milionë jetojnë në Angli dhe Uells ndërsa 40.000 jetojnë në Skoci. (14) Ndërsa gazeta Guardian jep një shifër prej 1.8 milionësh prej të cilëve 1 milion jetojnë në Londër dhe 150.000 në Birmingham. (15) Në censusin e berë në vitin 2001 për herë të parë është perfshirë edhe pyetja e deklarimit të fesë. Muslimanet me origjinë nga Pakistani dhe Bangladeshi përbejnë numrin më të madh të ndjekur nga ata që vijnë nga vendet e

Lindjes së Mesme por duhet përmendur fakti se numri i muslimanëve nga Europa është rritur së tepërmi këto vitet e fundit dhe kryesisht nga trevat shqiptare, Bosnja dhe republikat ish-sovjetike. Përsa i përket shpërndarjes gjeografike një karakteristikë e muslimanëve është së ata jetojnë në zona apo qendra afër njëri tjetrit. Censusi i viti 2001 dëshmon fakte të tilla si p.sh. gjysma e komunitetit bangladeshas jeton në Londer (55%) dhe pothuajse gjysma jeton vetëm në një distrikt. Megjithëse komuniteti shqiptar ka arritur këto vitet e fundit, praninë më të madhe të tyre në Londër e takojmë në WoodGreen. Fakte të tjera interesante nga censusi i vitit 2001 është përbërja tepër e re e komunitetit musliman. Duke e krahasuar me 10% të popullsisë së bardhë, 43% e pakistanezëve dhe 46% e bangladeshasve janë nën moshën 16 vjeç. Ndërsa në anën tjetër vetëm 2% e pakistanezve dhe 1% e bangladeshasve krahasuar me 17% të popullsisë së bardhë janë mbi moshën 65 vjeç. (16)

Përsa i përket marrëdhëniet me institucionet, përpjekjet e muslimanëve kanë qenë të perhershme për të realizuar kërkesat e tyre fetare dhe jo gjithmonë janë pritur me dashamirësi nga autoritetet. Dy nga çështjet më të debatueshme mes drejtuesve muslimanë dhe perfaqesuesve të qeverisë kishin të bënin me hapjen e shkollave islamike dhe lëndët fetare në shkolla. Një ndër shkollat e para islamike që kërkoi njohjen nga ana e qeverisë ishte një shkollë fillore e hapur nga ish këngëtari i muzikës pop, Cat Stevens, i njohur në arenën publike me emrin e ri Yusuf Islam. (17)

Numri i shkollave të pavarura islamike ka ardhur gjithnjë duke u rritur, nga 45 në vitin 1996, në 53 në 1997, dhe 77 në 2002. Të dhëna të sakta për numrin e xhamive nuk ka por mendohet të ketë me teper së 2000.

Xhamia më e njohur është ajo e Regent's Park në Londër e cila ka një histori pak a shumë të vecante. Në vitin 1940 kabineti i luftës aprovoi dhënien e një dhurate prej 100.000 £ për blerjen e një trualli për ndërtimin e një xhamie. Një gjest i tillë u dha si tribut për mijëra ushtarë muslimanë që kishin dhënë jetën për perandorinë britanike gjatë luftës së parë botërore. Mbreti George i gjashtë inaguroi qendrën islamike në nëntor të vitit 1944, por xhamia u përfundua në vitin 1977 dhe në vitin 1994 iu shtua pjesa arsimore dhe administrative. Një hulumtim i bërë në vitin 1990 konfirmoi që ka të paktën 839 xhami të rregjistruara dhe 950 organizata muslimane në të gjithë vendin. Numri i organizatave muslimane filloi të rritej pas vitit 1980 dhe kontributi i tyre humanitar në vendet muslimane ka qenë mjaft i rëndësishëm. Organizata të tilla si Islamic Relief (e themeluar në vitin 1984), Muslim Aid etj, u krijuan për tu ofruar ndihme njerëzve në nevojë.

Organizata të tjera si Komisioni i të Drejtave Njerezore Islamike, apo Shoqata e Avokateve Muslimane, u krijuan për të mbrojtur të drejtat e muslimanëve në vend dhe për të luftuar për drejtësi në të gjithë botën muslimane.

Në fushën e promovimit të islamit janë krijuar një sërë organizatash dhe instiucionesh të ndryshme. Akademia Islame në Cambridge u themelua në vitin 1983 dhe puna e saj nëpërmjet konferencave dhe seminareve të ndryshme ka qenë mjaft e rëndësishme në paraqitjen e islamit tek popullsia vendase.

Në fushën mediatike televizionet dhe radiot islame po japin një kontribut jetik për të plotësuar nevojat informative dhe edukuese të muslimanëve dhe për të promovuar islamin tek jomuslimanët.

Komuniteti musliman në Europë tashmë konsiderohet pjesë e pandashme e realitetit

ekonomik dhe politik të këtyre vendeve dhe pranimi i një fakti të tillë është prezent edhe në mendjet e intelektualëve europianë, të cilët nuk e shohin Europën si një klub krishter, por si një shoqëri multikulturore dhe multietnike. Jashtë këtij formacioni politik dhe ekonomik që një pjesë e europianëve kanë krijuar është edhe një ndër kombet më të lashta të Europës, me numrin më të madh të muslimanëve: kombi shqiptar. Megjithëse shqiptaret vazhdojnë të levizin në Europë me tagrin e të pafuarit, kjo ka krijuar mundësinë e krijimit të lidhjeve dhe njohjeve me fqinjët tanë europianë.

Padyshim komuniteti musliman në vendet perëndimore është në lutje dhe pritje që kombi shqiptar të bëhet pjesë e BE, dhe Islami në këtë formacion politik të shihet jo vetëm si i importuar nga emigrantët, por edhe i ngulitur tek popullsitë e kontinentit të vjetër që përfaqesohen nga kombi shqiptar apo boshnjak, apo numri tepër i madh i europianëve të kthyer në Islam.

Agim Alia

1 The Telegraph. September 4 2005

2 N. Matar. Islam in Britain, 1998, p 43.

3 P Lewis. Islam in Great Britain. Religion, Politics and the Identity of British Muslims, 1994, p 43.

4 H Ansari. The Infidel Within, 2003, p 27.

5 S Sonyet. The Hidden Minority. Turkish Muslim Children In British Schools. Cambridge, 1998, p 3.

6 N Matar. Islam in Britain, 1998, p 46.

7 N Matar. Islam in Britain, 1998, p 73.

8 N Matar. Islam in Britain, 1998 p 74

9 N Matar. Islam in Britain, 1998, p 11

10 N Matar. Islam in Britain, 1998, p 155

11 N Matar. Islam in Britain, 1998, p 186

12 H Ansari. The Infidel Within, 2003, p 131

13 J Nielsen. Muslims in Western Europe. 1992, p 31.

14 Offices for National Statistics.

15 The Guardian. June 17.2002. British Muslim Series. A Map of Muslim Britain.

16 Computerised from D. Owen. Ethnic Minorities in Great Britain. 1991 Census.

17 J Nielsen. Muslims in Western Europe. 1992, p 57.

Thënia e së vërtetës është rruga drejt Xhenetit

Nuk është e nevojshme të theksohet se thënia e të vërtetës është virtyt, që vlerësohet nga të gjithë njerëzit e ndershëm, pa dallim feje. Nga përvoja e secilit dimë se njerëzit pëlqejnë individët e ndershëm dhe që thonë gjithmonë të vërtetën. Një njeri i cili thotë gjithmonë të vërtetën i sjell shoqërisë, veçse dobi dhe mirësi. Për rrjedhojë, gënjeshtria nuk i këshillohet një myslimani të mirë. Nëse do të ishte i mundur materializimi i gënjeshtres, ajo sigurisht që do të kishte një pamje të pësh-tirosur dhe secili do të përpiquej t'i shmangej asaj! Thuhet se gënjeshtria i ka këmbët e shkurtra prandaj gënjeshtarët nuk mund t'i shmangen për një kohë të gjatë turpit dhe poshtërimit.

Fatkeqësisht, në ditët e sotme gënjeshtria prezantohet si veti pozitive. Një pjesë e mirë e njerëzve, mendojnë se nuk ka ndonjë gjë të keqe nëse dikush gënjen për llogari të përfitimit vetjak apo familjar. Me dhimbje mund të kontastojmë se gënjeshtria ka gjetur vend tek shtresat e ndryshme të shoqërisë, duke përfshirë edhe disa myslimanë. Njeriu i thjeshtë bën pyetjen se përse duhet të thotë të vërtetën kur sheh se të tjerët, sidomos ata që duhet të jenë shembull për të gjithë, nuk sillen kështu. Në ditët e sotme gënjejnë jo vetëm politikanët dhe njerëzit e fesë, por edhe biznesmenët, agjensitë e reklamave, mediat dhe shumë të tjerë.

Vetëm se, këto fenomene të sipërpërmendura, nuk na japin të drejtën ne të tjerëve që të ndjekim tendencat e negative dhe të gabuara, të cilat mbizotërojnë në shoqërinë e sotme. Është obligim për ne, që t'i luftojmë

këto sëmundje shoqërore dhe t'u tregojmë të tjerëve se mund të sillësh edhe ndryshe. Me një fjalë, të jetosh në bazë të mësimëve të Kuranit dhe Syneetit është jo vetëm e mundur dhe e dëshirueshme por edhe e dobishme dhe fitimprurëse.

Ata myslimanë, që gënjejnë dhe mashtrojnë gjatë veprimtarisë se tyre, duhet ta dinë se rruga e tyre nuk do të ketë një përfundim të mirë ose të lumtur. Allahu në Kuranin fisnik e ngre lart virtytin e thënies të së vërtetës duke e demonstruar këtë edhe nëpërmjet shembullit të pejgamberëve, besimtarëve dhe martirëve, si veti e natyrshme e tyre. Allahu nëpërmjet Kuranit na bën thirrje që ta bëjmë tonin këtë virtyt e t'i qëndrojmë atij besnik në çdo rrethanë: „ O ju që besuat! Ta keni në kujdes (frikë) Allahun dhe të jeni me ata të drejtit (që thonë të vërtetën). “ (Kurani fisnik, 9:119)

Qëllimi më i lartë i çdo myslimani duhet të jetë kalimi me sukses i sprovimeve të besimit dhe arritja e Xhenetit (Parajsës). Pejgamberi Muhamed, paqja dhe shpëtimi qofshin me të, në hadithin e mëposhtëm na tregon sesi është e mundur të arrihet kjo: „Përmbajuni së vërtetës (thënies së saj), sepse ju drejton nga e mira, dhe e mira ju çon drejt Xhenetit. Me siguri, çdo njeri, i cili thotë gjithmonë të vërtetën dhe i përmbahet asaj me këmbëngulje, është regjistruar tek Allahu si siddik (i vërtetë, thënës i së vërtetës). Shmangiuni pra gënjeshtres, sepse gënjeshtria ju drejton nga e keqja dhe e keqja ju çon drejt Xhehenemit (Ferrit). Me siguri, çdo njeri, i cili gënjen

vazhdimisht është regjistruar tek Allahu si gënjeshtar.“

Thënia e së vërtetës është një nga mjetet me të cilat myslimani mund të fitojë zemrat dhe simpatinë e të tjerëve. Thënia e së vërtetës e motivon njeriun që të kryejë vepra të mira dhe fisnike.

Nëse do t'i hidhnim një sy, përvojës dhe shembullit të myslimanëve të parë me në krye Pejgamberin e dashur, do të konstatojmë pa vështirësi se të gjithë pa përjashtim thonin të vërtetën. Ata janë për ne shembujt e duhur për t'u ndjekur dhe jo idhujt fallco, të cilët aktualisht na prezantohen si bartësit e suksesit dhe stilit përparimtar të jetesës.

Halifi i dytë i islamit, Omer ibën Hatab ka thënë për të vërtetën: „Thuaj të vërtetën edhe nëse kjo mund të të kushtojë kokën!“ Gjithashtu, më tej është shprehur: „Ai që thotë të vërtetën, arrin me sinqeritetin e tij atë që një gënjeshtar s'mund ta arrijë kurrë me mashtrimet e tij!“

Një kushëri i afërt i Pejgamberit, komentuesi i famshëm i Kuranit, Ibën Abasi është shprehur me një shprehje të bukur: „Ka sukses ai njeri që ka këto veti: sinqeritetin (thotë të vërtetën), modestinë, karakterin dhe mirënjohjen“.

Sunduesi nga Emevitët, Omer ibën Abdul Aziz, i cili quhej ndryshe edhe si i pesti prej halifëve të drejtë, ka thënë për gënjeshtren: „Nuk kam gënjer qysh kur jam ndërgjegjësuar se gënjeshtër e diskrediton njeriun.“

Mendimtari i madh islam, Imami el-Evzai, i cili ka jetuar në Levant është shprehur: „Betohem në Allah! Nuk do të gënjeja edhe sikur nga qielli të vinte shpallja se gënjeshtër është hallall!“

Jusuf ibën el-Esbat ka thënë: „Një natë në sinqeritet para Zotit ka më tepër vlerë për mua, sesa lufta në rrugën e Tij.“

Imami Shabi ka thënë: „Përmbajuni së vërtetës edhe atëherë kur mendoni se kjo mund

t'ju dëmtojë, pasi më vonë do ta shikoni se kjo do t'ju ndihmojë, dhe shmangiuni gënjeshtërës edhe atëherë kur mund t'ju duket se kjo do t'ju ndihmojë pasi më vonë me siguri do ta shikoni se kjo do t'ju dëmtojë.“

Sunduesi i famshëm Abdul Malik ibën Merwan mësohet t'i ketë thënë mësuesit të djemve të vet: „U mëso atyre të thonë të vërtetën, (po me aq përkushtim) si ua mëson Kurantin.“

Të gjitha thëniet, këshillat dhe fjalët e mençura të paraqitur mësipër përforcojnë mendimin, se thënia e së vërtetës ka qenë, është dhe do të jetë virtyt tipik i besimtarëve dhe qytetarëve të ndershëm.

Me anë të sinqeritetit dhe së vërtetës, i shmangemi më mirë problemeve dhe së keqes. Me anë të tyre kalojmë me sukses provimin në kompaktësinë e besimit tonë, duke i hapur rrugën vetes drejt Parajsës ku do të takohemi me të gjithë pejgamberët dhe besimtarët e devotshëm.

Prandaj vëllezër, të tregojmë kujdes që të themi gjithmonë të vërtetën dhe vetëm të vërtetën e të mos gënjejmë apo shpifim për gjëra që s'përputhen me realitetin dhe të vërtetën. Të vërtetën duhet ta thotë secili prej nesh dhe sidomos, ata që merren me biznes ose që u ofrojnë të tjerëve shërbime.

Muslimani duhet të thotë të vërtetën kudo, si në punë ashtu dhe në çdo aktivitet tjetër. Muslimani duhet të thotë të vërtetën dhe të sillet me edukatë ndaj të gjithëve, qofshin këta myslimanë apo jo.

Muslimani duhet të përpiqet që përkushtimi i tij ndaj fesë të jetë i sinqertë. Secili prej nesh duhet t'i drejtohet Allahut dhe t'i lutet Atij që t'i japi fuqi të mjaftueshme për të kryer me devotshmëri obligimet që rrjedhin nga aspekti fetar e jofetar.

Muslimani duhet të thotë të vërtetën pasi gënjeshtër është një ves i keq. Ai duhet të jetë i sinqertë pasi këtë e kemi obligim nga

Allahu dhe i Dërguari i Tij, Pejgamberi Muhammed, paqja dhe shpëtimi qofshin me të. Myslimani duhet të thotë të vërtetën dhe s' duhet të gënjejë pasi kjo është shenjë e besimit të fortë tek Allahu dhe shpalljet e Tij. Myslimani duhet të thotë të vërtetën, sepse njerëzit do ta pëlqejnë atë dhe do ta respektojnë në ndryshim nga mashtruesit të cilët përbuzen dhe izolojnë nga shoqëria nën frikën e tradhtisë dhe karakterit të tyre të paparashikueshëm.

Me thënien e së vërtetës myslimani siguron qetësinë shpirtërore, në kontrast të plotë me mashtruesit dhe gënjeshtarët që janë në tension të përhershëm nga fakti se mund të zbulohen dhe diskretitohen në mënyrë të turpshme.

Duke përfunduar dua të rikonfirmoj edhe njëherë me krenari se vetia e thënies të së vërtetës është dhuratë e paçmuar nga Allahu.

Siç e përmendëm edhe më sipër thënia e së vërtetës na çon drejt Xhenetit (Parajsës) dhe na mbron nga zjarri i Xhehenemit (Ferrit). Personaliteti i madh që mishëron shembullin më të përkryer që duhet të ndjekim si besimtarë - pejgamberi i dashur Muhamedi, paqja dhe shpëtimi qofshin me të, na inkurajon që të themi vetëm të vërtetën dhe t'i shmangemi gënjeshtërsisë edhe kur bëjmë shaka. Në një hadith ai është shprehur: „Atij që i shmanget gënjeshtërsisë qoftë edhe kur bën shaka, i garantoj një shtëpi në mes të Xhenetit (Parajsës)“.

O Zot! Na ndihmo që të themi vetëm të vërtetën. Na ndihmo t'i përmbahemi shpalljes Tënde dhe të mbrojmë besimin Tënd. Ki mëshirë për ne o Zot i madh, na i fal gjynahet dhe na prano në Xhenet, Amin!

Leksion i mbajtur në Xhaminë e Bratislavës, më 01.07.2005

© IslamOnweb.net

Pse Islami?

Pse Islami? Pyetja pse kërkon përgjigje racionale. Megjithatë, shumë njerëz janë të mendimit se nuk ka përgjigje racionale për përcaktimin ideologjik (ideologji-një tërësi mendimesh). Ata mendojnë se pranimi i çdo ideologji fetare është akt joracional. Askush nuk mundet të mohojë faktin se shumë njerëz pa vetëdije i përcaktohet ideologjive të ndryshme dhe u përmbahet atyre për shkak të ndikimit të rrethit ku ka lindur dhe është rritur. Ata identifikohen ideologjik e pranojnë ashtu siç e kanë pranuar mënyrën e veshjes së trashëguar. Për shembull: Njeriu mundet që thellë t'i përkushtohet ideologjisë nacionaliste, për shkak të përkrahjes së gjerë që do ta kishte prej masës e cila do t'i siguronte pushtet politik.

Të analizojmë dy pikëpamje të zakonshme rreth përkushtimit ideologjik:

- Sipas qëndrimit të parë, çdo ideologji që përfshin ndonjë lloj hyjni detyrimisht është joracionale.

Premisa e atyre që e mbrojnë këtë qëndrim janë pohimet se ideologjitë e tilla janë përtej aftësisë mendore për të kuptuar. Ata që i kanë pranuar këto premisa kanë arritur në përmblyllje, se gjithë llojet e 'besimit' të tillë mbështeten në mendime imagjinare dhe joracionale, e jo në realitetin.

- Këndvështrimi tjetër kërkon arsyetimin e 'besimit' në disa ide joracionale duke pretenduar kufizimin e logjikës.

Në fakt pasuesit e kësaj ideologjie deklarojnë nevojën që njerëzit tu përkushtohen ideve të tilla duke pasur thjesht 'besim' në to. Sipas përfundimit të tyre realiteti final në esencë është joracional dhe si i tillë i pakapshëm për mendjen njerëzore. Ideologjinë e tillë duhet pranuar dhe besuar për të siguruar ndonjë lloj 'shpëtimi'.

Këtë mënyrë të argumentimit është vështirë ta pranojmë pa parashtruar pyetjen: Çfarë mjet tjetër, jashtë mendjes tonë, kemi ne dispozicion për të mësuar dije? Po të na thuhet të besojmë në diçka që është joracionale (përtej arsyes), si për shembull besimi për vdekshmërinë dhe jo vdekshmërinë e ndonjë qenie, këtë ide ne nuk do të mundim ta pranojmë. Nuk është e natyrshme që prej neve të kërkohet që mënyrën e të menduarit dhe të jetesës kryesisht ta mbështesim në koncepte që nuk ka mundësi të verifikohen si të vërteta.

Nëse i kthehemi mendimit të parë rreth përkushtimeve ideologjike, do të shohim se ai mohon besimin në atë që nuk kemi mundësi ta kapim ta kuptojmë. Thexi është i vendosur mbi fjalën 'kuptim' dhe për këtë shkak ai duhet të definohet. Është fakt se njeriu nuk ka mundësi të ketë fotografi adekuate mentale për disa fakte matematikore dhe shkencore. Për shembull, njeriu nuk ka mundësi të ketë pasqyrim të adekuat mental për lakimin e kozmosit dhe për konceptin matematikor të pafundësisë (infinity). Nuk kemi mundësi të kemi pasqyre të përshtatshme mendore për mënyrën se si disa kafshë përjetojnë gjërat si për shembull lakuriqi i natës i cili shikon me anë valëve tej-zanore (ultrasonike). Këto koncepte ne i pranojmë si të sakta për shkak të argumentimit të shëndoshë e jo për shkak të ideve joracionale. Për këtë shkak kemi drejtë të themi ne me të vërtetë kemi mundësi t'i përfshijmë ato sende me kuptimin tonë.

Tani të flasim për Qenien e vetme, të gjithëdijshme që ka krijuar gjithësinë. Është e pamundshme që ne të kemi fotografi vizuale apo mendore për një qenie të tillë, sepse sipas argumenteve ajo Qenie nuk është e ngjashme me asgjë në këtë gjithësi, është e Pavarur prej vendit dhe kohës. Argumenti për ekzistencën e kësaj Inteligjence Unike është në mënyrën e krijimit të natyrës, të cilën ne lirisht mundemi ta ekzaminojmë; prandaj një ideologji e tillë është racionale. Nëse këtë e ke kuptuar dhe konfirmuar atëherë të vazhdojmë në përgjigjen e pyetjes: Pse Islami?

Një prej problemeve kryesore të ideologjisë ateiste është paaftësia për të shpjeguar inteligjencën në proceset e gjithësisë. Problemi tjetër është orvatja që jetën ta privoj nga kuptimi. Ateizmi, njeriun si krijesë e cila natyrisht është e prirë për sinqeritet, duke e mohuar shkakun themelorë dhe çdo gjë përtej vdekjes, e sjell në situatë kontradiktore dhe i shkakton paqëndrueshmëri në sjellje- dëshira për sinqeritet si prirje natyrore dhe nevoja për gënjeshtëri për të fituar 'shumicën e botës'.

Po të insistonte çdokush në 'fitimin e shumicë së botës' nuk do të ekzistonte shoqëria ashtu si e njohim ne. Si shembull të supozojmë që ata që duan të fitojnë më shumë në botë, e zgjedhin vjedhjen si mjet. Po të ndodhte kështu askush nuk do të prodhonte asgjë (ushqim për shembull) që tjetri të ketë mundësi ta vjedh prej tij. Si duket 'fitimi më i madh në botë' është vepër që ka për të dështuar. Atëherë a ka mundësi që ky sistem të jetë 'besim' i pranueshëm.

Thënë gjerësisht, ideologjitë teologjike, ndahen në të shpallurat, të shfytyruarat (imagjinuarat) dhe të shpikurat nga njeriu. Dikush lehtë mund të thotë: Mënyra e jetës që nga Krijuesi i është komunikuar njerëzimit është më e preferuar se mënyra e shpikur nga njeriu. Ai që dëshiron të pason këshillën e Atij që ka

krijuar gjithësinë dhe gjithë komponentët e saj -rreth të dobishmes dhe të dëmshmes-është më mirë për të t'i referohet shpalljes së pa ndryshuar prej Krijuesit, se sa të mbështetet në atë që është shpikur ose imagjinuar nga njeriu.

Ideologjitë që për vete pretendojnë se kanë mbështetje në shpallje, duhet tu nënshtrohen disa testeve, i pari i të cilëve dhe ai më i rëndësishmi është testi i konsistencës-stabilitetit. Duhet të testohen dy llojet e konsistencës: konsistenca e brendshme dhe ajo e jashtme. Konsistencë e brendshme është mos prania e kundërshtimit mes teksteve brenda librit të njëjtë. Konsistencë e jashtme është mos kundërshtimi i teksteve të librit me faktet e njohura qofshin ato psikologjike, fizike, kimike, historike, gjeografike, biologjike etj. Duke i aplikuar këto teste si të vërtetë më të rëndësishme konsidero e besimin në ekzistencën dhe atributet e përkryera të Zotit, e vërtetë kjo e proklamuar nga gjithë ideologjitë që pretendojnë se burojnë nga shpallja hyjnore. Zoti sipas gjithë ideologjitë që pretendojnë të janë të shpallura është i Gjithëdjishmi, i më Mëshirshmi, i Përhershmi...

Sidoqoftë në disa libra dija e Zotit është e përkufizuar dhe jopërkryer; për shembull, ndodh "mashtrimi" i Zotit nga disa njerëz. Për dallim nga këto libra Kur'ani ofron koncept perfekt për Krijuesin e Gjithëdjishëm të Universit.

Testi me radhë është ai i Autencitetit (vërtetësisë). Pyetja është teksteve që ne sot i kemi në duar a janë me të vërtetë shpallja e Krijuesit drejtuar njerëzimit. Studimi i historisë Islame do të vërteton se Kur'ani që e kemi sot është i njëjtë me atë që është shpallur para njëmijë e katërqind vjet. Gjatë shpalljes shumë njerëz atë e kanë mësuar përmendësh dhe i njëjti gjithashtu ka qenë edhe i shënuar.

Testi tjetër që duhet ta kalon një ideologji fetare është ai i Përfshirjes së plotë. Ideologji e vërtetë është ajo që i është shpallur prej Krijuesit dhe që përfshin sistemin më të dobishëm në gjithë sferat e jetës, sferat politike, ekonomike, sociale, mjekësore dhe mjedisore.

Në fund vjen testi i Mundësisë për aplikim Global. Një ideologji, historikisht dhe gjeografikisht e përkufizuar, nuk është e dobishme si ajo e cila është e aplikueshme për gjithë njerëzit, pa dallim vendndodhje, kohë dhe prejardhje.

Duke e përmbyllur fjalinë tonë themi: Ai që përdor kriteret e mundësisë për aplikim global, përfshirjes së plotë, vërtetësinë dhe para se gjithash kriterin e konsistencës do të arrin në përfundim Kur'ani është unik ose së paku është i denjë për hulumtim. Është interesant të theksohet që vetë Kur'ani thekson qasjen e lartpërmendur. All-llahu, subhanehu ve tea'la thotë: "A nuk e përfillin ata (me vëmendje) Kur'anin? Sikur të ishte prej dikujt tjetër, përveç prej All-llahut, do të gjenin në te shumë kundërthënie." (En Nisa, 82)

Dr. Xha'fer Shejh Idris
(ligjërator e përshtatur nga Analysis-Toronto)
Përktheu: Talha Kurtishi

Ejani në shpëtim!

Falenderojmë All-llahun Fuqiptotë për të gjitha të mirat që na ka dhënë. E falenderojmë që na ka bërë pasues së fesë së vetme të pranuar tek Ai dhe të pejgamberit të tij të fundit Muhammedit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem. Prej dhuntive më të mëdhaja të All-llahut, subhanehu ve teala, është se ai na ka obliguar me namaz, me anë të së cilit na i fal mëkatet, na largon nga veprat e liga, na i shton shpërblimet dhe na ngritë gradat në xhennet.

Ebu Bekr Ibën Abdullah el Muzani ka thënë: "Kush është si ti, o bir i Ademit? Kurdo që dëshiron, e përdor ujin për të marë abdes, shkon te vendi për adhurim, fillon namazin pa përkthyes në mes teje dhe Zotit tënd!" (El Bidaje ven-Nihaje 9/256).

Vlera jashtëzakonisht e madhe e namazit

Padyshim se namazi ka vlerë shumë të madhe, ai është shenjë e besimtarëve, rrugë e pejgamberëve dhe besimtarët në ditën e gjykimit do të dallohen nga ajo se pjesët ku kanë marrë abdes do t'u ndriçojnë. All-llahu, subhanehu ve teala, në shumë ajete na urdhëron në mënyrë të prerë që ta falim namazin.

Ai, subhanehu ve teala, thotë: "Faleni namazin dhe jepni zeqatin, dhe faluni me ata që falen." [Bekare: 43].

"Kërkoni ndihmë (në të gjitha çështjet) me durim dhe me namaz, vërtet, ajo është e madhe (vështirë), por jo edhe për ata që kanë frikë (Zotin)." [Bekare: 45].

"Kryeni faljen (namazin) dhe jepeni zeqatin, e çfarëdo të mirë që e përgatitni për veten tuaj, atë e gjeni tek All-llahu. S'ka dyshim se All-llahu përcjell çdo vepër tuajin." [Bekare: 110].

"Ata janë njerëz që nuk i pengon as tregtia e largët e as shitblerja në vend për ta përmendur All-llahun, për ta falur namazin dhe për ta dhënë zeqatin, ata i frikësohen një dite kur do të tronditen zemrat dhe shikimet." [Nur: 37]

"Ti lexo atë që po të shpallet nga libri (Kur'ani), fal namazin, vërtet namazi largon nga të shëmtuarat dhe të irituarat, e përmendja e All-llahut është më e madhe (e adhurimeve); All-llahu e di ç'punoni ju." [Ankebut: 45].

Nuk ka arsytet për lënien e namazit përveçse nëse çmendesh ose nëse të ka zënë gjumi (themi nëse të ka zënë gjumi, e jo nëse ke ra me flet) dhe të ka kaluar një namaz, në këtë rast posa të ngritesh prej gjumi duhet ta falish namazin që të ka kaluar.

Sipas Ligjit Islamik (shariatit) të sëmurit duhet thënë: "Pastrohu si dhe sa të mundesh. Ulu qysh të mundesh, por mos e lësho namazin. Pastrohu me ujë, e nëse nuk ke ujë merr tejemmum, me dhë të pastër. Falu në këmbë, nëse kështu nuk mundesh, falu ulur, nëse nuk mundesh as kështu, falu i mbështetur në anën e djathtë apo i shtrirë në shpinë, e nëse as kështu nuk mundesh, atëherë lëvize kokën ose vetëm sytë, në kuptim të fjalëve të All-llahut: "Andaj, sa te keni mundësi ruajuni prej dënimit të All-llahut!" [Tegabun 16].

Poashtu edhe Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, në shumë hadithe të tija na ka treguar vlerën e madhe që e ka namazi dhe dobitë e shumta që i fiton ai që e fal namazin.

Nga Ibën Umeri, radijAll-llahu anhumu, transmetohet se i Dërguari i All-llahut ka

thënë: "Islami është ngritur mbi pesë (shtylla): dëshminë se nuk ka hyjni tjetër përveç All-llahut dhe se Muhammedi është i dërguar i All-llahut, kryerjen e namazit, dhënien e zekatit, vizitën Ka'bes dhe agjërimin e Ramazanit". (Buhari dhe Muslimi)

Transmetohet nga Abdull-llah ibn Mes'ud, radijAll-llahu anhu, se ka thënë: "E kam pyetur Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem: "Cila punë është më e dashur tek All-llahu i Madhëruar?" Tha: "Namazi në kohën e vet". I thashë: "Pastaj cila?" Tha: "Bamirësia ndaj prindërve". I thashë: "Pastaj cila?" Tha: "Xhihadi (lufta) në rrugë të All-llahut". (Buhari dhe Muslimi)

Ebu Hurejre, radijAll-llahu anhu, thotë se e ka dëgjuar të Dërguarin e All-llahut duke thënë: "Çka mendoni, sikur të ishte një lumë para derës së njërit prej jush, në të cilin do të lahej për çdo ditë nga pesë herë, a do të mbetej në të ndytësi?" Të pranishmit thanë: "Nuk do të mbetej kurrfarë ndytësie". Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, atëherë tha: "Ky është shembulli i pesë kohëve të namazit. All-llahu me faljen e namazeve i shlyen mëkatet". (Buhari)

Poashtu Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, na ka mësuar që ti urdhërojmë fëmijët tanë që ta falin namazin.

Transmetohet nga Amr ibn Shuajb, ky nga babai i tij, e ai nga babai i vet, radijAll-llahu anhu, se i Dërguari i All-llahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Urdhëroni fëmijët tuaj për (të falë) namaz kur t'i kenë shtatë vjet, kurse detyroni me forcë kur t'i bëjnë dhjetë vjet...". (Hadith hasen, transmeton Ebu Davudi).

Andaj çdo prind duhet së pari ta fal namazin vet rregullisht, e pastaj ti mëson edhe fëmijët e vet që ta falin namazin dhe ta ndëgjojnë Krijuesin e tyre, sepse All-

llahu, subhanehu ve teala, thotë: "O ju që besuat, ruajeni veten dhe familjen tuaj prej një zjarri, lëndë djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët..." [Tahrim: 6].

Muadh Ibën Xhebeli e këshilloi djalin e tij: "Djali im! Fale namazin sikur të jetë i fundit dhe paramendo se nuk do të mund të falesh edhe njëherë. Dije se besimtari vdes në mes dy veprave të mira, njëren të cilën e ka bërë dhe atë që ka pasur për qëllim ta bënë më vonë." (Sifetus-Safveh 1/496).

Kërcënimi ndaj atij që e le namazin

Vëlla i dashur musliman, pasi që e kuptove vlerën dhe rëndësinë e madhe që ka namazi për ne si musliman, atëherë dije se All-llahu, subhanehu ve teala, poashtu është kërcënuar me dënim të ashpër për atë që e lenë namazin.

Ibën Umeri, radijAll-llahu anhu, thotë se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Mua më është urdhëruar që t'i luftoj njerëzit, derisa të dëshmojnë se nuk ka hyjni tjetër përveç All-llahut dhe se Muhammedi është i Dërguari i Tij, dhe derisa të falin namazin dhe të japin zekatin. E kur e bëjnë këtë, atëherë e kanë të mbrojtur prej meje gjakun dhe pasurinë e tyre, pos nëse i kanë hyrë në hak Islamit, e llogaria e tyre është te All-llahu". (Buhari, Muslimi)

All-llahu, subhanehu ve teala, na tregon se synimi i shejtanit është që ta largon njeriun nga namazi. Ai thotë: "Shejtani nuk dëshiron tjetër, përveç se nëpërmjet verës dhe bixhozit të hedhë armiqësi mes jush, t'ju pengojë nga të përmendurit Zotin dhe t'ju largojë nga namazi..." [Maide: 91].

All-llahu, subhanehu ve teala, na tregon se hipokritët (munafikët) e falin namazin me pritesë, veni re: "e falin namazin", pra,

cilësi e munafikëve është se e falin namazin me përtaci, e a thua çka mund të themi për atë që e lenë namazin tërësisht, e as nuk i kujtohet të falet?

All-llahu, subhanehu ve teala, na tregon se në ditën e gjykimit banorët e xhennetit do ti pyesin banorët e xhehnemit se pse kanë hyrë në xhehnem, e ata do të përgjigjen: "Ne nuk e falim namazin..".

Kurse Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Kush rregullisht e kryen namazin do t'i jetë dritë, shpëtim dhe dëshmi në ditën e Gjykimit, e kush nuk e kryen rregullisht atë, nuk do të ketë dritë, shpëtim e as dëshmi dhe në ditën e Gjykimit do të jetë me shoqërinë e Karunit, faraonit, Hamanit dhe Ubejj b. Halefit." [Imam Ahmedi].

Ibën Kajjimi, rahimehull-llah, duke e komentuar këtë hadith thotë: "Atë që nga falja e largon dëshira për pushtet, do të jetë i ringjallur pranë Faraonit; ai që e ka lënë namazin nga dëshira për pasuri do të ringjallet pranë Karunit; atë që kryelartësia dhe pozita e kanë penguar nga falja do të ringjallet në shoqëri të Hamanit, ndërsa nëse është në pyetje tregtia, atëherë do të ringjallet pranë Ubejj b. Halefit."

Poashtu All-llahu, subhanehu ve teala, dhe Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, na tërheqin vërejtjen se lënia e namazit është vepër e kufrit.

All-llahu, subhanehu ve teala, thotë: "(përqëndrohuni në atë fé) Të kthyer sinqerish tek Ai, kini frikë prej Atij dhe faleni namazin e mos u bëni nga idhujtarët." [Rum: 31].

Drejtësi, për gjithmonë

Feja Islame në të vërtetë i përmbahet parimit „dhëmb për dhëmb“. Kjo nuk do të

Xhabiri, radijAll-llahu anhu, thotë: "E kam dëgjuar të Dërguarin e All-llahut duke thënë: "Në mes njeriut, shirkut dhe kufrit është lënia e namazit". (Muslimi)

Burejde, radijAll-llahu anhu, thotë se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Zotimi i cili na ndan neve dhe ata është namazi, andaj ai që e lë atë ka bërë kufër". (Tirmidhiu thotë: hadith hasen).

Shekik Ibn Abdull-llah, i cili ishte prej tabiinëve dhe ishte i njohur për devotshmëri, thotë: "Shokët e Muhammedit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, nuk e konsideronin lënien e asnjë pune për kufër, përveç lënies së namazit." [sahih, transmeton Tirmidhiu].

Njëri nga selefët ka thënë: "O bir i Adem! Ti ke nevojë për pjesën tënde në këtë botë, mirpo ti ke nevojë edhe më shumë për pjesën tënde në ahiret. Nëse kujdesesh për pjesën tënde në këtë jetë, atëherë ti do ta humbësh pjesën tënde në botën tjetër dhe së shpejti do ta humbësh pjesën tënde në këtë jetë gjithashtu. Nëse kujdesesh për pjesën tënde në ahiret, ti gjithashtu do ta fitosh pjesën tënde në këtë jetë me lehtësi." (Fedailudh-Dhikr f.19).

Vëlla i dashur! A nuk janë të mjaftueshme këto fakte që i paraqitëm që të vendosësh një herë e përgjithmonë se nuk do të lësh asnjë namaz pa falur, a nuk është kjo e mjaftueshme që të pendohesh te All-llahu për gabimet që i ke bërë dhe të kthehesh me të gjitha forcat kah Ai? Nxito dhe pendohu para se të jetë vonë, kthehu te Zoti yt me pendim të sinqertë...

Omer Islami

thotë që të kryhet hakmarrja ndaj të pafajshmëve. Përkundrazi, kuptimi i parimit të

sipërpërmendur është që të vihet në vend drejtësia duke dënua agresorin për padrejtësinë ndaj viktimës.

Thelbin e ligjeve islame (duke përfshirë edhe mësimet islame), mund ta shprehim pra me një fjali, e cila përshkruan parimin themelor që përmbledh të gjitha vlerat e islamit - Drejtësinë.

Të sillesh me drejtësi do të thotë ti japësh secilit çfarë i takon. Kjo përmbledh në vetvete kompleksitetin e jetës dhe marrëdhëniet gjithnjë e në zhvillim, të gjitha shtytjet, përfytyrimet dhe shqetësimet, të gjitha konfliktet dhe dilemat.

Që Zoti ta udhëzonte njerëzimin nga drejtësia, dërgoi në botë peygamberët me shenja të qarta, Tekstet e shenjta dhe me peshoren (e drejtësisë). Tekstet e shenjta (librat e shenjta të shpallura peygamberëve nga Zoti) përmbajnë shpalljet që shpjegojnë ç'është e drejtë dhe e padrejtë, ç'është e mira dhe e keqja. Peshorja nënkupton aftësinë për të matur dhe analizuar në mënyrë që të ndjekim rrugën e treguar nga Zoti si dhe të shpjeguar nëpërmjet peygamberëve.

Këto burime na mësojnë se ç'të drejta kanë Zoti, personat e tjerë rreth nesh si dhe ç'të drejta kemi ne vetë dhe si mund të gjejmë barazpeshën mes këtyre të drejtave. Jeta e kaluar me bindje ndaj Zotit përmban analiza të vazhdueshme individuale dhe kolektive.

Normalisht, shumica e njerëzve është e aftë të zbatojë drejtësinë. Por Islami kërkon nga ithtarët e vet që të zbatojnë drejtësinë edhe atëherë kur janë nën efektin e emocioneve të fuqishme e kontroverse. Pengesat kryesore në zbatimin e drejtësisë ndaj individëve të tjerë janë dy: dashuria dhe urrejtja.

Le të shohim si na mëson Kurani të kapërcejmë pengesën e parë ndërsa gjy-

kojmë të afërmit apo vetveten: „O ju që besuat, vazhdimisht të jeni dëshmues të drejtë për hir të Allahut edhe nëse është kundër (interesit) vetvetes suaj, kundër prindërve ose kundër të afërmeve, le të jetë ai (për të cilin dëshmohet) pasanik ose varfanjak, pse Allahu di më mirë për ta. Mos ndiqni pra emocionin e t'i shmangeni drejtësisë. Nëse shtrembëroni ose tërhiqeni, Allahu hollësisht di çka punoni.“ (Kurani fisnik, 4:135)

Në këtë varg Kuranor shikojmë një pozicionim e përcaktim të qartë përsa i përket konfliktit të përhershëm mes drejtësisë dhe interesit personal. Kurani na urdhëron: Lini të drejtë edhe nëse kjo do të ishte kundër interesave tuaja të ngushta personale apo në disfavor të të afërmeve tuaj.

Njerëzit e pavetëdijshëm mendojnë se duke qenë të padrejtë ndaj të tjerëve mbrojnë interesat e tyre. Synimi i tyre për të qenë të padrejtë apo të drejtë mund të reflektojë thjeshtë përlogaritjet me përfitim vetjak. Besimi i vërtetë tek Zoti e nxjerr njeriun nga kjo dobësi materiale. Vargjet e përmendura më sipër na rikujtojnë se mbrojtësi i vërtetë i interesave të të gjithë njerëzimit është Zoti dhe vetëm Ai mund të na mbrojë kur vjen puna për t'iu bindur urdhërit të Tij për të qenë drejtë. Drejtësia që kërkon Islami nuk e lejon tarafin apo favorizimet.

Pengesa e dytë, po aq e rrezikshme sa e para, është urrejtja. Kurani edhe për këtë çështje shprehet si mëposhtë: „O ju që besuat! Bëhuni plotësisht të vendosur për hir të Allahut, duke dëshmuar të drejtën, dhe të mos u shtyjë urrejtja ndaj një populli e t'i shmangeni drejtësisë; bëhuni të drejtë, sepse ajo është më afër devotshmërisë. Kini drojë nga Allahu se Allahu di hollësisht për atë që veproni.“ (Kurani fisnik, 5:8)

Me fjalë të tjera nuk mund të tregohemi të padrejtë, nëse gjykojmë ithtarët e besimeve të tjera fetare apo armiqët. Tendenca e natyrsme e individëve injorantë e të pacivilizuar është të sjellurit ndaj armiqve si me dikë që nuk gëzon kurrfarë të drejtash dhe që s'meriton gjykim të drejtë e të paanshëm.

Kjo ka qenë praktikë edhe në shoqërinë klanore paraislamike (xhahilijeti = injoranca), dhe kjo praktikë vazhdon edhe sot në ditët e botës moderne. Shikoni sesi e kontrollon këtë dukuri negative Islami. Besimtarët marrin udhëzime me paralajmërimin se Zoti na shikon vazhdimisht dhe se armiqësinë mos ta keqpërdorin për kryerjen e padrejtësive dhe mënxyrave.

Drejtësia nga ana tjetër përmban edhe dënimin, prandaj, edhe Islami e pranon parimin „dhëmb për dhëmb“. Kjo nuk do të thotë ndëshkimin e të pafajshmëve. Përkundrazi kjo nënkupton dënimin e fajtorit për hir të viktimës. Është e çuditshme se sot shpesh, ata që i përshkruajnë viktimat si barbarë, u vijnë në ndihmë agresorëve kur vjen situata e krizës.

Shpalljet Kuranore krijuan një shoqëri ku i pasuri dhe i varfëri, miku dhe kundërshtari, myslimani dhe jomuslimani, pushtetari dhe qytetari, të gjithë ishin të barabartë para ligjit, të gjithë ishin subjekte të një gjykimi me drejtësi. Gjykatësit (kuda' - kadi) ishin të pavarur dhe askush, duke përfshirë edhe pushtetarin (halifi), nuk ishte i privilegjuar para ligjit. Nëse lindte konflikt mes halifit dhe qytetarit të thjeshtë, të dy ishin të detyruar të paraqisnin provat e tyre para gjyqit. Historia islame është plot me histori që përshkruajnë natyrën e kësaj drejtësie e cila u

aplikua në të gjithë territorin e shtetit islam në periudhën e lulëzimit të tij.

Edhe në periudhën e shpërbërjes së shtetit unik islam shpesh gjejmë shembuj të tillë të cilat vështirë i gjejmë gjetkë. Mjafton të përmendim një shembull nga historia. Gjatë sundimit britanik në Indi, një herë, lindi një konflikt mes hinduistëve dhe myslimanëve për një ngatëresë toke. Hinduistët pretendonin se ngastra ishte pjesë e një tempulli të tyre, myslimanët pretendonin se i përkiste xhamisë së tyre. Emocionet ishin të theksuara tek të dyja palët dhe egzistonte rreziku i shpërthimit të një konflikti të dhunshëm. Gjykatësi anglez nuk mundi të gjente prova të mjaftueshme për zgjidhjen e konfliktit sepse kundër njëra-tjetrës qëndronin pretendimet e secilës palë. Ai pastaj iu drejtua të dyja palëve nëse do të pajtoheshin me dëshminë e një personi të besueshëm. Të dy grupet ranë dakord. Gjykatësi zgjodhi si dëshmitar një mysliman, imamin e atij qyteti i cili njihje si njeri besimtar dhe njeri korrekt. Dëshmitari u thirr në gjyq. Atmosfera ishte e tensionuar dhe komuniteti i vet (mysliman) i kërkonte që të dëshmonte në favor të tyre para gjyqit. Dëshmia e tij që në fakt koncize: „Hinduistët kanë të drejtë“ dhe vazhdoi, „kërkesat e myslimanëve janë të pabaza.“

Ky mysliman nuk e tradhëtoi komunitetin e vet edhe pse dëshmia e tij që në favor të jomuslimanëve. Pikërisht pse u shpreh pa frikë dhe pa marrë parasysh se cilit komunitet i përkiste, ai vërtetoi edhe një herë se myslimanët i dedikohen të vërtetës dhe vlerësojnë mbi të gjitha drejtësinë. Pikërisht për drejtësi të tillë ka nevojë bota sot.

Halid Balg

Përgatiti për publikim në shqip: islamweb.sk

Defektet në rrugën e dijes

Deri tani kemi dhënë mjaft sqarime për dijen dhe dijetarët dhe jemi munduar të sqarojmë rolin që duhet të kenë dijetarët në ngjalljen e umetit dhe tiparet që duhet ti posedojnë që kuptimi i tyre i fesë të jetë i shëndoshë dhe i saktë.

Kemi folur edhe për gjërat që e mbrojnë njeriun nga keqkuptimi i fesë dhe gjërat që i ndihmojnë në kuptimin e shëndoshë dhe produktiv të fesë.

Sot, në këtë takim tonin flasim për disa defekte që paraqiten në këtë rrugë.

Hyrje

Pasi që shejtani i futet njeriut nga më shumë se një derë dhe insistimi i tij për të hyrë nga dyert më të rëndësishme dhe më të mëdhaja nuk ndalet, andaj insistimi i tij për të hyrë nga dera e dijes është shumë i madh, sepse dija është vepra më e mirë pa konkurrencë.

Imam Gazaliu, rahimehull-llah, ka thënë: "Gjëja me gradë më të lartë për njeriun është: lumturia e përhershme, kurse gjëja më e mirë është mjeti që shpjen deri te kjo gradë. Te kjo gradë nuk mund të arrijë njeriu përpos se me dije dhe vepra, kurse veprën nuk mund ta bëjë nëse nuk di se si duhet bërë ajo vepër, andaj konkludojmë se baza e lumturisë në dynja dhe ahiret është vetëm dija, andaj edhe është vepra më e mirë". ("Ihjau Ulumid-Din", 1/12).

Për këtë shkak kjo rrugë është shumë e rëndë dhe në këtë rrugë ka shumë peripeti

dhe pengesa. Këto peripeti dhe pengesa disa herë e dëmtojnë krejtësisht dijen, disa herë e prishin qëllimin e disa herë mënyrën e nxënies së saj. Prej këtyre peripetive shpërton ai të cilin e shpëton All-llahu, azze ve xhel-le.

Për këtë shkak njeriu që është në rrugën e dijes duhet ti mëson defektet që mund ti shfaqen në këtë rrugë dhe të mbrohet prej tyre.

1- Mungesa e sinqeriteti gjatë mësimit të dijes.

All-llahu, subhanehu ve teala, në shumë ajete e qorton me të madhe mungesën e sinqeritetit në veprat që i bën njeriu gjat jetës së tij dhe tregon se ky njeri nuk fiton asnjë shpërblim dhe se All-llahu është i Pastër dhe i Mirë dhe vetëm të pastrën dhe të mirën e pranon.

All-llahu, tebareke ve teala, thotë: "Kush është që dëshiron fitimin e botës tjetër (Ahiretit), Ne do t'ia shtojmë fitimin e tij, e kush e dëshiron vetëm fitimin e kësaj bote, Ne ia japim, po në botën tjetër ai nuk ka hise". (Esh-Shura: 20).

"Kush është që e ka për qëllim vetëm këtë botë, Ne atij që duam i japim në të aq sa duam, e pastaj atij i bëjmë të hyjë në xhehenem i nënçmuar, i përbuzur. E kush e ka për qëllim botën tjetër, duke qenë ai besimtar, përpiqet për të ashtu si i takon asaj, angazhimi i tyre do të jetë i pranishëm (te Zoti)". (El-Isra: 18- 19).

Ebu Hurejre, radijall-llahu anhu, thotë: Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: All-llahu, azze ve xhel-le, thotë:

"Unë jam më i panevojshmi për ortak, ai që bën një vepër dhe më bën ortak në te, e lë atë njeri dhe veprën e tij". (Muslimi).

Ebu Sad ibën Ebi Fudale El-Ensariu, radijall-llahu anhu, tregon se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

"Kur ti bashkon All-llahu mbarë njerëzit në Ditën e Kijametit, atë ditë që ska dyshim në te do të thërret një thirrës: ai që i ka bërë ortak All-llahut në një vepër që e ka bërë për Te le të kërkon shpërblimin e tjetërkush përpos All-llahut, sepse All-llahu është më i panevojshmi nga shirku". (Sahih, Ibn Maxheja).

Zejd ibën Thabiti, radijall-llahu anhu, thot: kam dëgjuar Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, duka thënë: "Ai që qëllim të vetin ka dynjanë, All-llahu ia shpërndanë çeshtjet e tija, i vëndon varfërinë mes syve dhe nga dynjaja nuk i vjen më shumë se sa ajo që i ka caktuar, kurse ai që qëllim të vetin ka ahiretin, All-llahu ia grumbullon çeshtjet, i vëndon pasurinë në zemrën e tij dhe i vjen dynjaja përdhunshëm". (Sahih, Ibn Maxheja).

Hatib Bagdadiu, rahimehull-llah, ka thënë: "Ai që ka kohë, të cilin All-llahu i ka dhënë trup të shëndetshëm, i është bërë e dashur largimi nga shtresa e injorantëve dhe ka vullnet për ta mësuar fenë ta shfrytëzon këtë mundësi dhe të mer iniciativë nga frika se mund ti ndodh diç që e largon prej këtij qëllimi ose i ndërrohet gjendja dhe pengohet nga kjo rrugë. Le të jetë serioz në këtë çeshtje, i sinqertë në njetin dhe synimin e tij dhe kërkon prej All-llahu që ti jep dije të dobishme dhe sukses në te dhe ta rruan nga dija nga e cila nuk ka dobi.

Le të rruhet që mos të ketë qëllim nga kërkimi i dijes polemikat dhe debatet, të kthehen njerëzit kah ai dhe të mer kompensim për te". ("El-Fekih Vel-Mutefekih", 2/87).

Kab ibën Maliku, radijall-llahu anhu, tregon: kam dëgjuar Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi

ve sel-lem, duke thënë: "Ai që kërkon dije për tu renditur në rradhtë e dijetarëve dhe për të polemizuar me injorantët, a për ti kthyer fytyrat e njerëzve drejt tij, do ta shtin All-llahu në zjar". (Sahih, Tirmidhiu).

Kadi Ebu Bekër Ibën Arbaiu, rahimehull-llah, duke e komentuar këtë hadith thotë: "Dija mund të bëhet shkatërrim për bartësin e tij, nëse nuk e kërkon për All-llah. Hadithi tregon se qëllimi është shtyllë e veprës, rukën, ose kushti pa të cilin nuk ka vlerë. Nëse mungon ky kusht atëherë kjo vepër nuk është asgjë, ... e nëse dëshiron të renditet në rradhët e dijetarëve, priset nga shkaku i zilisë dhe mburrjes para mocanikëve dhe kjo vepër e cila duhet të bëhet për ahiret po bëhet për dynja. Nëse dëshiron të polemizon me injorantët, bëhet si ata. Nëse dëshiron të tërheq fytyrat e njerëzve kah ai për të fituar pasuri të kësaj bote, e shet fenë për pak gjëra të kësaj dynjaje. Ky njeri është mëkatar dhe i prishur, shpresojmë të vdes me shehadet e të mbetet nën Dëshirën e All-llahut, subhanehu ve teal, ose ti dridhet besimi e ti dobësohet në çastet e vdekjes e të bëhet nga banorët e zjarit". ("Aridetul-Ahvedhi", 10/121).

Ebu Hurejre, radijall-llahu anhu, tregon se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Ai që mëson një dije e cila duhet të mësohet për All-llah, kurse e mëson për të fituar mirësi të kësaj bote nuk do të nuhat aromën e xhennetit në Ditën e Kijametit". (Sahih, Ebu Davudi).

Abdullah ibën Mesudi, radijall-llahu anhu, ka thënë: "Si do të jetë gjendja juaj kur do t'ju kaplojnë fitnet nga çdo anë. Në te do të rriten të vegjlit dhe do të plaken të vjetrit e do të bëhen adete të pasuara, e nëse ndryshohen do të thuhet: kjo gjë është vepër e keqe. I kanë thënë: kur do të ndodh kjo? Tha: kur do të pakësohen besnikët, të shtohen kryetarët, të pakësohen fukahatë (dijetarët e fesë), të

shtohen kur'atë (lexuesit e Kur'anit), ta mësojnë njerëzit fenë jo për fe dhe kur të dëshirojnë ta fitojnë dynjanë me vepra të ahiretit". (Sahih, Daremiu). Hasan Basriu, rahimehull-llah, ka thënë: "Dënimi i dijetarit është vdekja e zemrës. I kanë thënë" ç'është vdekja e zemrës? Tha: kërkimi i dynajsë me vepra të ahiretit".

Xhafer ibën Muhamedi ka thënë: "Nëse shihni një dijetar që e do dynajnë akuzone në fenë e tij, sepse secili njeri atë që do me te edhe mirret".

Sufjan Theuriu ka thënë: "Njeriu mëson fenë që të ketë frikë All-llahun, andaj edhe i është dhënë përparësi dijes para veprave tjera, sepse me të njeriu i frikohet All-llahun".

Gjithashtu thoshte: "Stolisne dijen dhe mos u stolisnu me dije". (Shiko: "Xhamiu Bejanul-ilmu ve Fadluhu", 1/ 191).

Imam Dhehebiu, rahimehull-llah, duke folur në jetëshkrimin e Hisham Ed-Destuvaiut, rahimehull-llah, thotë:

"Ishte Hafidh, Huxhe, Imam, Sadik, Ebu Bekër, Hisham ibën Ebu Abdullah El-Basri Er-Rebii, tregtar i rrobave nga Destu, kurse Destu ishte një vend në Ahvaz.

Aun Ibën Umare thotë: kam dëgjuar Hisham Destuvaiun duke thënë: "Pasha All-llahun nuk mund të them se ndonjë herë kam kërkuar hadithin sinqerisht për All-llahun".

Imam Dhehebiu thotë: Pasha All-llahun as unë nuk mund të them për veten. Selefii kërkoni dijen për All-llah andaj edhe u dalluan e u bënë imamë që pasoheshin. Kishte njerëz që në fillim nuk e kërkoni dijen për All-llah, e fituan dhe u dalluan me të, pastaj llogaritën vetveten e kjo dije i shpiu në sinqeritet. Muxhahidi dhe të tjerët kanë thënë:

"Kërkuam dijen jo për All-llah, mirëpo dija insistoi që të jetë vetëm për All-llah".

Ka njerëz që e kanë kërkuar dijen me qëllim të keq dhe për dynja e që të lavdërohen,

andaj ata fitojnë atë që kanë patur për qëllim. Kjo kategori e njerëzve nuk janë ndriçuar me dritën e dijes, nuk len mbresa në zemër dhe nuk jep fryta të mëdha, kurse dijetar është ai që ia ka frikën All-llahun.

Disa njerëz tjerë kanë marrë dije dhe kanë fituar pozita, mirëpo bënë zullum, nuk iu përmbanë dijes, bënë mëkate të mëdha dhe vepra imorale, të mallkuar qofshin, ata nuk janë dijetarë.

Disa të tjerë nuk kanë frikë All-llahun në dijen e tyre por i përdorin hilet, japin fetva me lehtësime, transmetojnë transmetimet jo të sakta, madje disa shpifin mbi All-llahun dhe gënjejnë mbi Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, për këtë All-llahu ia çeri perdën, i iku dija dhe u bë zahireja e tij për në zjar.

Të gjitha këto grupe kanë transmetuar prej dijes shumë gjëra, janë zhytër në te, mirëpo pas tyre erdhën njerëz që kishin mungesë të qartë në dije dhe vepra. Pas tyre erdhën njerëz që lidhja e tyre me dijen ishte vetëm sipërfaqësore, prej tij vetëm pak kishin marë, u shtirën sikurse janë dijetarë të ndershëm, asnjëher nuk u shkoj ndërmend se me këtë vepër i afrohen All-llahun, sepse nuk kanë parë ndonjë hoxhë të cilin duhet ta pasojnë në dije e u bënë si masa e gjërë. Qëllimi i mësuësit nga ky tabor është të posedojë libra të çmueshëm që i deponon për të shikuar ndonjë herë, i deformon gjërat që i citon dhe nuk i analizon mirë. All-llahun e lusim të na jep shpëtim dhe falje...". ("Sijer", 7/152).

Dija është çelësi i veprës dhe udhëheqësi i tij, baza mbi të cilën ngritet vepra, andaj duhet të jetë i sinqertë për All-llahun që të jetë i pastër dhe të jep si fryta veprat e mira, të cilat shpresojmë se do të pranohen te All-llahu, azze ve xhel-le.

Duhet sinqeriteti në kërkimin e dijes, kurse kjo arrihet duke bërë nijet që kërkimin e dijes ta bësh vetëm për All-llah, ta largosh injoran-

cën nga vetja dhe tjerët, ta mbrosh sherijatin nga sulmet e ndryshme dhe të egra për ta shmëtuar, falsifikuar dhe ngatërruar.

Vazhdojmë në këtë hutbe me elementet tjera që janë pengesa dhe defekte në rrugën e dijes.

2- Fshehja e dijes

Defekti i dytë në këtë rrugë është fshehja e dijes, fshehja e asaj që ta ka mësuar All-llahu, azze ve xhel-le, dhe me këtë vepër përhapet injoranca dhe mbetet dominante injoranca.

All-llahu, tebareke ve teala, thotë: "Ata, të cilët fshehin argumentet dhe faktet që Ne i shpallëm, e pasi që ato ua sqaruam njerëzve në librin, të tillët i mallkon All-llahu, i mallkojnë edhe ata që mallkojnë". (El-Bekare: 159).

Imam Kurtubiu, rahimehull-llah, duke e komentuar këtë ajet thotë: "All-llahu, azze ve xhel-le, tregon se ai që i fsheh faktet dhe udhëzimin që ka shpallur është i mallkuar... Është për qëllim secili që e fsheh hakun dhe e kaplon secilin që fsheh dijen e fesë së All-llahu dhe e cila ka nevojë të përhapet... Këta njerëz i mallkon All-llahu, domethënë distancohet prej tyre dhe i largon nga shpërblimi dhe i mallkojnë këta njerëz edhe melaqet edhe njerëzit". (shiko: "El-Xhamiu liAhkamil-Kuran", 2/189).

Ahmed Shakiri, rahimehull-llah, në librin e tij "Umdetut-Tefsir" thotë: "Ky ajet është kërcënim i ashpër ndaj atij që fsheh argumentet e qarta, objektivat e shëndosha dhe udhëzimin e dobishëm për zemrat e njerëzve të cilat i kanë sjellur pejgamberët". (Shiko: "Umdetut-Tefsir", 1/ 279).

All-llahu, subhanehu ve teala, thotë: "Ata që fshehin nga libri atë që shpalli All-llahu dhe për të fitojnë shumë të paktë, ata në barqet e tyre fusin vetëm zjarr. Atyre All-llahu nuk do t'u flasë në ditën e gjykimit dhe as nuk i shfajëson ata, por për ta pason dënimi i rëndë e i padurueshëm. Ata janë që në vend

të udhëzimit e morën humbjen dhe dënimin në vend të shpëtimit. Sa të durueshëm qenkan ata ndaj zjarrit?". (El-Bekare: 174-175).

Abdurahman Sadiu, rahimehull-llah, thotë:

"Ky ajet është kërcënim i ashpër ndaj atij që i fsheh ato që ia ka shpallur All-llahu, subhanehu ve teala, pejgamberëve të Vet dhe dijen, gjë për të cilën All-llahu ka marrë besën nga bartësit e tij se do tua përhapin njerëzve dhe nuk do ta fshehin, andaj ai që e zëvendëson këtë gjë me gjëra të kësaj dynjaje dhe e lanë pas dore urdhërin e All-llahut, këta: "... ata në barqet e tyre fusin vetëm zjarr", sepse këtë pasuri që kanë fituar e kanë fituar në mënyrë më të keqe dhe me ndalesat më të mëdhaja, andaj edhe shpërblimi i tyre ishte sipas llojit të veprës së tyre. Këtyre njerëzve nuk u flet All-llahu, është i mllëfosur me ta, ua ka kthyer shpindën, kurse kjo është më e dhimbshme se denimi i zjarrit... Këta njerëz që kanë braktisur Kur'anin, ia kanë kthyer shpinën, kanë zgjedhur devijimin e jo udhëzimin, denimin e jo faljen, këta njerëz vetëm zjarin e meritojnë, mirëpo si e durojnë?!" (Shiko: "Tejsirul-Kerimir-Rahman", fq. 65).

All-llahu, tebareke ve teala, thotë: "Dhe kur All-llahu mori zotimin nga ata që iu pat dhënë libri: që gjithqysh t'ua publikoni atë njerëzve, e të mos e fshehni, por ata e lanë pas dore atë për pak send të kësaj jete; pra, bënë punë të keqe". (Ali Imran: 187).

Imam Ibën Kethiri, rahimehull-llah, thotë: "Në këtë ajet ka vërejtje për dijetarët që mos të ecin rrugës së tyre e tu ndodh ajo që u ka ndodhur atyreve që kanë qenë para tyre, andaj dijetarët e kanë për detyrë që të përhapin dijen e dobishme që shpie në vepra të mira dhe mos të fshehin asgjë prej saj". (Shiko: "Tefsirul-Kuranil-Adhim", 1/436).

Hasani dhe Katadeja thonë: "Ky ajet vlen për secilin që ka dije mbi fenë, andaj ai që di diçka prej fesë duhet tua mësojë tjerëve dhe ruajuni nga fshehja e dijes, sepse këtu qëndron shkatërrimi.

Muhamed ibën Kabi, rahimehull-llah, thotë: "Dijetarit nuk i takon që të heshtë dijen e as injorantit që ta heshtë injorancën e vet". (Shiko: Tefsirin e Imam Kurtubiut, 4/313).

Imam Sadiu, rahimehull-llah, thotë: "Mithaku, beslidhja është marëveshja e rëndë dhe e sigurtë. Këtë beslidhje e ka bërë All-llahu me secilin që i ka dhënë libra dhe i ka mësuar dijen që tua sqarojnë njerëzve gjërat për të cilat kanë nevojë dhe mos ta fshehin e as mos të jenë koprrac në këtë drejtim, sidomos nëse e pyesin për ndonjë gjë ose u ndodh diçka që ua detyron këtë gjë, sepse secili që ka dije, e ka obligim tua sqarojë njerëzve atë gjendje dhe tua bën të qartë të vërtetën nga e kota. Të sukseshmit e kanë kryer këtë detyrë në mënyrën më të plotë, ua kanë mësuar njerëzve atë që ua ka mësuar All-llahu duke e shprehur kënaqësinë e Zotit të tyre, nga dhembshuria ndaj njerëzve dhe nga frika e mëkatit të fshehjes së dijes". (Shiko: "Tejsirul-Kerimir-Rahman", fq. 127).

All-llahu, subhanehu ve teala, i drejtohet Pejgamberit të Tij dhe duke e edukuar umetin e tij: "O ti i dërguar! Komunikojë atë që t'u zbrit prej Zotit tënd, e nëse nuk bën (kumtimin në tërësi), atëherë nuk e ke kryer detyrën (revalatën-risalen). All-llahu të garanton mbrojtjen prej njerëzve (prej armiqve). All-llahu nuk vë në rrugë të drejtë popullin që mohon". (El-Maide: 67).

All-llahu, azze ve xhel-le, e detyron Pejgamberin e Tij, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, që ta publikon fenë dhe mos të fsheh asgjë prej saj pa marë parasysh gjendjen dhe situatën në të cilën gjindet dhe rezikun i cili i

kanoset, sepse All-llahu është ai që mbron ate.

Imam Kurtubi, rahimehull-llah, thotë: "Kështu e edukon All-llahu, azze ve xhel-le, Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, dhe bartësit e dijes nga umeti i vet që mos të fshehin asgjë nga sherijati". (shiko: "Tefsirin e Imam Kurtubiut", 6/230).

Transmeton Imam Buhariu dhe Imam Muslimi nga Aisheja, radijall-llahu anha, e cila ka thënë: "Ai që kujton se Resulullahi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka fshehur diçka nga Libri i All-llahut ka bërë shpifje të madhe ndaj All-llahut, spese All-llahu, azze ve xhel-le, ka thënë: "O ti i dërguar! Komunikojë atë që t'u zbrit prej Zotit tënd, e nëse nuk bën (kumtimin në tërësi), atëherë nuk e ke kryer detyrën (revalatën-risalen)...". (El-Maide: 67).

Këto ajete të qarta flasin për rezikun e madh që sjell fshehja e dijes për ata që e bëjnë këtë vepër dhe se secili njeri të cilin All-llahu e ka begatuar me dije duhet ta përhap ate. Këtë gjë shumë mirë e kanë kuptuar sahabet e Muhammedit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, andaj edhe janë përhapë anë e mbanë botës për ta përhapur këtë fe, kanë braktisur vendet më të dashura për ta, sikurse është Mekeja dhe Medineja dhe kanë lërë eshtrat e tyre anë e mbanë ruzullit tokësor, krejt këtë e kanë bërë nga dëshira për ta zbatuar këtë urdhër dhe nga frika e madhe që kanë patur nga ky kërcënim.

Ti sjellim dy shembuj se sa mirë dhe qartë i kanë kuptuar këto ajete sahabet e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, e ata janë Ebu Hurejre dhe Ebu Dherri, radijall-llahu anhum.

Transmeton Imam Buhariu, rahimehull-llah, se Ebu Hurejre, radijall-llahu anhu, ka thënë: "Njerëzit thonë: e ka tepruar me transmetime Ebu Hurejre, po mos të ishin dy ajete në Kur'an asgjë nuk do t'ju transmetoja, pastaj

lexoi: "Ata, të cilët fshehin argumentet dhe faktet që Ne i shpallëm, e pasi që ato ua sqaruar njerëzve në librin, të tillët i mallkon All-llahu, i mallkojnë edhe ata që mallkojnë. Përveç atyre që pendohen, që përmirësohen dhe që u shpjegojnë njerëzve (të vërtetën), të tillëve ua pranoj pendimin, se Unë pranoj shumë pendimin, jam mëshirues". (El-Bekare: 159- 160).

Domethënë: po të mos ishin këto ajete që e qortojnë fshehjen e dijes nuk do të kishte transmetuar aspak hadithe, mirëpo pasiqë fshehja e dijes është e ndaluar u bë obligim përhapja e tij, andaj edhe kishte shume transmetime prej tij, sepse dinte shumë hadithe.

Transmeton Buhariu nga Ebu Dherri, radijall-llahu anhu, i cili ka thënë: "Po të vëndonit shpatën në këtë qafë dhe pastaj mendoj se mund të them ndonjë fjalë që kam dëgjuar nga Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, para se të më hiqet koka, do ta kisha thënë".

Dijetarët dhe imamët janë kujdesur që tua kujtojnë nxënësve gjat sqarimit të edukatës së nxënies së dijes edhe nevojën e publikimit dhe kumtimit të fesë dhe ua kanë tërhjekur vërejtjen nga fshehja e dijes.

Imam Ibën Kethiri, rahimehull-llah, thotë: "Nxënësi i dijes duhet të jetë i dobishëm për nxënësit tjerë dhe nuk duhet të fshehë dijen, sepse kanë ardhur shumë ajete dhe hadithe që e ndalojnë një vepër të tillë". (Shiko: "Baithul-Hathith", fq. 133).

Në vijim ti përmendim edhe disa hadithe që flasin për këtë temë.

Ebu Hurejre, radijall-llahu anhu, tregon se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Kush pyetet për një dije dhe e fsheh do të frerohet në Ditën e Gjykimit me frerë nga zjari". (Sahih, transmeton Ebu Davudi, Tirmidhiu, etj.).

Ebu Hurejre, radijall-llahu anhu, tregon se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Shembulli i atij që mëson dijen dhe

pastaj nuk e tregon ate është sikur shembulli i atij që mbledh thesar mirëpo nuk shpenzon prej tij". (Hasen, Taberaniu).

Ai që e mbyll gojën dhe nuk e thot fjalën e vërtetë i mbyllet goja me frerë të zjarit të xhehenemit, domethënë sikur vepra ashtu edhe denimi.

Kjo vlen për raste dhe çështje që domosdo duhet sqaruar njerëzve, ose për raste kur një jomusliman interesohet për Islamin, ose për një njeri që rishtazi ka hyrë në fe dhe nuk di të falet ose nuk i di obligimet kryesore fetare, dhe pyet, atëherë ai që pyetet e ka obligim tia sqarojë këto gjëra dhe nëse nuk e bën këtë vepër e meriton këtë denim.

Shejh Hamid Fekihu, rahimehull-llah, thotë:

"Kjo vlen edhe në situatë kur është përhapur injoranca dhe dominojnë besimet e kota, bidatet, bestytnitë, adetet e flliqura, imitimi i jomuslimanëve, adeteve dhe principeve të tyre, të cilat e shkatërrojnë fenë, moralin dhe nderin, në këso raste obligimi më i madh i dijetarëve që kanë marrë trashëgiminë e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, që të japin maksimalisht mundin e tyre për ta përhapur këtë dije në mesin e familjes, vëllezërve, fisit dhe popullit të tyre me shpresë së do të bëhet shkak që ti shpëtojë All-llahu nga devijimi dhe hidhërimi i All-llahut.

Tregon Ibën Abdul-Berri, rahimehull-llah, se Selim ibën Amiri ka thënë: Ebu Umamete na tregonte shumë hadithe e pastaj thoshte: a i kuptuat? I thonim: po. Thoshte: kumtoni prej meje këtë që ua kam mësuar.

Ibën Kasimi, rahimehull-llah, thotë: "Imam Maliku kur na përshëndetke gjatë ndarjes na thoshte: keni frikë All-llahun dhe përhapne këtë dije, mësojani njerëzve dhe mos e fshehni". (Shiko: "Xhamiu Bejanil-Ilmi", 1/ 123).

Normalisht se dijen duhet përhapur atij që e meriton dhe për këtë jemi duke folur, kurse

nëse dikush nuk e meriton, atëherë nuk është mëkat që atij mos ti jepet ajo dije.

Shejh Ahmed Shakiri, rahimehull-llah, thotë:

"Përhapja e dijes është obligim dhe nuk lejohet fshehja e tij, mirëpo është e veçantë për ata që e meritojnë, andaj dijetarët e kanë lejuar që mos ti jepet atyreve që nuk janë të gatshëm ta marrin dhe atyreve që insistojnë në gabim edhe nëse e kuptojnë të vërtetën.

Një dijetarë e kanë pyetur për një çështje, kurse ai nuk i ka dhënë përgjigje, e pyetësia ia ka përmendur hadithin: "Kush pyetet për një dije dhe e fsheh do të frerohet në Ditën e Gjykimit me frerë nga zjarri". (Sahih, transmeton Ebu Davudi, Tirmidhiu, etj.).

Dijetari ia ktheu duke i thënë: Ieri këto frerë këtu dhe shko, e kur të vjen dikush që kupton e nuk i tregoj le të më lidh me këta frerë.

Disa dijetarë kanë thënë: "zgjedhi kërkuesit e dijes tënde ashtu sikurse i zgjedh kërkuesit e vajzave tuaja". (Shiko: "El-Baithul-Hathith", fq. 133).

3- Të flasish mbi All-llahun pa dije

Faja është amanet, dija e fesë është amanet, andaj ai që nisat në rrugën e dijes duhet ta dijë se ka marrë përsipër një amanet shumë të madh dhe për te do të jep llogari nëse nuk e kryen ashtu si duhet.

Të flasish mbi fenë e All-llahut është sikur të flasish në emër të All-llahut dhe mbi All-llahun, andaj edhe sinqeriteti dhe vërtetësia janë mëse të domosdoshme dhe pa to pikëpyetje e madhe se sa ky njeri është kërkues i denjë i dijes fetare.

Sot ballafaqohemi me shumë raste kur njerëzit flasin në emër të fesë dhe në Emër të All-llahut pa ndonjë argument të fuqishëm ose të qartë nga Kur'ani apo Sunneti i Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, andaj edhe kjo bëhet shkak që ky njeri veten ta shpjen në devijim, por edhe tjerët.

Për këtë peshë të madhe që ka folja mbi fenë e All-llahut dhe kujdesi i madh që duhet të kenë ata që thirren në emër të njohjes së fesë, Imam Ibën Kajim El-Xhevziu ka shkruar një libër me titull "A'lamul-Muvekiine an rabil-Alemine", ku tregon se të japish fetva ose të flasish në emër të fesë është sikur të nënshkruash në emër të Zotit, andaj edhe duhet patur kujdes shumë të madh në këtë drejtim.

Imam Ibën Kajimi, rahimehull-llah, në këtë libër mes tjerash thotë (fq. 8-9): "Pasi që kumtimi prej All-llahut mbështetet në njohjen e asaj që e kumton dhe vërtetësinë në transmetim, atëherë nuk është meritë për ta bërë këtë vepër akush përpos atij që është cilësuar me dije dhe vërtetësi, të di atë që kumton dhe të jetë i vërtetë në te. Shtoja kësaj edhe mënyrën e mirë e jetesës dhe sjelljen e mirë, të jetë i drejtë në fjalët dhe veprat e tij, jeta e tij sekrete dhe publike të jetë e njejtë, gjatë hyrjes dhe daljes dhe në të gjitha gjendjet e tij mo stë këtë dallim. Nëse posti i atij që nënshkruan në emër të mbretit është një post që nuk mund ti mohohet vlera dhe t'i injorohet pozita dhe konsiderohet prej posteve më të larta, vallë çka do të kishim thënë për postin e nënshkrimit në emër të Zotit të tokës dhe qiejve? Andaj, ai i cili e ka marrë këtë post duhet të përgaditet mirë dhe ta dijë pozitën e postit që ka dhe nuk duhet të ngushtohet nga thënia e të vërtetës dhe publikimin e sajë, sepse All-llahu ka për ta ndihmuar dhe udhëzuar".

Të flasish mbi All-llahun pa dije domethënë të gënjeshtër mbi All-llahun, azze ve xhel-le, kurse këtë eskuzivitet nuk ia ka dhënë askujt, saqë edhe mikut dhe Pejgamberit, të tij, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, nuk i ka dhënë e i ka thënë: "Sikur të trillonte ai (Muhammedi) për Ne ndonjë fjalë! Ne do ta kapim atë me të

Djathtën Tonë. E pastaj do t'ia këputnim atij arterien e zemrës". (El-Haka: 44- 46).

Ibën Kethiri, rahimehull-llah, duke e komentuar këtë ajet thotë: "Nëse Muhammedi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka shpifur mbi All-llahun, i ka shtuar shpalljes gjëra dhe ka pakësuar prej saj ose ka thënë diç nga vetja dhe ia ka mveshur All-llahut, sikurse dikush pretendon, do tia shpejtojmë denimin".

Pasiqë edhe Muhammedit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, i është dhënë ky kërcënim, atëherë çka mbetet për ne tjerët që mudo-hemi të jemi zëvendësit e tij, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem!

Edhe përshkrimi i denimit ka atë ndikimin e vet, andaj Zamahsheri thotë se ai që mundohet të trillon mbi All-llahun denohet ashtu sikurse i denojnë mbretërit ata që trillojnë mbi ta, duke i mbytur dalngadal, të lidhur në pranga dhe duke u shijuar llojloj mundimesh dhe torturash. Qëllimi nga kjo është për të treguar se sa vepër e shëmtuar është të gënjesht mbi një qenie shumë të madhe sikurse është All-llahu, tebareke ve tealë. (shiko: "El-Keshaf", 4/155).

All-llahu, subhanehu ve tealë, thotë: "E kush është më gabimtar i madh se sa ai që trillon rrenë ndaj Zotit, ose thotë: "Mua po më shpallet e nuk i është shpallur asgjë, ose se sa ai që thotë: "Do të thur diçka të ngjashme me atë që e ka zbritur All-llahu". E, sikur t'i shihje mizorët kur janë në agoni të vdekjes, e engjëjt kanë shtrirë duart e veta (me ndëshkim) e (u thonë): "Shpëtojeni pra vetveten (nëse mundeni)". "Tash përjetoni dënimin e turpshëm për shkak se e thoshit të pavërtetën për All-llahun, dhe ndaj argumenteve të Tij ishit kryeneç". (El-Enam: 93).

Imam Kurtubiu, rahimehull-llah, duke e komentuar këtë ajet ka thënë: "Nga kjo kategori e njerëzve janë ata që kanë braktisur fikhun dhe sunetet dhe atë në të cilën kanë

qenë selefi e thotë: më ka ardhë një ide se duhet vepruar kështu, ose më flet zemra se kështu duhet thënë, etj. e gjykojnë sipas asaj që u flen në zemër ose u dominon si ide, duke supozuar se kjo u vjen atyreve nga pastërtia nga njollat dhe zbrazja nga xhelozia, e u shfaqen atyreve shkenca dhe të vërteta hyjnore dhe i mësojnë sekretet gjenerale dhe i dinë detalet e imta, andaj nuk kanë nevojë për dispozitat e gjenerale të fesë e thonë: këto janë dispozita të përgjithshme fetare dhe me to gjykohet masa e gjërë dhe e thjeshtë, kurse evlijata dhe njerëzit e veçantë, ata nuk kanë nevojë për këto citate dhe tekstse". (Shiko: "El-Xhamiu Liahkamil-Kurani", 7/ 41).

Imam Abdurrahman Sadiu, rahimehull-llah, thotë: "Nuk ka njeri që bën zullum dhe krim më të madh se sa ai që trillon mbi All-llahun duke i mveshur fjalë apo dispozitë nga të cilat Ai është i pastër. Ky njeri është më zullumqari sepse gënjen dhe ndryshon fenë, bazën dhe degët e saja dhe ia mvesh këtë All-llahut. Kjo vepër është shumë e dëmshme". (shiko: "Tej-sirul-Kerimir-Rahman", fq. 226).

All-llahu, tebareke ve tealë, thotë: "Mos i thuani asaj rrenës së gjuhve tuaja: "Kjo është hallall e kjo është haram" e të shpifni ndaj All-llahut rrenën. Vërtet, ata që shpifin rrenën ndaj All-llahut, nuk kanë shpëtim. Kanë një përjetim të vogël (në këtë jetë), e do të kenë dënim të padurueshëm". (En-Nahl: 116- 117).

Kërcënime të njëpasnjëshme dhe shumë të rëndë ndaj atyreve që marrin guximin të fusin në fe gjëra që s'janë të saja dhe të nxjerin prej fesë gjëra që janë pjesë integrale dhe shumë e rëndësishme e saj. Fatkeqësisht në këtë kohë kjo vepër shumë shpesh haset në shumë vende dhe raste.

Imam Ibën Kethiri, rahimehull-llah, thotë: "All-llahu, azze ve xhel-le, u ka ndaluar muslimanëve që të ecin rrugës së idhujtarëve,

të cilët bënë hallalle dhe harame me gjuhën dhe përshkrimet e tyre dhe sipas mendimeve të tyre. Në këtë hyn edhe secili që ka shpikur bidate që skanë mbështetje fetare, ose ka lejuar atë që ka ndaluar All-llahu, ose ka ndaluar atë që ka lejuar All-llahu, sipas mendimit dhe epshit të vet. Pastaj e dha kërcënimin e vet duke thënë: "Vërtet, ata që shpifin rrenën ndaj All-llahut, nuk kanë shpëtim". Domethënë as në dynja e as në ahiret. Nëse përjetojnë ndonjë afatizim të shkurtër në dynja, ata i pret denim i madh dhe i dhembshëm në ahiret". (Shiko: "Tefsiri i Ibën Kethirit", 2/ 590).

Në këtë që flasim përpos gënjeshtres mbi All-llahun hyn edhe gënjeshtra mbi Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem. Ky veprim fatkeqësisht ka ndodhur me të madhe pas brezave të artë të islamit, andaj në shumë kohëra janë paraqitur njerëz që kanë trilluar dhe shpifur hadithe duke ia atribuar Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem. Edhe ato hadithe njihen sikur hadithe meudu, të trilluara dhe të shpifura. Mirëpo dijetarët e hadithit e kanë kryer një mision shumë të ndershëm dhe të pastër dhe kanë klasifikuar këto hadithe dhe ua kanë bërë të ditur muslimanëve se cilat janë ato hadithe të trilluara dhe apokrifet, andaj në to nuk duhet aspak të mbështetemi e as ti citojmë në shkrimet dhe fjalimet tona para njerëzve.

Edhe pse dijetarët e hadithit kanë bërë këtë vepër shumë të ndershme dhe kanë dhënë një mund jashtëzakonisht të madh në këtë drejtim, ne akoma kemi njerëz që mbështeten në këso lloj hadithesh për të promovuar rregulla apo veprime fetare.

Andaj për ata që i kanë trilluar këto hadithe dhe ata që i përhapin me vetëdije apo pa te vlejné hadithet që do ti përmendim më poshtë. All-llahu na ruajte!

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Gënjeshtra mbi mua nuk është

sikur gënjeshtra mbi ndokend tjetër, andaj ai që gënjen mbi mua qellimisht le të përgadit për vete një karige të xhehenemit". (Buhariu dhe Muslimi).

Ky hadith është mutevatir, domethënë e transmetojnë një numër shumë i madh i transmetuesve që nuk u mundëson atyreve që të bashkohen në gënjeshtër. Hadithi mutevatir është i padiskutueshëm në vërtetësinë tij dhe i padiskutueshëm në zbatimin e tij në jetën tonë të përditshme.

Për këtë do të kishte mjaftuar kjo që të jemi shumë të kujdesshëm kur flasim për fenë e All-llahut, tebareke ve teala, dhe kur flasim në emër të Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, sepse përndryshe në është bërë gati vendi ynë në zjarin e nxehtë të xhehenemit, Zoti na ruajtë!

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Mos gënjeni mbi mua, sepse ai që gënjen mbi mua do të hyjë në zjar". (Buhariu dhe Muslimi).

Imam Ibën Haxher El-Askalani, rahimehull-llah, thotë: "Mos gënjeni mbi mua", i kaplon të gjitha gënjeshttrat dhe të gjitha llojet e saja dhe domethënë mos më mveshni mua gënjeshtra.

Disa injorantë janë mashtruar dhe kanë shpikur hadithe për të stimuluar në vepra të mira dhe për të frikësuar nga veprat e këqija e kanë thënë: ne nuk gënjejmë kundër Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, por këtë e bëjmë për ta ndihmuar sherijatin e tij, mirëpo ata si duket nuk kanë ditur se ti mveshish Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, gjëra që si ka thënë domethënë të gënjeshtro mbi All-llahun, sepse është nxjerje e një dispozite fetare qoftë për detyrim apo për pëlqim edhe e kundërta për haram apo mekruh...". (Shiko: "Fet'hul-Bari", 1/241).

All-llahu, xhel-le shanuhu, ka ndaluar në mënyrë kategorike dhe të rreptë të flasish

mbi Te dhe e ka konsideruar haram të qartë, duke thënë: "Thuaj: "Zoti im i ndaloi vetëm të këqijat e turpshme, le të jenë të hapta ose të fshehta, ndaloi mëkatin, ndaloi shtypjen e tjetrit pa të drejtë, ndaloi t'i mvishni All-llahut shok pa patur për të kurrfarë argumenti, dhe ndaloi të thoni për All-llahun atë që nuk e dini se është e vërtetë". (El-A'raf: 33).

Imam Ibën Kajimi, rahimehull-llah, duke e komentuar këtë ajet thotë: "Të flasish mbi All-llahun pa dije, kjo është prej ndalesave dhe mëkateve më të mëdhaja, andaj është përmendur në kategorinë e katërt të ndalesave rreth të cilave janë pajtuar fetë dhe ligjet dhe nuk lejohen në asnjë rast dhe nuk i ngjajnë coffinës, gjakut apo mishit të dërrit të cilat në rast reziku dhe domosdoshmëria edhe lejohen.

Ndalesat janë dy lloje:

a) Ndalesat për vet subjektet; të cilat nuk lejohen në asnjë rast

b) Ndalesat objektive, të cilat janë të ndaluara në rrethana dhe kohëra të caktuara.

Për ndalesat subjektive, All-llahu, xhel-le shanuhu, ka thënë: "Thuaj: "Zoti im i ndaloi vetëm të këqijat e turpshme, le të jenë të hapta ose të fshehta,..."". Pastaj kaloi në ato mëkate që janë më të mëdhaja: "... ndaloi mëkatin, ndaloi shtypjen e tjetrit pa të drejtë, ...". Pastaj kaloi në atë që është edhe më i madh se këto: "...ndaloi t'i mvishni All-llahut shok pa patur për të kurrfarë argumenti,..."". Më në fund kaloi te ajo që është edhe më e madhe: "... dhe ndaloi të thoni për All-llahun atë që nuk e dini se është e vërtetë". (El-A'raf: 33). Kjo është ndalesa dhe mëkati më i madh, sepse përmban gënjeshtrën mbi All-llahun dhe mveshjen e gjërave që nuk i përkasin, ndryshimin e fesë, mohimin e asaj që ka konfirmuar dhe konfirmimin e asaj që ka mohuar, pohimin e asaj që e ka mohuar dhe mohimin e asaj që e ka pohuar, armiçësimin e asaj që e ka miqësuar

dhe miqësimin e asaj që ka armiçëqsuar, dashurinë e asaj që ka urrejtur dhe urrejtjen e asaj që ka dashur dhe përshkrimin ashtu si nuk e meriton dhe përket në Qenien, Cilësitë, Fjalët dhe Veprat e Tija.

Në llojen e ndalesave, haramave, nuk ka ndalesë më të madhe se kjo te All-llahu e as mëkat më të rëndë, sepse është baza e kufirit dhe shirkut, themeli i bidatit dhe devijimeve, pasi që çdo bidat devijues në fe ka themel foljen për All-llahun pa dije.

Andaj selefi dhe imamët e kanë refuzuar këtë dukuri me të madhe, u kanë bërë titur këtyre njerëzve në mbarë ruzullin tokësor dhe ua kanë tërëzve vërejtjen njerëzve nga fitneja e tyre në mënyrë të rreptë. Kanë vepruar në këtë drejtim aq shumë sa që nuk kanë vepruar kështu me veprat imorale, zullumin dhe armiçësinë, sepse dëmi i bidateve, rrënimi i tyre fesë dhe kundërshtimi tyre me fënë janë shumë më të rënda.

All-llahu, tebareke ve tealë, u ka mohuar njerëzve të drejtën të shpallin hallallë dhe harame pa argumente nga Ai, duke thënë:

"Mos i thuani asaj rrenës së gjuhëve tuaja: "Kjo është hallall e kjo është haram" e të shpifni ndaj All-llahut rrenën. Vërtet, ata që shpifin rrenën ndaj All-llahut, nuk kanë shpëtim. Kanë një përjetim të vogël (në këtë jetë), e do të kenë dënim të padurusshëm". (En-Nahl: 116- 117).

E çka mund të themi për atë që i mvesh All-llahut, azze ve xhel-le, gjëra që me to nuk e ka përshkruar Vetveten?! Ose i mohon ato cilësi që me to e ka përshkruar Vetveten?!

Disa dijetarë të selefit kanë thënë: Kujdes, mos të thotë dikush prej jush: këtë e ka bërë hallall All-llahu kurse këtë e ka bërë haram e t'ju thotë All-llahu: ke gënjyer, nuk kam lejuar këtë e as ndaluar atë.

Ka për qëllim lejimin dhe ndalimin në bazë racionale dhe pa argumente nga All-llahu dhe Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem.

Baza e kufrit dhe shirkut është folja për All-llahun pa dije, sepse idhujtari mendon se ai që adhurin dikend përpos All-llahut me te i afrohet All-llahut, i ndërmjetëson te Ai dhe kryhet nevoja e tij me ndërmjetësimin e tij, ashtu sikurse janë ndërmjetësimet te mbretërit, andaj secili idhujtar flet për All-llahun pa dije...

Për këtë të gënjesh mbi Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, është shkak për të hyrë në xhehenem dhe për të zërë vend atje, vend i cili nuk ndahet kurrë prej tij, sepse ka bërë gabim trashanik, ka folur për All-llahun pa dije, pasi që të gënjesh mbi Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, është sikur të flasish mbi Ate që e ka dërguar...". (Shiko: "Medarixhus-Salikin", 1/372).

Në një vend tjetër thotë: "All-llahu, subhanehu ve teala, ka ndaluar të flitet për All-llahun pa dije në fetva dhe vendimmarrje dhe e ka konsideruar prej ndalesave më të mëdhaja, madje i ka dhënë gradën më të lartë në mesin e këtyre ndalesave, duke thënë: "Thuaj: "Zoti im i ndaloi vetëm të këqijat e turpshme, le të jenë të hapta ose të fshehta, ndaloi mëkatën, ndaloi shtypjen e tjetrit pa të drejtë, ndaloi t'i mvishni All-llahut shok pa patur për të kurrfarë argumenti, dhe ndaloi të thoni për All-llahun atë që nuk e dini se është e vërtetë". (El-A'raf: 33).

Në këtë ajet i kategorizoi ndalesat në katër kategori. Filloi me më të lehtë: veprat imorale, pastaj kaloi në kategorinë e dytë që është edhe më e ndaluar: mëkati dhe zullumi, pastaj kaloi në kategorinë e tretë që është edhe më e keqe dhe e rëndë: idhujtaria dhe pastaj kaloi në kategorinë e katër që është kategoria më e rëndë dhe më e keqe se të gjitha këto kategori, e ajo është: folja për All-llahun pa dije. Me këtë nënkuptohet folja për

All-llahun pa dije mbi Emrat, Cilësitë dhe Veprat e Tija, mbi fenë dhe sherijatin e Tij.

All-llahu, subhanehu ve teala, thotë:

"Mos i thuani asaj rrenës së gjuhve tuaja: "Kjo është hallall e kjo është haram" e të shpifni ndaj All-llahut rrenën. Vërtet, ata që shpifin rrenën ndaj All-llahut, nuk kanë shpëtim. Kanë një përjetim të vogël (në këtë jetë), e do të kenë dënim të padurueshëm". (En-Nahl: 116- 117).

U ofroj All-llahu, azze ve xhel-le, kërcënim atyreve që gënjejnë mbi Te në dispozitat e Tija dhe thënia e tyre për gjërat që nuk i ka ndaluar: këto janë të ndaluara e për ato që nuk i ka lejuar: këto janë të lejuara. Kjo është sqarim prej All-llahut se njeriut nuk i lejohet të thotë se kjo është hallall e kjo haram, nëse nuk e di se a thua me të vërtetë All-llahu i ka lejuar dhe ndaluar ato gjëra". ("A'lamul-Muvekiin", fq. 31).

4- Futja me zor në mesin e dijetarëve

Dija është dhuratë hyjnore për ata që kanë zemër të dliirë, për ata që nuk janë mendjemë-dhenjë dhe kokëllartë. Por është edhe sprovë e madhe për ata që nuk janë të sinqertë, që mburren dhe shumë gjëra i pretendojnë.

Secili njeri duhet ta dijë se All-llahu i ka nxjerë njerëzit nga barku i nënës injorantë, pastaj i mësoi me mjetet e dijes, duke i dhënë aftësitë e kuptimit dhe aftësinë e tejkallimit të pengesave që i dalin në këtë rrugë dhe eliminimi i angazhimeve që e dezorinetojnë nga ky synim.

All-llahu, xhel-le shanuhu, ua kujton njerëzve këtë begati të madhe që u ka dhënë, i nxorri në dynja tërësisht injorantë, pastaj u dha dëgjimin, shikimin dhe zemrën, apo mendjen, sepse me këto forca apo shqisa i mundësojnë njeriut të perceptojë dhe të dijë. Këto gjëra ia ka dhënë All-llahu, tebareke ve teala, njeriut që të arrijë ta adhurojë Ate dhe ta

shfrytëzojë çdo gjymtyrë, shqisë e fuqi për ta respektuar Zotin e Tij.

Andaj një musliman aq sa ma shumë e shton dijen aq ma shumë duhet ta shton edhe afërsinë me All-llahun, kjo është pjesë e edukatës së një dijetari dhe meriton të jetë i tillë, sepse dija e thërret njeriun që t'i nënshtrohet All-llahut, të le pretendimin dhe egoizmin.

All-llahu, azze ve xhel-le, thotë: "All-llahu ju nxori nga barqet e nënave tuaja (si foshnje) që nuk dinit asgjë. Ju pajisi me (shqisa për) të dëgjuar, me të parë dhe me zemër, ashtu që të jeni falënderues". (En-Nahl: 78).

Ebu Omer ibën Abdul-Berri, rahimehull-llah, thotë: "Nga edukata e një dijetari është lërja e pretendimit të gjërave që nuk di ti bëjë dhe lërja e mburrjes më gjërat që di ti bëjë, përpos nëse detyrohet në një hap të këtillë, sikurse ndodhi me Jusufin, alejhisselam, kur tha: "Ai (Jusufi) tha: "Më cakto mua përgjegjës të depove të vendit, unë jam besnik i dijshtëm". (Jusuf: 55).

Sepse Jusufi, alejhisselam, e bëri këtë hap pasiqë aty nuk kishte njerëz që e njihnin e ta lavdërojnë me atë që meriton dhe e pa se secili që ulet në atë vend nga banorët e vendit nuk do t'ia jep hakun, andaj nuk kishte zgjidhje tjetër përpos se të lajmërohet për këtë post. Nëse ka këso gjendje atëherë të lejohet dijetarit ta lavdëroj veten dhe të tregoj pozitën që ka. Në këtë rast ky njeri i tregon begatitë që ia ka dhënë All-llahu në shenjë falënderimi ndaj Tij.

Gjëja më turpëruese për një njeri është pretendimi i gjërave që nuk mund ti kryen. Këtë ves e kanë qortuar dijetarët në kohën e vjetër dhe tash dhe kanë shkruar rreth kësaj teme shkrime dhe poezi". (Shiko: "Xhamiu Bejanil-llmi", 1/ 145).

All-llahu, xhel-le shanuhu, e ka edukuar peygamberin e tij, Musain, alejhisselam, me

një edukatë shumë të lartë dhe e ka qortuar pse nuk ia ktheu dijen Atij, andaj për këtë shkak ndodhi edhe tregimi i Musait, alejhisselam, me Hidrin, tregim të cilin na e ka treguar Kur'ani dhe Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, në hadithet e tija.

Hadithit që e tregon këtë tregim Imam Buhariu, rahimehull-llah, i ka dhënë titullin: "Kapitulli: Çka është e pëlqyeshme të thotë dijetari nëse pyetet: kush di më shumë, e ia kthen dijen All-llahut". Tregimi është shumë i gjatë dhe për atë që dëshiron ta dijë detailsht mund ti referohet sures El-Kehf, prej ajetit 60 deri në ajetin 82 dhe hadithit të cilin e transmeton Imam Buhariu në sahihun e tij me nr. 78, 122, 2147, 2578 dhe Imam Muslimi në sahihun e tij me nr. 2380.

Po e tregoj vetëm pjesën e parë të tregimit për të parë së për çka All-llahu e detyroi Musain, alejhisselam, ta bëjë të tërë këtë udhëtim.

"U ngrit Musai, alejhisselam, duke mbajtur fjalim para izraelitëve edhe u pyet: kush është njeriu më i dijshtëm? Tha: unë jam njeriu më i dijshtëm. E qortoi All-llahu sepse nuk ia ktheu dijen All-llahut, andaj edhe i shpalli se një rob i Imi jeton në vendin ku takohen dy detërat, ai është më i ditur se ti. Tha: o Zot si të arrij deri te ai? Tha: mer me vehte një peshk në strajcë, e ku ta humbish aty është ai...".

Kur e sjellim këtë rast kuranor dhe hadithor nuk kemi qëllim të themi se Musai, alejhisselam, pretendoi dijen, por të tregojmë se pasiqë All-llahu e qortoi, Musain, alejhisselam, pse nuk ia referoi dijen Atij edhe pse ai dinte dhe punonte sipas asaj që dinte, pasiqë ishte i zgjedhur nga All-llahu, si njeri me zemër, mendje dhe shpirt të pastër, të dliër dhe të ndriçuar, si Pejgamber i All-llahut, edhe atij nuk i takonte të bëjë këso gabimesh, çka do të kishim thënë për ata njerëz që pretendojnë dijen dhe skanë aspak lidhje me dijen?!

Dijetarët tanë e mëhershëm ishin dijetarë me zemër shumë të dliirë, me butësi shumë të gjërë, me dije shumë të madhe, mirëpo asnjë prej tyre nuk kishte turp të thonte nuk di, kur nuk dinte. Po normale është sjellja e tyre, kur edhe melaqet nuk janë turpëruar të thonë për gjërat që nuk dinin: "...Ti je i pa të meta, ne nuk kemi dije tjetër përveç atë që na e mësove Ti. Vërtetë, Ti je i Gjithëdijshmi, i Urti!" (El-Bekare: 32).

Ibën Abdul-Beri, rahimehull-llahu, transmeton nga Abdurahman ibën Mehdiu, rahimehull-llahu, i cili thotë: "Ishim te Malik ibën Enesi, rahimehull-llahu, dhe i erdhi një njeri e i tha: Ebu Abdullah, kam ardhur prej një udhëtimiti gjashtmuor dhe më kanë dërguar populli im që të pyes një pyetje. Tha: pyet. E pyeti ky njeri për një pyetje, kurse Imam Maliku iu përgjigj: nuk e di. U habit ky njeriu, sepse i dukej se ka ardhur te njeriu që i di të gjitha gjërat, e tha: çka ti them popullit tim kur të kthehem? Tha: thuaju: Imam Maliku ka thënë se nuk di.

Ibën Vehbi ka thënë: kam dëgjuar Malikun duke përmend fjalën e Kasim ibën Muhamedit: "Të jeton një njeri injorant është ma mirë se sa të flet për All-llahun pa dije, pastaj tha: nëse Ebu Bekri, radijall-llahu anhu, të cilin e ka veçuar All-llahu me dhunti ka thënë: nuk di, atëherë çka të themi ne.

Ibën Vehbi ka thënë: Maliku më ka thënë: Resulullahi ishte Imam i muslimanëve dhe zotëriu i mbarë botërave, kur e pyetnin për ndonjë gjë ai nuk jipte përgjigje derisa ti vinte shpallja.

Imam Maliku ka thënë se ka transmetime se Ibën Abasi, radijall-llahu anhu, thoshtë: "Nëse dijetari e gabon frazën "nuk e di" godi-

tet me goditje vrasëse". (shiko: "Xhamiu Bejanul-llmi", 2/53).

Kështu ka qenë tradita e dijetarëve të selefët, ata nuk pretendonin gjërat që nuk dinë ti rregullojnë dhe mbarojnë, ishin modest dhe këshilldhënës, saqë Imam Shafiu, rahimehull-llahu, ka thënë: "Çdo herë që kam debatuar me dikend kam dëshiruar që ai mos të gabojë dhe çdo dije që e kam në zemër kam dëshiruar ta ketë secili dhe të mos më mvishet mua".

Gjithashtu Imam Shafiu, rahimehull-llahu, ka thënë: "Kam dëshiruar që çdo dije që e kam ta kishin mësuar njerëzit, të shpërblehem për të por mos të më falënderojnë mua". (Shiko: "Adabu Shafii ve menakibuhu", fq. 91).

Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, u është kërcënuar pretenduesve të dijes dhe Kur'anit me zjarr, duke thënë: "Do të ngadh-njen Islami derisa udhëtojnë tregtarët nëpër detëra dhe derisa futen kuajt në (luftë) në rrugë të All-llahut, pastaj dalin njerëz që lexojnë Kur'anin e thonë: kush e lexon ma shumë se ne, kush di ma shumë se ne dhe kush kupton ma shumë se ne, pastaj u tha shokëve: vallë a do të ketë në mesin e tyre mirësi. Sahabet thanë: All-llahu dhe Pejgamberi i Tij e dinë. Tha: ata janë prej jush, nga ky umet dhe ata janë lëndë e zjarrit". (Sahih, Taberaniu dhe tjerët, shiko: "Sahihut-Tergibi vet-Terhibi, 1/ 58).

Ky hadith është prej argumenteve të pejgamberisë, sepse ka ndodhur mu ashtu si ka thënë në këtë dynja, po ka me ndodhë edhe ajo që ka treguar për në ahiret, All-llahu na ruajtë.

All-llahu na dhashtë bereqete në dynja dhe ahiret, na dhashtë sinqeritet në dije dhe vepra. Amin.

Bekir Halimi

Enciklopedizmi i shkenctarëve muslimanë

Shkenctarët muslimanë, ata që ngritën civilizimin islam në formë të veçantë kishin një veçori, e kjo veçori është enciklopedizmi. Ata nuk ishin specialist vetëm në një art dhe shkencë ose në ndonjë degë të shkencës, por ishin enciklopedi që i dinin shumicën e gjërave në të cilat kishte arritur shkenca në kohën e tyre.

Xhorxh Sartoni në librin e tij "Hyrje në historinë e shkencës" kur arriti në shekullin e shtatë dhe të tetë solar nuk u besonte materialeve që ia ofronin asistentët e tij, por u detyrua që ta mësojë vet gjuhën arabe dhe pas studimit të civilizimit musliman arriti në përfundim që shekujt që vijonin, prej shekullit të tetë deri te shekulli i trembëdhjetë, ti emërton me emrat e shkenctarëve më të dalluar musliman. Gjysmës së dytë të shekullit të tetë i dha emrin: shekulli i Xhabir Ibën Hajanit, gjysmës së parë të shekullit të nëntë i dha emrin: shekulli i Havarizmit, gjysmës së dytë të shekullit të nëntë i dha emrin: shekulli i Raziut, gjysmës së parë të shekullit të djetë i dha emrin: shekulli i Mesudiu, gjysmës së dytë të shekullit të dhjetë i dha emrin: shekulli i Xhuzxhaniut, pjesës së parë të shekullit të njëmbëdhjetë i dha emrin: shekulli i Biruniut, gjysmës së dytë të shekullit të njëmbëdhjetë i dha emrin: shekulli i Hajamit, gjysmës së parë të shekullit të dymbëdhjetë i dha emrin: shekulli i Ibën Zehr El-Andalusiut, gjysmës së dytë të shekullit të dymbëdhjetë i dha emrin: shekulli i Ibën Ruzhdit, gjysmës së parë të shekullit të trembëdhjetë i dha

emrin: shekulli i përkthimit nga arabishtja në gjuhët europiane.

Vlera e shkencës në Kur'an

Shkenctarët musliman kanë bërë një analizë statistikore në suret dhe ajetet e Kur'anit që flasin për shkencën dhe njohuritë dhe kanë konkluduar se:

804 ajete kanë brenda tyre lëndën: dije;
52 ajete lëndën: lajm;
20 ajete lëndën: lexim;
80 ajete lëndën: informatë;
49 ajete lëndën: mendje;
20 ajete lëndën: kuptim;
18 ajete lëndën: mendim.

Tërësisht këto janë 1093 ajete, kurse Kur'ani tërësisht ka 6232 ajete, që domethënë se një e gjashta e ajeteve të Kur'anit flet për shkencën, e lavdëron, stimulon dhe nxitë për te.

Mirëpo kur lexon njeriu fjalën e Allahut:

"...Zoti im, më shto dituri!". (Taha: 114).

"...Po All-llahu ia kanë frikën nga robërit e Tij vetëm dijetarët...". (Fatir: 28).

"All-llahu vërtetoi se nuk ka zot tjetër përveç Tij, e dëshmuar edhe engjëjt e dijetarët, dhe se Ai është Zbatues i drejtësisë. Nuk ka zot përveç Tij, Fuqplotit e të Urtit". (Ali Imran: 18).

Kjo pa dyshim se na trishton dhe frikëson në të njëjtën kohë.

Nga kjo pikënisje dolën në shesh dijetarët enciklopedistë të cilët e mësuat botën.

Në kohën e Faraonëve shkenctarët arritën në shumë fshehtësi të dijes dhe i

mësuan shumë dije të reja, mirëpo nuk arriten të kenë llojlojshmërinë dhe enciklopedizmin që e kanë arritur muslimanët.

Në civilizimin grek shkenctarët e tyre nuk kanë arritur numrin, cilësinë dhe llojlojshmërinë siç ka qenë rasti me civilizimin islam.

Ne habitemi kur dëgjojmë emrat e shkenctarëve siç është Ibën Semili, Ibën Kelbiu, Ebu Ubejde, Esmeiu, Hejthem ibën Adu, Medainiu, shkenctarë që kanë jetuar në shekullin e dytë sipas hixhretit dhe secili prej tyre ka lënë mes dy qind dhe tre qind librave.

Gjuha arabe dhe shkencat islame

Në fillim shkenca kishte kuptimin e studimeve islame, sepse të gjithë shkenctarët pa përjashtim mirreshin me shkencë nga dimenzioni fetar, andaj arsimimi i tyre ishte islamik dhe bazohej në gjuhën arabe dhe sheriatin.

Të gjithë shkenctarët musliman, ata që vazhduan në lëmitë fetare ose lëmitë ekzakte që dolën prej tyre filluan shkencën me mësimin e fesë islame dhe duke i dhënë rëndësi të madhe gjuhës arabe, e cila ishte çelësi i shkencave islame.

Biruni nuk ishte arab, Ibën Xhiniu, nuk ishte arab, por ishte grek, ibën Tufejli dhe Xhahidhi nuk ishin arab, mirëpo e kishin mësuar gjuhën arabe dhe ishin bërë mësues të saj, sepse ishte gjuhë e shkencës dhe zhvillimit.

Ibën Kelbiu shkroi në nëntë shkenca dhe në çdo shkencë nga dhjetra libra. Ka shkruar për ëndërrat, vlerat, ekzistencat, histori, gjeografi, poezi, gjenealogji, histori të injorancës, histori islame, etj.

Kjo aftësi është e jashtëzakonshme dhe jo e thjeshtë. Ajo që të mahnit më së

shumti është fakti se ka arritur kulmin në çdo shkencë dhe shkrimet dhe librat në këto shkenca janë të dalluara dhe nuk janë vetëm nxierje të letrave, por janë përplot me dije, kuptim, precizitet dhe perceptim.

Disa shembuj nga enciklopedizmi i shkenctarëve muslimanë

Prej shkenctarëve të njohur dhe të dalluar të muslimanëve është edhe Taberiu. Ky ishte i dalluar në tefsir, komentin e Kur'anit, në këtë lëmi është shtylla e mufesirëve, komentatorëve të Kur'anit, kur shkruan në këtë shkencë, aq mirë shkruan sa që duket se ai vetëm këtë shkencë e zotëron. Mirëpo ai që lexon librin e tij në histori e sheh se historia islame nuk mund të kuptohet pa leximin e këtij libri. Aq mirë e ka shkruajtur këtë libër sa që thua se nuk ka shkruajtur ky njeri në asnjë shkencë përpos kësaj shkenca. Nëse shfletojmë në fikh, do të vërejmë se Taberiu ishte imam në fikh dhe kishte medheb të vetin. I këtillë ka qenë edhe në kirraete, lexime të ndryshme të Kur'anit, në akide, lëndën e besimit, në hadith, Usul, sire, kada, gjyqësi, moral, ëndëra, poezi, etj.

Nëse i hedhim sy Imam Ebu Hanifes, rahimehull-llah, do ta gjejmë njeri i cili ka arritur kulmin në shumë shkenca, si në fikh, usuli fikh, tevhid, etj. ai poashtu dallohej edhe në shkencën e etikës, ekonomisë, shitblerjes, etj. trashëgëmia shkencore e këtij Imami është aq e madhe sa që me trashëgimin e tij shkencore veprojnë me miliona njerëz dhe gjykojnë me te gjykatës dhe gjykata. Krejt kjo tregon gjenialitetin e këtij shkenctari enciklopedik,

i cili ka përmbledhur disa shkenca dhe në të gjithat ka arritur kulmin e tyre.

Imam Shafiu ishte argument në gjuhën arabe, ishte poet pa rival, andaj edhe ka thënë një herë: po mos t'ishte fikhu do të bëhesha më poet se Lebidi (Lebidi ka qenë poet i njohur, të cilin edhe Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, e ka përmendur në hadithet e tija). Kurse ai ishte më poet se Lebidi edhe pse mirrej kryesisht me fikh. Ai krahas gjuhës dhe fikhut ishte i dalluar në Usuli Fikh, ai edhe konsiderohet i pari i cili i ka vënduar rregullat e usuli fikhut në librin e tij "Er-Risale". Është argument në shkencën e akides dhe tevhidit, argument në historinë e arabëve, historinë islame, dhe njohës i mirë i fiziognomisë.

Bakilaniu është i njohur me librin e tij mbi mrekullinë e Kur'anit, por është shkencetar edhe në Tefsir, Fikh, Usuli Fikh, gjenezën e fjalëve, shtresat e njerëzve, njohjen e feve, frakcioneve islame, moral, histori, letërsi, kritikë, etj. Bakilaniu ka lënë pesëdhjetë e pesë libra dhe secili libër konsiderohet bazë në lëminë e vet. Ai njihet edhe me debatet, ligjëratat dhe polemikat me priftërinjtë.

Një ditë ishte i ulur me një prift. E pyeti: si je dhe si e ke familjen dhe fëmijët. U nervozua prifti nga kjo pyetje duke i thënë: si ka mundësi të më pyesish si i ke fëmijët? A nuk dinë se priftërinjtë nuk kanë fëmijë. Bakilaniu ia ktheu shpejt si rrufe: distacoheni ju vet nga fëmijët, kurse ia mveshni këtë gjë Zotit?!

Prej shkenctarëve enciklopedistë është edhe Ebul-Hasen Maverdiu. E ka marrë këtë emër sepse kishte një duqan që shiste në te lëng trandafili, që në arabisht i thuet mau verd, e shkurtimisht i thuhet maverdi. Të këtyllë kanë qenë shumica e

shkenctarëve musliman, ata nuk kanë qenë nëpunës, por kanë fituar me dorën e vet, sepse nëse një dijetar punon si nëpunës e shemb me këtë një shtyllë prej shtyllave të dijes së tij. Maverdiu ka shkruajtur aq shumë libra sa nuk i dihet numri. Maverdiu ka shkruajtur librin "Ahkamu Sultanije", "Muftehar Ulumul-Kuran", "Emthalul-Kuran", "Et-Tefsirul-Kebir lil-Kur-anil-Kerim", "El-Havi fi fikhush-Shafi" dhe shumë libra në politikë sikurse është libri "Ahlakul-Meliki", ("Morali i mbretit"), "Politika e Mbretit", "Këshillë Mbretërve", "Edukata e dynjasë dhe fesë", etj.

Zbulime dhe inovacione të muslimanëve

Dëshirojmë ti regjistrojmë disa zbulime dhe inovacione që kanë origjinë islame që ta dije populli ynë këtë gjë, pasi që ka të atillë që synojnë ti fshehin këto fakte.

Shkrimtari britanez Paul Vallely bëri një listë të njëzet zbulimeve më me ndikim të muslimanëve dhe i paraqiti në ekspozen e tij të fundit.

1- Kafeja fillimisht është zbuluar nga arabët në Etiopi, kurse të parët që e kanë përdorur dhe është dokumentuar kjo janë jemenasit. Në fundin e shekullit të pesëmbëdhjetë kafeja arrin në Mekë dhe Turqi, kurse në vitin 1645 me eksportimin e kafes në Venedik ajo prezantohet në mënyrë solemne para publikut evropjan. Emri arab kahva shkrihet në atë turke kave që më vonë të mer emin italian caffe ose anglisht coffee.

2- Grekët e vjetër mendonin se sytë ta në lëshojnë reze, diçka sikur laseri dhe se në atë mënyrë ne shohim. Në shekullin e dhjetë matematicienti musliman Ibën Hejthemi zbulon se në realitet drita depërton në syrin tonë dhe se nuk del dritë prej

syve tanë. Andaj ai e zbuloi fotoaparatin e parë me leqe pasiqë vërejtë se drita hyn nëpërmjet kanateve të mbyllura. Aq sa më e vogël është vrima aq më e mirë është fotografia. Ky shkenctar pas disa orvatjeve e prodhon camera oscura.

Hejthemiu është meritë edhe për kalimin e fizikës nga aktiviteti filozofik në aktivitet eksperimental.

3- Shumë shekuj para vëllezërve Rajt, poeti dhe ingjinieri Abas ibën Firnasi ka patur disa orvatje për prodhim të një maqine fluturuese. Në vitin 852 ai e bën provën e parë nga minareja e xhamisë së madhe në Kordobë, mirëpo nuk korre sukses. Në vitin 875, pasi që kishte mbushur 70 vjet e bën edhe provën e fundit, mirëpo tani me maqinë të sofistikuar dhe të përbërë nga mëndafshi dhe pendla të shqiponjës. Në këtë tentim ai fluturon dhjetë minuta para se të rëzohet. Përndër të tij aeroporti i Bagdadit dhe një krater në Hënë e mbajnë emrin e tij.

4- Larja dhe pastrimi është detyrë fetare te muslimanët, andaj ata me kalimin e kohës e kanë përsosur prodhimin e sapunit. Edhe pse egjyptianët dhe romakët kanë përdorur një lloj sapuni, mirëpo sapuni që ka formën e sodit është prodhim i arabëve. Këta janë të parët që kanë kombinuar yndyrat bimore, natrium hidroksidin dhe yndyrat me aromë. Njëra prej gjërave më karakteristike me të cilat i kanë dalluar muslimanët kryqtarët ka qenë era e keqe e tyre. Këta janë edhe shpikësit e shamponit, i cili është bartur në Europë në vitin 1759 prej tregtarëve muslimanë.

5- Procesi i ndarjes së lëngjeve sipas pikës së vlimit të tyre është zbuluar në vitin 800 nga shkenctari i madh musliman Xhabir ibën Hajan. Ky ka bërë trasnformi-

min e alkemisë në kimi, ka zbuluar shumë procese dhe maqina që shfrytëzohen edhe sot: kristalizimin, destilimin, purifikimin, oksidimin, avullimin dhe filtrimin. Ai ka zbuluar acidin e sulfurit dhe azotit. Ai është inovatori i destiluesit me ç'rast botës i jep parfymet e para. Si babë i kimit moderne ai është përpjekur për eksperimentim sistematik.

6- Leva. Shufër e fortë dhe e gjatë, që shërben për të ngritur më lehtë a për të lëvizur trupa të rëndë. Maqinë e cila lëvizjen qarkore e shndërron në lëvizje lineare. Kjo maqinë është pjesa qendrore te shumica e maqinerisë moderne në botë. Ky inovacion është vepër e ingjinerit brilant musliman Xhezeriut. Libri i tij i botuar në vitin 1206, të cilin e ka shkruar për njëzet e pesë vjet studimesh dhe hulumtimesh, me titull "Bashkimi mes dijes dhe veprës së mirë në prodhimin e mekanikës" konsiderohet prej librave më të shkëlqyer që janë botuar në mesjetë mbi maqinat mekanike dhe hidraulike. Kopje të këtij librit gjinden në muzeun "Top Kapi" në Stamboll, "Muzeun e arteve të bukura" në Boston, në "Luvër" në Francë dhe "Bibliotekën e Oksfordit".

Ky libër është bërë shumë i njohur në perëndim dhe janë përkthyer disa pjesë të tij në gjuhën gjermane nga Wiedmani dhe Hawser në çerekun e parë të shekullit njëzet, kurse në anglisht e ka përkthyer Donald Hill, ekspert i historisë së teknologjisë arabe. Instituti i trashëgimisë shkencore arabe në Halep të Sirisë e ka ribotuar këtë libër të vjetër në vitin 1979.

Prej pesëdhjet zbulimeve të tija është edhe brava e shifruar.

7- Shumica e instrumenteve kirurgjike e kanë të njëjtin dizajn sikur ato të prodhuara në shekullin e dhjetë nga kirurgu

musliman El-Zahravi. Ai ka zbuluar se zorrët e disa kafshëve pas një kohe vet kalben, andaj edhe mund të shfrytëzohen për qepjen e pacientit të operuar.

Sistemi i qarkullimit të gjakut është zbuluar nga Ibën Nefisi, 300 vjet para se ta përvehtëson këtë teori Wilijam Harvi dhe sot mbarë bota ia mvesh atij e jo Ibën Nefisit. Anestezionin e ka zbuluar Ibën Sina. Kurse mjekët muslimanë e kanë zbuluar edhe injekcionin bosh brenda për menjanimin e kataraktës, e cila edhe sot e kësaj dite përdoret.

8- Vakcinat janë edhe një zbulim shkencor në medicinë. Ato në Europë vijnë në vitin 1724 nëpërmjet gruas së ambasadorit britanez në Stamboll. 50 vjet para se të fillon perendimi të flet për mbrojtje, fëmijët në Turqi kanë fituar vakcina për fruthin.

Zbulimi dhe zhvillimi i prodhimit të letërës, gjilpërën magnetike, busulën, barutin, naftën, teorinë e formulimit të gjallëresave, teorinë e gjeneve, tërë këto dhe shumë zbulime tjera janë islame dhe pse u atribohen shkenctarëve europjan.

Kjo dhënie vazhdon edhe sot. Pesëdhjet për qind e mjekëve që janë shpërngul në perendim, Europë, Amerikë dhe Australi janë muslimanë. 23% të inxhinierëve që kanë emigruar në perëndim janë muslimanë. 15% prej fizikantëve që kanë emigruar në perendim janë muslimanë.

Sipas një statistike të një raporti shkencor egjyptian thuhet se për gjashtë vite kanë shkuar vetëm në Amerikë një mijë e pesëqind doktor shkence, prej tyre janë kthyer vetëm dy qind, kurse një mijë e treqind kanë mbetur atje.

Përgaditur nga: Bekir Halimi

Zemërimi dhe shkaktarët e tij

Thuhet se zemërimi është armik i arsyes, sikurse ujku që është armik i deleve. Vëshitirë që futet ujku në tufën deleve e të mos i vrasë ato.

Është e vërtetë se hidhërimi mund ta shpjerë personin në mëkate. Mund të shkaktoj që veprat e tij të mira të zhduken dhe të bëhen të pavlera. Mund të shkaktoj që edhe një person i cili i bindet ligjit të kryej krime.

Në të njëjtën kohë, ne mezi gjejmë një person i cili nuk zemërohet. Në të vërtetë, nëse hasim në një person i cili nuk zemërohet kurrë, ne këtë do ta shohim si një të metë e jo si një vlerë të tij.

Problemi qëndron në atë se shumica nga ne nuk dijnë se si të veprojnë kur zemërohen. Ne nuk mund të flasim mirë dhe

drejt kur jemi të zemëruar. Ne nuk kemi ushtruar vetën e as fëmijët tanë se si të zemërohen dhe për çka të zemërohen. Për shkak të kësaj, kam bërë përpjekje që të sjell së bashku atë çka thonë Kurani dhe Suneti në lidhje me këtë çështje, duke ngërthyer në vete edhe këshillat e mira nga mendimtarët e ndryshëm.

Definicioni i zemërimit

Shumë dijetarë, të fushave të ndryshme, janë munduar që ta definojnë zemërimin. Formulimi i definicioneve të tyre dukshëm ndryshon, por në parim kuptimi është i njëjtë. Kuptimi themelor i zemërimit është diçka që edhe fëmijët e vegjël e kuptojnë ashtu siç e kuptojnë të rriturit, pa kurrfarë

vështirësie.

Rreziku në sqarimin dhe shpjegimin e çështjeve që janë të dukshme është që shpesh kjo paraqet mjegulli, paqartësi në ato çështje që kurrë nuk kanë qenë prezente për të filluar me to. Nga kjo është pse dijetari klasik al-Menâvî ka qenë i kënaqur që të definojnë zemërimin sikurse: “gjendje psikologjike që instiktivisht kuptohet.”

Natyrisht, dijetarët tjerë kanë qenë më ambicioz në definimin e zemërimit dhe duhet që t'i përmendim disa mendime të tyre:

El-Kurtubi definojnë zemërimin në këtë mënyrë: “Gjuhësisht, nënkupton ashpërsi. Një njeri i zemëruar që ka sjellje të ashpër.” [Tefsîr el-Kurtubî (1/150)]

Zemërimi gjithashtu është definuar si: “Ndryshimi që ndodh në lidhje me rritjen e shtypjes së gjakut që të sjell një gatishmëri hakmarrëse në gjoks.” [al-Ta`rifât]. Një tjetër definicion i dhënë është që zemërimi definohet si: “dëshirë (ndjenja e të qenit të gatshëm) për ta ngacmuar tjetrin përmes asaj që shkakton zemërimin tek ai.”

Shkaktarët e zemërimit

Shumë gjëra inicojnë zemërimin. Shkaktarët janë të shumtë dhe njerëzit dallojnë në atë se çka i zemëron ata. Ajo çka një person e konsideron të vogël, të parëndësishme, e njëjta gjë mund ta shpjer një person tjetër jashtë kontrollit.

Ja disa shkaktarë të zemërimit:

1. Vetëkënaqësia: Një person mund të jetë shumë i kënaqur me mendimin e tij apo shumë krenar me statusin, pasurinë apo prejardhjen e tij. Kjo mund të sjell ndjenjë të urrejtjes ndaj të tjerëve nëse vetëdija fetare e personit është e mangët.

Kjo është kur vetëkënaqësia të shpie në arrogancë dhe mendjemadhësi.

Një arrogancë e tillë është mëkat i madh. Pejgamberi, paqa dhe bekimi i Zotit qofshin mbi të, ka thënë: “Askush nuk do të hyj në xhenet zemra e të cilit përmban mendjemadhësi sa një grimcë.” [Sahîh Muslim (91)]

Ai gjithashtu ka thënë: “Urdhëroni njëritjetrin në punë të mira dhe pengoni njëritjetrit nga punët e ndaluara, përderisa ju i shihni njerëzit duke iu dorëzuar koprracisë, duke u dhënë pas epshit dhe duke u kapur për kënaqësitë e kësaj bote - secili person tërësisht i impresionuar me mendimet e tij personale. Kur kjo të ndodhë, bëhu i kujdesshëm për vetën tënde dhe largohu nga punët e njerëzve të zakonshëm.” [Sunen Tirmidhî (3058) dhe Sunen Ebî Dâvûd (4341) i vërtetuar nga Ibën Hibbân (385)]

Ibën Abbas ka thënë: ‘Tri veçori janë shkatërruese: mendjemadhësia, koprracia, dhe pasimi i epsheve.’

Gjeneratat e mëhershme të muslimanëve kanë qenë shumë të kujdesshëm nga vetëkënaqësia dhe kanë këshilluar njëritjetrin për këtë gjë, shpesh në mënyrë indirekte. Salîm b. Hanzalah transmeton se ai ka qenë duke shëtitur me një grup të njerëzve të cilët ishin ngjitur pas Ubej b. Ka'b. Kur `Umeri e pa këtë gjë, ai ngriti shkopin e tij në të. `Ubeji tha: “`Umer, çka jeni duke bërë?” `Umeri tha: “Është nënçmim (përlulje) për ta të vijnë pas teje dhe është provë për ty që të përcillen në këtë mënyrë.” [Sunen Dârimî (527)]

2. Polemika: AbdAllah b. Husejn njëherë ka thënë: “Polemika është ajo që të shpie në zemërim, dhe Allahu e turpëron mendimin që është thënë me zemërim.”

Polemika është e dënueshme në shumë mënyra. Për këtë gjë, Islami e ka ndaluar

atë. Pejgamberi, paqa dhe bekimi i Zotit qofshin mbi të, ka thënë: “Unë mund të garantoj shtëpi në Xhenet veçanërisht për ata të cilët heqin dorë nga polemika, edhe nëse kanë të drejtë.” [Sunen Ebi Dâvûd (4800)]

3. Shakaja: Ne e dimë që personat që janë të prirur të tregojnë shumë shaka shpesh i shpiejnë gjërat shumë larg. Nganjëherë ata thonë shprehje të pakuptimta. Herave tjera, thonë gjëra që në të vërtetë lëndojnë njerëzit dhe mundohen që t'i përmirësojnë ato duke thënë se kjo është vetëm shaka.

Kjo është pse Pejgamberi, paqa dhe bekimi i Zotit qofshin mbi të, ka thënë: “Askush nuk duhet që të rrëmbej diç që është pronë e dikujt tjetër - as për të vërtetë madje as për shaka (argëtim).” [Sunen Tirmidhî (2160) dhe Sunen Ebi Dâvûd (5003)]

Hâlid b. Safvân njëherë foli për temën e shakasë dhe tha: “Njëherë një person goditi shokun e tij me diç më të fortë se sa guri dhe e bëri që të ketë aromë më të rëndë se sa kokrra e mustardës dhe zbrazti mbi të diç që djeg më shumë se sa një përmbajtje në kazanin e vluar, e më pas

tha – Unë vetëm bëra shaka me ty.”

Halifeja `Umar b. `Abdul-`Aziz tha: “Lar-goju shakasë, sepse sjell atë që është e shëmtuar dhe inicon urrejtjen.”

Mejmûn b. Mehrân tha: “Nëse një bisedë hapet me shaka, do të përfundoj me ofendime dhe shpërthime.”

4. Fjalët e ndyta dhe vulgare: Ofendimet dhe kundërshtimet digjen në zemrat e njerëzve dhe inicojnë zemërimet e tyre. Pejgamberi, paqa dhe bekimi i Zotit qofshin mbi të, ka thënë: “Allahu urren fjalët e ndyta (sharjet) dhe vulgare.” [Sunen Tirmidhî (2003) dhe vërtetohet nga Ibën Hibbân (5693)]

Ekzistojnë një mori shkaktarësh të zemërimit, siç janë: pabesia (tradhëtia) ndaj të tjerëve, lakmia dhe dëshira për pozitë.

Al-Gazâlî në mënyrë të mprehtë sjell një studim: “Një nga inkurajimet e mëdha për zemërim në mes të injorantëve është prirja që të përshkruajnë sjelljet zemëruese si një kurajë (guxim), burrëri, vetërespekt dhe fisnikëri.” [Ihyâ' `Ulûm id-Dîn (3/173)]

Duke qenë të kujdesshëm nga natyra e zemërimit dhe shkatarëve të tij kjo do të na ndihmoj neve – me ndihmën e Allahut – që të mos jemi viktimë e zemërimit.

Shkroi: Shejh Najif el-Hamad
drejtues i gjykatës në rajonin Rimâh
Përktheu: B.M.

Relativizmi

Gjuha arabe bashkëkohore me këtë term përcakton dy teori të ndryshme: teorinë e relativitetit e Ajnshtajnit (Albert Einstein, Mars 14, 1879 – Prill 18, 1955), teori e njohur në lëminë e fizikës dhe relativizmin¹, teori filozofike dhe sociologjike. Në këtë tekst do të flasim rreth teorisë së dytë.

Rrënjat e kësaj teorie kthehen në kohën e Protagorës², filozofit grek që jetoi pesë shekuj para erës sonë. Kjo teori është shumë e përkrahur nga disa mendimtarë përrëndimorë që studiojnë çështjet e sociologjisë dhe antropologjisë. Sipas teorisë në fjalë, nuk ka kriter të qëndrueshëm që dallon të vërtetën nga e pavërteta, të mirën prej asaj që është e keqe. Gjithë gjykimet janë relative. Kur parashtrohet pyetja për llojin e relativitetit, përgjigjet e përkrahësve, fillojnë të dallohen. Sipas më ekstremëve çdo individ është vlerësuesi i së mirës dhe së keqes. Ajo të cilën ai e konsideron të mirë është e mirë, në kohë që, e keqja për atë është me të vërtetë e keqe. Disa tjerë për gjykues e zgjedhin kulturën e shoqërisë, të cilën e definojnë si modeli i jetës i zbatuar nga një shoqëri, në periudhë të caktuar historike. Kultura përbëhet prej besimeve, kodeve të sjelljes, gjuhës dhe i përfshin gjithashtu edhe traditat, zakonet, artet, inovacionet, teknikën dhe trashëgiminë. Sipas këtyre mendimtarëve ajo të cilën kjo kulturë e sheh si e vërtetë dhe e mirë është e tillë për atë kulturë. Ky qëndrim është i pranueshëm në një shoqëri që nuk ka kriter të unifikuar për ta vlerësuar të vërtetën dhe të mirën.

Njëri prej këtyre thotë: "Çdo zakon dhe traditë e përhapur në kohë dhe vend të caktuar, ka justifikimin e vet për atë kohë

dhe vend."³

Një sociologe e tjetër thotë: "Shumë nga shoqëritë veprojnë në mënyra të ndryshme duke synuar realizimin qëllimeve të ndryshme. Këto mjete dhe qëllime nuk mundën të vlerësohen me mjetet dhe qëllimet e ndonjë shoqërie tjetër, sepse nuk janë të njëjtë as mjetet e as qëllimet e shoqërive të ndryshme." (referenca e njëjtë)

Nuk ekziston kriter botëror për vlerësimin e kulturave, që vërteton apo mohon saktësinë e tyre, që i jep përparësi njëres para tjetrës. Ithtarët e një kulture nuk kanë të drejtë të gjykojnë kulturat e tjera sipas parimeve të kulturës së tyre. Qëndrimi i paanshëm shkencor kërkon që çdo kulturë të valorizohet sipas parimeve të vlerësimit që janë pjesë e asaj kulture. Sipas tyre nuk kemi të drejtë të kritikojmë popullin eskimez i cili si shenjë mikpritje ia huazon mysafirrit gruan e tij e as kulturat që mbysin foshnjën në djep dhe plakun duke u arsyetuar me jo-produktivitetin e tyre.

Vërejtjet tona rreth kësaj teorie janë:

1. Është teori e cila vet i mohon parimet e saj (është kontradiktore me vetën). Përderisa vlerësimi (për saktësinë, mirësinë dhe vërtetësinë) varet nga gjykimi individual ose kulturor, i cili formohet individualisht dhe në kushtet e kulturës dominuese, atëherë me çfarë të drejtë thuhet se bëhet fjalë për një të vërtetë botërore e cila duhet të merret parasysh, siç kërkojnë përkrahësit e kësaj teorie.

2. Ekzistojnë vlera të përbashkëta morale që janë yrnec (paradigmë) i sjelljes në shumë shoqëri pa marrë parasysh dallimin e tyre kulturor, dhe dallimet në kohë dhe vend. Këtë e kanë zbuluar disa dijetarë të

antropologjisë. Shembuj për vlerat e përbashkëta është refuzimi i veseve si gënjeshtër, vrasja, incesti, padrejtësia, në pothuajse gjithë shoqëritë.

3. Mospajtimi rreth kufijve të gënjeshtërës dhe moralit nuk është argument për mos-ekzistimin e tyre. Prania e kriterëve të përbashkëta është një gjë, pajtimi rreth tyre është diçka krejtësisht tjetër.

4. Ithtarët e kulturave të ndryshme mundohen të justifikojnë vlerat e tyre me arsye të mbështetura nga kriteret e përbashkëta. Askush nuk thotë: Kjo është e vërtetë sepse ne e konsiderojmë të tillë. Ata qëndrimet e tyre mundohet ti arsyetojnë me kriteret logjike, të përbashkëta për gjithë njerëzit.

Merre si shembull mbytjen e vajzave nga frika prej varfërisë, siç na rrëfen Kur'ani, dukuri që ka qenë e përhapur tek arabët para islamit. Ata edhe pse e bënin këtë krim të pamëshirshëm, besonin në Allahun. Prania e këtij besimi e lehtësoi debatin me ta dhe ndryshimin e këtij realiteti pasi që tek ata u forcua njohja e Allahut, subhanehu ve te'ala.

5. Dëshmia e shqisave, që është e pranueshme për shumicën dërmuese, vërteton qëndrimin se jo çdo gjë ka mundësi të vlerësohet sipas prirjeve individuale, ose sipas kulturës shoqërore. Asnjë i mençur, pa marrë parasysh përkatësinë e tij kulturore, nuk mundet të mohon lindjen e diellit (pasi që ka lindur) apo të thotë është çështje relative. Për gjithë njerëzit e një vendi në kohë të caktuar, dielli ka lindur.

6. Nëse pranojmë relativizmin atëherë pse të mbështetemi në prirjen individuale apo në tiparet e kulturës. Pse të mos gjykojmë me parimet e përbashkëta për shumicën e njerëzve: dëshmia e shqisave, provat logjike, bile edhe disa justifikime që nuk

qëndrojnë, por rreth të cilëve mundet të debatohet.

7. Njerëzit janë qenie shoqërore, krijojnë shoqëri të ndërlidhura që bashkëpunojnë mes vete. Realizimi i kësaj lidhshmërie dhe bashkëpunimi nuk është i mundshëm pa vlera të përbashkëta, të cilat disa ekonomistë dhe sociologë i quajnë kapitali i shoqërisë. Shoqëritë që e kanë hisen më të madhe prej këtij "kapitali" janë më forta në lidhjet e tyre dhe më të afta për realizimin e qëllimeve ekonomike dhe politike, se sa ato që nuk kanë shumë kapital.^o

Megjithatë, përskaaj dobësisë që e ka relativizmi si teori, ajo në mënyrë epidemike përhapet në perëndim, në veçanti tek shtesa e rinisë. Shumë prej tyre, siç na tregojnë kolegët e tyre, besojnë se çështjet e fesë dhe moralit janë çështje që varen nga shija e personit, e cila ndryshon varësisht nga temperamenti i individit. Për këto çështje, thonë ata, nuk ka kriter objektiv. Besimi në relativizmin si teori ndoshta është pasojë e fanatizmit i cili akoma dominon në disa shoqëri perëndimore, që traditat, zakonet dhe vlerat e shoqërive tjerë i valorizojnë sipas kulturës tyre. Sipas tyre ato kultura që janë më afër kulturës së tyre, janë më afër të asaj që konsiderohet e mirë dhe e vërtetë, dhe e kundërta. Bota Islame dhe jo vetëm ajo, ka vuajtur shumë nga relativizmi politik, edhe pse në shikim të parë le përshtypjen e tolerancës ndaj atyre që nuk pajtohen me të.

Relativizmi si një prej sëmundjeve të shoqërisë perëndimore ka kaluar edhe në botën Islame dhe si teori përkratet nga shumë "intelektualë", bile edhe atyre te deklaruar si "islamistë". Disa prej tyre filluan të gjurmojnë pas bazave të kësaj teorie në trashëgiminë tonë Islame. Argumentet e tyre dallojnë varësisht nga koha dhe vendi:

disa për bazë e marrin rregullin: Çdo muxhtehid (ai që i ka angazhuar gjithë aftësitë e tij mendore dhe dijen e tij, që duhet të jetë e gjerë, për të hulumtuar dhe gjykuar rreth ndonjë çështjeje fetare) e ka qëlluar të vërtetën, të tjerët argumentojnë me rastin e namazit të iqindisë në ndodhinë me fisin Benu Kurejdha. Pala e tretë mbështetet në rregullin: Ndryshimi i dispozitave, varësisht nga koha dhe vendi dhe si shembull e marrin rastin e imam Shafi'iut i cili kishte ndryshuar shumë nga qëndrimet e tija pas shpërnguljes në Egjipt.

Në këto argumente nuk ka të tillë që përkrahin apo mbështesin formën perëndimore të relativizmit, e përshkruar si më lartë:

Së pari: Besimi i besimtarit, në lidhje me Krijuesin e tij nuk është çështje relative, që varet nga dallimet në logjikën e njerëzve. All-llahu ka ekzistuar para se të krijohen njerëzit dhe para se ta njohin ata Zotin e tyre. Ekzistimi i Zotit është i pavarur nga ekzistimi i krijesave dhe nga vetëdija e tyre për Zotin. Ekzistimi i Tij është absolut i pa përkufizuar, dhe asgjë në lidhje me ekzistimin e Zotit nuk është relative. Myslimani krahas besimit në ekzistimin e Zotit është i bindur se ai duhet ta njëson Zotin me adhurim edhe, thënë në mënyrë hipotetike, atëherë kur asnjë prej njerëzve nuk e adhuron Zotin. Besimi se Zoti është i vetmi që meriton adhurimin është gjithashtu e vërtetë absolute që nuk varet nga zbatimi i kësaj vërtete prej njerëzit. Tek mysli-manët sinqeriteti, drejtësia, besnikëria, devocioni janë vlera universale që nuk varen nga zbatimi/moszbatimi i tyre individual, kulturor dhe shoqëror.

Së dyti: Për ata që thonë: Çdo muxhtehid e ka qëlluar të vërtetën, kriteri i vërtetësisë nuk është ajo të cilën e ka thënë muxhtehidi, sepse ata janë të bindur në rregullin

Islam sipas të cilit e vërteta nuk njihet me anë të njerëzve. E vërteta e qëlluar në këtë rast është ixhtihadi i cili është kriter objektiv i mbështetur në prova. Megjithatë ne nuk kemi mundësi që për çdo muxhtehid të themi se është në drejtë, posaçërisht në rastet e kontradiktave mes gjykimeve të muxhtehidëve, njëri thotë: kjo është e lejuar kurse tjetri thotë: është e ndaluar, njëri thotë kjo gjë është farz në kohë që tjetri thotë është haram. Nëse ne i shpallim si të vërteta të dy gjykimit kemi bërë bashkimin mes dy kontradiktave, gjë kjo e cila nuk i lejohet njeriut të mençur. Edhe atëherë kur nuk ka kontradikta, jo çdoherë gjykimi i muxhtehidit është i vërtetë.

Së treti: Ata që relativitetin e saktësisë e argumentojnë me tregimin e namazit të iqindisë në fisin Benu Kurejdha nuk e kanë kuptuar si duhet fjalën e të Dërguarit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem. Po, është e saktë që i Dërguari i All-llahut nuk i shpalli si gabimtarë as ata që u falën para se të mbërrijnë te Benu Kurejdha e as ata që e vonuan namazin derisa erdhën te fisi në fjalë. Me këtë veprim ai shpalli namazët e të dyja palëve si namaz i pranueshëm, dhe ky gjykim nuk është aspak kontradiktor, sikur që nuk ka kontradikta në pohimin se namazi në fillim të kohës është i pranuar si namazi në fund të kohës. I Dërguari i All-llahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, duke e saktësuar veprën e të dy palëve e shpalli si të gabuar mendimin e çdonjëres se pala e tjetër është në gabim. Thënë ndryshe: ju namazin e juaj e keni në rregull por e keni gabim konsideratën se pala tjetër ka gabuar. I Dërguari i All-llahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, i vlerësoi si të sakta vetëm qëndrimet e sakta e çdo njëres prej dy palëve.

Së katërti: Sa i përket imam Shafi'iut, mjafton të themi se ndryshimi i tij nuk ka

lidhje me relativizmin sepse ndryshimi në qëndrime që e bëri imam Shafi'iu, nuk kanë lidhje me vendin ku u shpërngul. Si shembull do të përmendim dy qëndrimet e tij të ndryshme në lidhje me personin i cili pas hulumtimit është falur në drejtim të gabuar a është i detyruar me përsëritje të namazit? Sipas qëndrimit të tij të vjetër njeriu nuk e ka për obligim përsëritjen e namazit ndërsa sipas qëndrimit të dytë ai është i obliguar me përsëritje të namazit. Pyetja është: Çfarë lidhje ka vendndodhja e tij (në Hixhaz apo Egjipt) me fetvanë e dhënë? Ndryshime të ngjashme kanë edhe imamët tjerë që qëndrimet e tyre i ndryshonin në kushte të ndryshme, si imam Ahmedi i cili nuk u shpërngul për jetë në vend tjetër, por pati ndryshim në mendime.

Mbeti të themi: Ka çështje që nga vet natyra janë relative. Relativiteti i tyre nuk duhet të përzihet me relativitetin e së vërtetës dhe vlerave morale që ishin tema e këtij shkrimi. Relativiteti i pranuar është për shembull gjatësia dhe shkurtësia tek njeriu e cila varen nga vendi dhe koha. Ai që në Sudan është i shkurtër konsiderohet

i gjatë për kriteret e Kinës. Sidoqoftë ky relativitet nuk shkakton mospajtim të madh mes njerëzve. Kur thuhet njeriu është i gjatë shumica e kuptojnë se kjo gjatësi është relative dhe ka të bëjë vetëm krahasuar me njerëzit e një vendi dhe një zonë kohore. Relativiteti i tillë është edhe shpejtësia e njeriut...

Dr. Xha'fer Shejh Idris
Përktheu: Talha Kurtishi

Shënime:

1-Doktrinë filozofike sipas të cilës gjithë kriteret e gjykimit janë relative dhe varen nga subjektet dhe situatat. Shih: Wordnet, botimi i Universitetit Princeton

2-Π ρ ω τ α υ ό ρ α ς, filozof i Greqisë së lashtë. Jetoi mes viteve 490-420 para erës sonë

3-William Graham Summer Hodges jr. i cituar nga Harold M. në librin e tij Conflict and Consensus, An Introduction to Sociology fq. 60
° Francis Fukuyama, The Great Disruption: Human Nature and the Reconstitution of Social Order, fq. 18-19

"Hadithe të zgjedhura - Perla të urtësisë nga i Dërguari i Perëndisë"
në 300 faqe, mbi 1000 hadithe, në tema të ndryshme,
me vlerësim nga dijetari Nasirudin Albani

Shtëpia botuese "Nun" - Shkup

tel: +389 2 320827

Ndikimet në shtëpitë tona

Shtëpia sot është e mbushur me influenza të shumta. Disa prej tyre janë brenda shtëpisë dhe të tjera janë jashtë saj. Është shumë e rëndësishme që ne të kemi kujdes nga influencat e tyre. Le të shikojmë disa prej tyre:

Shkolla

Shtëpia nuk është i vetmi vend ku vajzat tona edukohen. Është edhe një institucion që e ndan me të (shtëpinë). Shkolla ka një influencë të dukshme. Ne kemi nevojë për të pyetur veten se çfarë efekti kanë shkollat tek vajzat tona.

Ne mund t'i përgjigjemi kësaj pyetjeje vetëm nëse ne duam të hapim sytë tanë dhe të shohim mirë se çfarë janë duke sjellur vajzat tona në shtëpi. A vinë ato në shtëpi me dituri të të saktë, me sjellje të mira dhe madhërim për Allahun apo këto cilësi zvogëlohen dita-ditës?

Është gabim për ne për të vendosur fëmijët tanë në çdo shkollë dhe pastaj t'i themi vetes që fëmijët tanë janë në duar të mira. Ne më mirë t'i bëjmë disa gjëra të qarta që në fakt të jemi ne ata që i kanë vendosur ata në duar të mira. Madje edhe kur ne të jemi konfident që ajo shkolla është e mirë ne nuk harrojmë rolin që ne kemi për të luajtur në atë shkollë.

Shokët

Vajzat tona domosdoshmërisht do të kenë një grup shoqesh me të cilat rrijnë në shkollë apo diku tjetër. Ata shpesh formojnë lidhje të forta me njëra tjetrën dhe kalojnë një kohë të gjatë së bashku. Këto shoqe mund të jenë të mira por edhe atëhere ne duhet të jemi të kujdesshëm që ata të mos udhëheqen nga ndonjë vajzë e cila nuk është e virtutshme

dhe e cila mund të llastojë vajzat e tjera përreth saj.

Ka histori të tmerrshme që unë mund t'ju tregojë që ju do ta keni vështirë t'i besoni dhe këto histori i përkasin madje jo vajzave në shkollë të mesme por në ato elementare. Vajzat në këtë moshë janë shumë naive dhe impresionohen shumë lehtë. Zemrat e tyre janë tepër të pastra. Mund të ndodh që të jetë një vajzë midis tyre e cila është e keqe dhe në të njëjtën kohë të posedojë një personalitet të fortë. Një vajzë e tillë mund të humb (nga rruga e drejtë) shumë të tjera.

E njëjta mund të thuhet edhe për djemtë. Shokët dhe miqtë janë midis influencat më të fuqishme që një fëmijë mund të ketë dhe është detyra e prindërit t'i largojë nga ata. Prindërit duhet të dinë se kush janë shokët e fëmijëve të tyre.

Nëse ne ia dalim me sukses në kthimin e të rinjve tanë dhe grave në thirrësa islam në shtëpitë e tyre ne do të arrijmë shumë. Ne do të jemi të aftë për të arritur brenda çdo shtëpie dhe të ketë një efekt pozitiv mbi çdo anëtarë të gjeneratës së ardhshme.

Ka mënyra për të arritur efekt në reformat brenda shtëpisë:

1) Duke vendosur një prezencë në shtëpi përmes shërbimit të familjes.

2) Duke përdorur metoda të ndryshme të edukimit, mësimit dhe udhëzimit brenda shtëpisë.

3) Duke monitoruar anëtarët e familjes që keni nën kujdesin tuaj dhe duke i mbrojtur ata, pa u bërë dyshues, pa u lodhur ose të shpall veten si i pafuqishëm për këtë.

Ne i kërkojmë Allahut që kjo të ndihmojë njerëzit për të përmbushur rolet e tyre përkatëse në familjen e tyre. Qëllimi im për ta shkruar ishte që njerëzit ta vendosin këtë në praktikë. Sot ka shumë influenca negative që sillen rreth shtëpive tona dhe ata janë aktiv brenda familjes tonë në një mënyrë apo tjetër.

Këngëtari zëri i të cilit dëgjohet në shtëpitë tona, valltari, folësi, kasetat, librat, volumet e poezive, fotografitë dhe revistat janë të gjitha

pjesë e një komploti për të na influencuar ne. Askush nuk është i shpëtuar nga efekti i keq përveç atë që e ka mbrojtur Allahu.

Ne i kërkojmë Allahut të na jap sukses në reformimin e shtëpive tona dhe duke përmbushur besimin që Allahu ka vendosur mbi ne. Allahu i di më së miri punët tona.

Dhe paqja dhe bekimet e Allahut qoftë mbi robin e tij dhe të dërguarin e tij Muhammedin, salallahu alejhi ve sel-lem, dhe mbi familjen e tij dhe shokët e tij.

Selman el-Avdee

Marrë nga: Thirja brenda shtëpive tona
Përktheu: Ammar Ardit Kraja

Po, u bëra një myslimane

Ruga ime drejt islamit nuk qe e komplikuar, por sipas disa prej njerëzve të rrethit tim familjar e shoqëror, ajo qe ndoshta pak e papritur... Njëzet vitet e para të jetës sime i kalova si ateiste. Të them të drejtën, besimi fetar nuk më interesonte shumë. Ndonjëherë mendohesha nëse egzistonte ndonjë fuqi hyjnore, ose ç'ndodh me ne pas vdekjes, por këto ishin thjeshtë mendime pa rëndësi për mua. Pas përfundimit të studimeve, vendosa të udhëtoja e të studioja jashtë shtetit. Për dy vjet me radhë, punova e studiova njëkohësisht. Gjatë kësaj kohe u njoha me disa të krishtera. Njëra prej tyre u be shoqja ime e ngushtë. Lu përgjigja dëshirës së saj dhe fillova të ndiqja një kurs që kishte për qëllim njohjen me krishterimin. Meqenëse kam një karakter të hapur, bëja shumë pyetje dhe interesohesha për shumë gjëra. Por nuk më pëlqente që shumë prej pyetjeve të mia nuk iu përgjigjej njeri. Brenda në shpirt besoja që egzistonte Zoti. Megjithatë, nuk kisha vullnetin e duhur për të zbuluar më tepër.

Pas kthimit në Sllovaki, u përpoqa të integrohesha në jetën e këtushme, por pa sukses. Kisha një punë, kisha miq por s'isha e lumtur. Vendosa të udhëtoja përsëri, këtë herë në një vend tjetër. Atje u njoha me bashkëshortin tim të ardhshëm. Zhvillova me të diskutime mbi fenë dhe ai më solli libra mbi besimin islam. Të them të drejtën, fillova t'i lexoj ato me paragjykime. Pas leximit të librit të parë, u binda që çka shkruhej aty ishte e vërtetë. Gjeta aty ato gjëra që kisha kohë që po i kërkoja. Zoti më nxorri më në fund në dritë. Vendimin për t'u bërë myslimane nuk ia thashë as të fejuarit tim. Thjeshtë e bëra fakt të kryer dhe u ndieva sikur hoqa nga shpirti një barrë të rëndë. Më pushtoi një gëzim i madh. Doja të dija përherë e më tepër. Doja të mësoja si të lutesha, në arabisht sigurisht, doja të lexoja Kuranin dhe të njihesha me myslimane të tjera.... Nuk ishte aspak e vështirë të zbatoje ato që Zoti na urdhëron të kryejmë. U mbulova me shami vetëm pas nje viti pasi nuk isha e sigurtë nëse kjo ishte dhe bindja ime e sin-

qertë. Ido njohuri e re mbi islamin më sjell një gëzim të papërshtuar. Elhamdulillah!!!

Nga ana tjetër kisha frikë çdo më thoshin prindërit dhe miqtë për vendimin tim por nuk pati aspak probleme. Dëshiroj që edhe ata, të gjejnë rrugën për tek Zoti por nga ana ime, e vetmja gjë që mund të bëj për ta është t'i njoh ata me islamin, pastaj zgjedhja është në dorë të tyre. Nëse Zoti i Madhërueshëm ua ka bërë risk atyre islamin, atëherë ata do të vijnë tek ai në një kohë të volitshme. Dëshira ime është që në Sllovaki, njerëzit të mos kenë paragjykime ndaj islamit dhe myslimanëve. Isha mësuar që të mos i gjykoja njerëzit nga pikëpamja etnike dhe as fetë nga pikëpamja e besimtarëve përkatës.

Përveç kësaj, shumica e njerëzve mendon se shumica e myslimanëve janë arabë, gjë që s'është e vërtetë. Në fakt shumica e myslimanëve s'janë arabë.

Zoti më dhuroi një bashkëshort të mirë, por edhe pengesa të ndryshme, por unë e di se se këto përbëjnë provime për besimin tim. Me ndihmën e Zotit gjithçka do rregullohet dhe unë do të gjej një vend ku të ndihem e qetë. Kam në plan të kthehem në Sllovaki, të jetoj këtu dhe të njihem me sa më shumë myslimanë sllovakë. Islami është besimi ku të gjithë ndihen të barabartë. Nuk ka rëndësi se nga e kemi prejardhjen apo se ç'ngjyrë kemi... Ju uroj të gjithëve të keni bekimin dhe mirësinë e Zotit.

Marwa-ja nga Sllovakia (2005)

© islamweb.sk

Të drejtat themelore të bashkëshortëve

Të drejtat dhe obligimet e secilit nga bashkëshortët hyjnë në fuqi me lidhjen e kontratës martesore së tyre (niqah). Nuk ka nevojë për përmendjen e tyre në kontratë sepse ato janë të kuptueshme si pjesë integrale të saj. Ka një konsensus midis dijetarëve përsa i përket këtyre të drejtave, ashtu siç janë marrë nga Kur'ani dhe Sunneti i saktë dhe janë pjesë e themelore e sheriatit (legjislacionit islam). Nuk është e qëllimtë këtu për t'i diskutuar ato në detaje dhe të numërojmë burimet e tyre. Të tilla informacione mund të gjenden në libra mbi subjektin ose në fikhun në përgjithësi. Të drejtat e përbashkëta do të përmenden shkurtimisht vetëm për të treguar efektin e një kontrate martesore mbi secilin nga bashkëshortët.

Ato janë të ndara në tre kategori: të drejtat e përbashkëta, ato të burrit dhe ato të gruas.

1). E drejta e secilit nga bashkëshortët mbi njëri-tjetrin

a). E drejta për sjellje të mirë dhe të drejtë nga bashkëshortët.

b). E drejta për përmbushjen e kënaqësive seksuale.

c). Vendosija e një marrëdhënie mahremi (të afërta) midis burrit dhe nënës së gruas së tij, gjyshes, vajzave, mbesave etj., dhe midis gruas dhe babait të burrit, stërgjyshërve, djemve nipave etj...

d). E drejta për edukimin e fëmijëve të lindur brenda martesës.

e). E drejta për trashëgimi pas vdekjes së njërit nga bashkëshortët.

2). Të drejtat e burrit

a). Njohja nga ana e gruas pozitën e autoritetin e burrit dhe sjellja e saj e përshtatshme ndaj tij.

b). Bindja në gjithë atë që është e drejtë dhe nuk përfshin mosbindje ndaj Allahut dhe të dërguarit të tij. Kjo është shumë e theksuar në lidhje me marrëdhëniet seksuale. Bindja është obligim mbi gruan në rrethana normale.

c). Shërbimi në shtëpi sipas zakonit dhe dokeve, ka patur shumë shembuj të kësaj natyre në familjen e pejgamberit dhe gratë e sahabeve.

d). Ajo nuk duhet të lejojë në shtëpi askënd të cilin ai nuk e pëlqen pa lejen e tij, madje edhe nëse ai/ajo të jetë nga të afërmit e gruas.

e). Qëndrimi i gruas në shtëpi. Ajo mund të shkojë ose shëtisë brenda një zone të cilën ai e lejon. Sipas kësaj, shtëpia duhet të jetë e përshtatshme, të posedon vend për liri (vend të qarkullojë lirisht), siguri dhe rehati.

f). Disiplinimi i gruas për mosbindje të vullnetshme dhe rebelim kundër burrit përderisa ai nuk urdhëron ndonjë gjë të ndaluar. Duhet të jetë brenda kornizave

të shariatit dhe të mos përfshijë agresion kundër saj ose padrejtësi ndaj gruas.

3). Të drejtat e gruas

a). Mehri.

b). Përkujdesja, e cila përfshin të gjitha ato që gruaja ka nevojë si ushqim, veshje, banesë, ilaçe etj.. në modelim sipas zakonit dhe dokeve, madje edhe nëse ajo është e pasur ose e pamvarur nga kjo ndihmë.

c). Sjellja e mirë, këndshmëri dhe konsideratë për ndjenjat e saja.

d). Drejtësia midis grave kur burri ka më shumë se një. Kjo do të thotë barazi në furnizim, në kalimin e kohës me secilën dhe sjelljen e drejtë, të gjithë këto sipas aftësive të burrit. Kjo nuk përfshin barazinë e ndjenjave ndaj tyre, gjë e cila është e pamundshme.

e). Edukimi dhe udhëzimi fetar. Ai duhet t'i mësojë asaj nëse ajo nuk është e informuar ose ta furnizojë atë për të mësuar nëse ai vet është i paaftë për këtë gjë. Ai duhet ta inkurajojë atë të përmbushë detyrat e saja ndaj Allahut dhe ta pengojë atë nga sjelljet e palejueshme dhe ai do të përgjigjet për neglizhencë përse i përket kësaj.

f). Mbrojtja e reputacionit të saj dhe vet të saj nga çfarëdo lloj dëmi.

Umm Muhammed

Marrë nga "Marriage Procedure in Islam"

Përktheu: Ammar Ardit Kraja

Usame ibën Munkidh

Usame ibën Munkidh ishte Muejjid Ed-Devle Ebul Harith Usame Ibën Murshid Ibën Ali... Ibën Munkidh. Shkurt, Usame ibën Munkidh. Ne, edhe më duke shkurtuar, do ti themi Usame. U lind në datën 4 të Korrikut të vitit 1095, në afërsi prej 20 kilometreve të Hamanit në qytetin e Shajzerit 24 vite pas luftës së Malazgirtit që bëri Sultani i Selçukëve Alparslani me Imperatorin e Bizansëve Diogenin ose katër vite para se ta okupojnë Kudosin të krishterët.

Duhet ti freskojmë dituritë tona madje edhe ti përforcojmë për ndodhit që kanë patur vlerë të shënohen dhe për vrojtimit në jetën e Usames, të transferuara në tregime, që Libri i Shembujve të lexohet në mënyrë më të dobishme për kohën e atëhershme dhe për personat e rrëndësisëm që përmenden në këtë libër.

Qyteti Shajzer, ku është lindur dhe është rritur Usame, është i njohur për nga përqëndrueshmëria prej periudhës antike. Emri i tij (i qytetit) përmendet në epitafet (mbishkrime varri) Egjiptase dhe në një poezi të Imru'l Kajsit. Në tekstet Egjiptase përmendet me emrin Senzar ose Sezar, ndërsa në Greqishten e vjetër Sidzara. Arabët i thonë Shajzer dhe ky emër kështu mbetet deri ditëve tona.

Qyteti është në bregun e lumit Asi, që gjendet në majen e një kodrine të vogël por e thiktë e cila ka okupuar një kthesë të lumit, të cilit (breg) poetët arab i thonin "Urf el-Dik (Krahu i Gjelit)".

Njëra prej dy rrugëve kryesore që mundeshet ta përcillte ushtria e kryqëzatave që

vinte nga veriu kalonte në afërsi të këtij qyteti.

Ndërsa rruga tjetër, sipas disa gjasave, ishte rrugë e bregut që shkonte mbi Lazikijen (Lazikije). Kalaja e Shajzerit është ndërtuar mbi këtë kodër që quhet Krahu i Gjelit. Në të njëjtën kohë, është një kala që shumë rrëndë okupohet për shkak se mbrohet prej lumit Asi.

Ushtritë Islame këtu kanë arritur 17 vite pas Hixhretit, në vitin 638. Banorët e qytetit e kanë pritur me këndime (kuptohet këngë islame) Ebu Ubejden, radjallahu anhu. Prej asaj date e këndeje qyteti ndonjëherë është okupuar nga ana e Bizansëve. Por më së shumti ka qenë në duar të muslimanëve.

Gjatë viteve 1025, atëbotë toka që gjindej në rrethinën e kalasë së Shajzerit ishte në duart e Bizantinasve. Ndërsa kryetari i Halepit Salih El-Mirdasi ua dorëzoi Munkidhëve, të cilët ishin të lidhur me familjen Beni Kinane, ose stërgjyshërve të Usames.

Nga gjyshërit e Usames, Munkidhi Mukallled udhëheqësi i Kefertabit, një ndër qytetet më me vlerë të vendit, tokat e veta i ka zgjerruar deri te lumi Asi dhe përafërsisht në vitin 1040 ndërtoi Kalanë e Urës (Hisn el-Xhisër, Xhisër-i Beni Munkidh) në një rafshinë afër Kalasë së Shajzerit.

Këtë krahinë, që më pas u shëndrua në vendbanim, në këtë përkthim do ta përmendim si 'Urë e lagjes'.

Shajzeri, me sa duket pas rrethimit, kalon në duart e gjyshit të Usames Izzud-devle Munkidh' it në bazë të marveshjes së

bërë me një peshkop që kishte pozitë atje i cili quhej El-Bara.

Lejohet që, Forcat Mbrojtëse të Bizantinasve që gjendeshin në Kala, lirisht ta lëshojnë vendin. Një vit pas lirimit të kalasë, në 1082 ndërrohet jetë Izzuddevle Munkidhi ndërsa në vend të tij erdhi Izzuddevle Ebul Nasri.

Ky person ishte xhaxhai i Usames. Gjatë kohës së udhëheqësisë së tij në kufinj të veta shtynë edhe Afamijen, Kefertabin dhe Lazikijen. Në vitin 1086 ishte i detyruar që t'ia dorëzon komandantëve të Melikshahut, Sultanit të Selçukëve.

Në vitin 1097, duke qenë Usame dy vjeçar, Antakinë e okupojnë Kryqëzatat. Pas një kohë të shkurtër, në vitin 1098 vdes Ebu'l Murhafi.

Sipas spjegimeve të Usames i vijuari (halefi, udhëheqësi me radhë) është musliman i devotshëm, në jetën e vet ka qenë i preokupuar me ibadet, gjueti dhe me shkrim të bukur (hat).

Ky (udhëheqësi me radhë) është babai i Usames, Mexhdeddin Ebu Selame Murshid i cili heq dorë nga udhëheqësia në favor të vëllaut të tij Sultanit Ebu'l Asakir, duke thënë "Pasha Allahun, udhëheqësinë nuk mundem ta pranoj. Sikur që kam ardhur në këtë botë ashtu dua edhe të shpërngulem".

Në kohën e udhëheqësisë së Ebu'l Asakirit kalaja shpesh herë mbetet e pa mbrojtur nga rrethimet e Kryqëzatave. Kohë pas kohe kalanë e rrethojnë edhe Bizantinasit, Batinitë dhe disa udhëheqës musliman të rrethinës. Ja pra, moshë e pjekurisë së Usames haset në këtë periudhë të stuhishme. Tash, para se ta përmbledhim jetën e Usames, për një moment të largohemi nga Shajzeri, për ta paraqitur panoramën e periudhës.

Kjo periudhë, ka qenë periudhë më e fortë nën udhëheqësinë e Sultan Melikshahut dhe vezirit të madhë Nizamulmulkit të Imperatorisë së Madhe të Selçukëve. Prezenca e Kalifatit të Abbasitëve mbante një vlerë simbolike. Edhe pse Bizansi mundoheshte të zgjerohet kohë pas kohe në jug dhe veri, por nuk mundeshte të çon krye prej sulmeve të Selçukëve. Anadolia dal ngadal i del prej kontrole. Evropjanët, të cilët Usame i përmend me emrin Frenk (Efrenc) në veçanti okupojnë rripin e bregut duke ardhur prej veriu dhe prej brigjeve lindore të detit Mesdhe. Kuds, Nablusi, Antakia, Lazkia, Trablusi, Gaza, Kefertabi dhe Afamia të cilët ishin afër Shajzerit mbetën në duart e Kryqëzatave. Në rajon, janë formuar shtete të vogla Kryqëtare si Mbretëria e Kudsit dhe Principatë e Antakisë. Këto shtete kohë pas kohe duke i bashkuar ushtritë e veta sulmonin mbi Muslimanët. Guximin e tyre e kanë shtuar deri të rrethimi i Shamit.

Në Irak dhe Siri udhëheqësinë në duart e veta e ka komandanti i madhë Atabek Nureddin Zengi'u i lidhur me Sultatin e Selçukëve.

Pastaj njeriu i cili do ta mar në kontrol tërë rajonin Salahuddin Ejjubi do të jetë njëri prej komandantëve të lidhur me Nureddin Zengi'un.

Nureddin Zengi'u, komandantët e vet ditë e natë i urdhëron të luftojnë dhe të vrapojnë prej një kalaje në tjetrën.

Nën udhëheqësinë e Artukogullëve (Djemtë e Artukut, familja e Artukut) ka qenë një pjesë e rëndësishme që sot godet rajonin jug-lindje të Turqisë. Forcat e Atabek Zengi'ut kohë pas kohe rrethonin qytetet e Artukogullëve. Gradualisht zgjerojnë udhëheqësinë e vet.

Kalifët Fatimij përjetojnë periudhën e fundit në Egjipt. Vezirët gropojnë pusët njëri tjetrit. Me një fjalë zhvillohet një luftë e brendshme. Para se të mbaron një luftë e brendshme fillon tjetra. Kjo gjendje vazhdon derisa nuk i jep fund kalifatit Fatimij, Salahuddin Ejubi.

Ja pra, "vrojtimit dhe ndodhitë e shënurara me vlerë" nga Usame në Kitab El-l'tibar na e paraqesin këtë periudhë me tërë gjallërinë e saj.

Me tërheqjen e Murshidit, babai i Usames, nga udhëheqësia pushtetin në duart e veta e merr xhaxhai i tij. Pasiqë xhaxhai tij nuk kishte djal, ai Usamen e edukon si princ trashigues. Usames i ipet edukimi më i mirë i mundshëm. Ky edukim, Usames ia mundëson të bëhet një luftëtar i mrekullueshëm, komandant i suksesshëm, poet dhe edukator i madh.

Gjatë kësaj kohe mësimet i ndjek te kryetari i Darul Ilmit nga Trablusi i cili kishte ardhur në qytetin Shajzer, dijetar i retorikës dhe gramaticienti Ebu Abdullah Tulejtuli (Andaluzi, Toledo: Tulejtul), nga dijetari i shkencës së hadithit të asaj kohe El-Samani dhe nga dijetar tjerë të Shajzerit.

Merr pjesë pothuajse në të gjitha luftërat që zhvillohen në Shajzer dhe rrethinë. Megjithëse ishte i rri, për shkak të asaj që ishte princ trashigues në disa luftëra udhëheqësia i ipet atij.

Mirëpo, më pas xhaxhait të tij Sultan Ebu'l Asakirit i bëhen djemtë. Dal ngadal relacionet me xhaxhain e tij ashpërsohen. Xhaxhai i tij, fillon ta urrej Usamen të cilin e kishte rritur me kujdes. Usame, me sa duket nga shtypja e xhaxhait të tij, në vitin 1138 nga Shajzeri vendoset në Sham. Në Sham, hynë nën përkujdesjen dhe mbrojtjen e Emirit Muinuddin Enar (Unar). Merr pjesë në disa luftëra dhe pasi që fillojnë të

acarohen relacionet mes Atabek Nureddinit me Muinuddinin, largohet nga Shami dhe shkon në Egjipt.

Në Egjipt gjindet në rrethinat e pallateve të vezirëve Fatimij. Me dëshirë ose pa dëshirë, pozicionohet në grindjet dhe përçarjet e brendshme. Kushtet detyrojnë që të largohet nga Egjipti. Përsëri kthehet në Sham. Gjatë asaj kohe ndodh një tërmet i fortë ku në rrethinë së bashku me disa qytete edhe Shajzerin e bënë rafsh me tokën. Atëbotë nuk mbeti shtëpi pa u rrënuar në Shajzer, i cili ishte nën udhëheqësinë e kushëritit të Usames, Taxhuddevleti. Spjegimet e Ibën Ethirit, mësues i cili gjatë tërmetit gjendej jashtë ndërtesës shkollore, tregojnë se: "Bile asnjë mbrojtës nuk erdhi të pyet për pasojat e fëmijëve. Sepse të gjithë kishin vdekur". Kështu përfundon historia e Munkidhëve në Shajzer. Kjo fatkeqësi thellë e prekë Usamen. Usame, në një poezi që bënë pjesë në Ravzatejn, thotë: "Sado që të kishin patur urrejtje dhe armiqësi ndaj meje;

Gjaku i djemve të xhaxhait tim është gjaku im, sikur gjaku i djemve të babait tim".

Kur qyteti mbetet pa mbrojtësin e vet Atabek Zengiu e okupon Shajzerin. Me sa duket, pasi që u frigonte se Shajzeri me të drejtë do t'i takonte Usames, atëherë ky e dëbon Usamen nga Shajzeri. Pas kësaj Usame shkon në Hasankejf (Hýsn-ý Kejfa) e cila ishte nën kontrollin e Fahredin Kara Arslanit nga Artukogullët. Aty qendron deri sa të ndron jetë Nuredin Zengiu.

Pas vdekjes së Nureddinit rajonin nën kontroll të vetin e mer Salahudin Ejubi në vitin 1174. Kur Shami kalon në duart e Salahudinit, Usame atëher kthehet në Sham. Në Sham nga ana e Salahudinit mirëmbahet, nderohet dhe paguhet. Deri atëherë ende prej një qyteti në qytet tjetër, prej një

shteti në shtet tjetër, nga një luftë në luftë tjetër. Usameja i cili vizitoi, Bitlisin, Dijarbakërin, Musulin, Bagdatin, Kairon, Kudusin, Nablusin dhe qytete tjera, vitet e fundit të jetës së vet në mënyrë të qetë i kalon në Sham, ku edhe ndërton jetë me 16 Nëntor 1188, ditën e Hënë (H. 23 Ramazan 584).

Marrë nga: Memoirs of Usamah ibn-Munqidh, versioni në turqisht
Përktheu: S.A.

Të nesërmen (një ditë pas) varoset në anën e lindjes së Xhebel-i Kasijun'it.

Usame gjatë 93 viteve ka shkruajtur disa vepra, mirëpo nuk njihen aq shumë për shkak se pjesa më e rrëndësishme e veprave nuk ka arritur deri në ditet e sotshme.

Esed ibën Furat

Jemi kthyer në kohë, në Tunizinë e gjelbër në vitin 162 sipas kalendarit hixhrij. Është ditë e tubimit të madh. Sot Tunizia përcjell kërkuesin e dijes që udhëton për në Lindje. Në ditët e sotit kërkuesit e dijes udhëtojnë për në perëndim, përdërisa jo shumë shekuj më parë caku i tyre ishte Lindja, djepi i qytetërimit dhe zhvillimit.

Njerëzit sot janë tubuar për ta përcjellur njeriun tridhjetëvjeçar, ardhacak në Tunizi me prejardhje prej krahinës së Nejsaburit, i lindur në qytetin Dijarbekir. Atin e tij e kishte dërguar halifeja El Mensur që t'i jep fund rebelimit të Berberëve në perëndim. Ky djalosh rininë e kaloi në Tunizi duke kërkuar dije në tubimet e dijetarëve të saj. Pasi që në këto tubime kaloi kohë të mjaftueshme vendosi të vazhdon udhëtimin e dijes në Lindje.

Kështu filloi udhëtimi i Esed ibën Furatit, i cili pasi lundroi nëpër detet e ujit dhe të shkretëtirës arriti në Medine e cila në atë kohë ishte qendër e dijes në udhëheqjen e Imamit të saj Malikut, All-llahu e mëshiroftë. Me modestinë e kërkuesit të dijes u ul para Imam Malikut. Imam Maliku kishte pamje që nxiste respekt, askush nuk merrte guxim që të flet para tij. Në tubimet e tij më shumë dëgjohej se sa

debatohej, nuk kishte vend për parashikimin e situatave dhe ndodhive të ndryshme, dhe dhënien e dispozitave rreth tyre, siç vepronin dijetarët e Irakut. Esedi ishte i guximshëm dhe për çdo çështje pyeste detajet më të imta. Ata që druheshin që pyetjet e tyre t'ia parashtrojnë imam Malikut këtë e bënin me anë të Esedit. Pas dy vjet qëndrimi në gjirin e imam Malikut, ibën Furati vendosi që kërkimin e dijes ta vazhdon në Irak. Hyri tek imam Maliku i cili e porositi me devotshmëri, me kujdes ndaj Kur'anit dhe me këshillim të njerëzve.

Në kohën kur Esedi arriti në Irak, imam Ebu Hanifeja vetëm se ishte shpërngulur në ahiret. Mësimdhënien pas tij në shkollë e morën për sipër imamët Ebu Jusufi dhe Muhammedi, All-llahu i mëshiroftë. Pas angazhimit të Ebu Jusufit me çështjet e gjyqësisë, mësuesi kryesor në medresenë e Irakut mbeti Muhammed ibën Hasen Esh Shejbani. Në tubimin e tij u ul edhe djaloshi që kishte ardhur prej perëndimit i cili përpos dërsit të rregullt, kërkoi edhe mësim të veçanta me mësuesin e tij. Këtë etje për dituri e vërejtë Imam Muhammedi i cili i dha një dhomë në shtëpinë e tij dhe se bashku me të kalonte netët dhe ditët duke lundruar nëpër detet e dijes pa fund. Për këtë angazhim imami nuk kërkoi

as pagë e as shpërblim, përkundrazi ai nxënësit të tij ia siguronte mjetet e jetës.

Kështu e kuptonin dijen të parët tanë. Ajo ishte adhurim me të cilin i afroheshin All-llahut, subhanehu ve te'ala, e kërkonin për të fituar kënaqësinë e Tij. Edhe mësuesi edhe nxënësi qëllim të vetmin e kishin All-llahun, xhel-le she'nuhu. Esendi i cili kaloi një kohë të gjatë me imam Malikun dhe Muhammedin, ishte i pari i cili u mundua t'i bashkon dy shkollat e ndryshme juridike, atë tradicionale të imam Malikut dhe racionale të Ebu Hanifës dhe nxënësve të tij.

Pas Iraku morri udhën për Egjipt, për të mësuar para dy nxënësve të imam Malikut, Esh'hebi dhe Ibën Kasimi, i pari ishte i ashpër në kohë që i dyti dallohej me butësi dhe mëshirë. Dijen që e tuboi në udhëtimet e tij e shënoi në librin El Mudevvene e cila është e njohur edhe me emrin "El Esedijje".

Kur nxënësit shprehën dëshirë të përkraheshin librin në fjalë, u habitën me refuzimin e Esedit dhe vendosën ta paditin para gjykatësit. Gjykatësi i habitur nga kjo padi, e studioj librin dhe e pa se në të ishin shënuar meselet që i kishte tubuar Ibën El Kasimi dhe nga paditësit kërkoi që edhe ata të vizitojnë Ibën El Kasimin dhe të mësojnë prej tij. Tha: Unë nuk kam mundësi ta detyroj Esedit që t'ua mundëson përkrahimin e librit, por do të mundohem të ndërmmjetësoj. Pas ndërmmjetësimi të kadiut Esedi e lejoi përfitimin nga libri i tij prej tjerëve. Më vonë ky libër u bë bazë e shkollës juridike të pasuesve të imam Malikut. Pas mungesës njëzetvjeçare u kthye në Kajrevan, qytet ky i cili në atë kohë ishte kryeqyteti i Magribit (perëndimi) mysliman. Në moshën pesëdhjetë vjeçare u ul për herë të parë në vendin e mësuesit, dhe me energji të madhe filloi të shpërn-

dan diturinë që e kishte mësuar gjatë udhëtimit të tij. Një nxënës i tij me emrin Sehnun morri librin e tij dhe udhëtoi në Egjipt dhe të njëjtin ia paraqiti Ibën Kasimit i cili tashmë kishte ndryshuar disa nga mendimet që i ka pasur. Ibën Kasimi i shkroi letër Esedit duke kërkuar që edhe ai t'i bën ndryshimet, gjë kjo të cilën ai e refuzoi. Librin me ndryshimet e Ibën Kasimit e morri Sehnuni dhe prej asaj dite ajo filloj të quhej Mudevvenetu Es Sehnun, edhe pse origjinalin e librit e shkroi Esed ibën Furati. Pas njëzet vjet të kaluara në mësimdhënie, u emërua në postin e kadisë.

Në këtë shkrim folëm për Esedin si dijetar... në shkrimin që vijon do të shohim çfarë bëri ky njeri si udhëheqës i ushtrisë dhe admiral i flotës...

Myslimanët ishin sundimtarët e brigjeve të detit Mesdhe. Sundimi i tyre shtrihej në gjysmat e brigjeve perëndimore dhe lindore, dhe përgjatë bregut jugor. Për bregun verior vlente marrëveshja e nënshkruar me Italinë dhe ishullin e Sicilisë. Kur emirit të Magribit, Zijadetull-llah i erdhi lajmi, për gjendjen e vështirë të myslimanëve në Sicili vendosi të konsultohet me kaditë e atij vendi dhe në oborrin e tij i ftoi Kadiun Ebu Mihrez dhe kadiun Esed Ibën Furat. Për lajmin të cilin e solli vet sunduesi i Sicilisë dy dijetarët kishin qëndrim të ndryshme. Ebu Mihrezi ishte i mendimit që lajmi i një personit nuk mjafton në kohë që Esedi thoshte: Marrëveshjen e kanë nënshkruar të dërguarit e dy shteteve dhe lajmërimi për prishjen e saj nga njëra prej dy palëve nënshkruese mjafton për anulimin e saj. Kjo përgjigje e Esedit ishte e mjaftueshme që emiri të fillon përgatitjen e flotës detare.

Esedi kërkoi që të merr pjesë në këtë betejë, dhe kërkesën e tij emiri e pranoi

pas një refuzimi fillestar. Emirin e bindi fjala e Esedi i cili tha: Ju keni detarë që shumë mirë i drejtojnë anijet e fitores, por ju nevojitet një dijetar i cili do t'i drejton me Librin e Allahut dhe Sunnetin e të Dërguarit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem. Kur i dëgjoi këto fjalë emiri vendosi që Esedi të jetë komandanti i ushtrisë në atë betejë. Pas emërimit në atë post kadiu tha: Pse po ma ul gradën e kadiut në gradë të emirit? Nuk ta kam ul gradën, u përgjigj emiri, postit tënd si gjykatës ia kam bashkangjitur edhe postin e emirit. Ti je edhe kadi edhe emir! (sh.p. Në atë kohë posti i kadiut, gjyqtarit çmohej më tepër se posti i sundimtarit)

Pasi që u kompletua flota e përbërë prej nëntëdhjetë e tetë anijeve ushtarake dhe dhjetë mijë ushtarë erdhi dita e përcjelljes. Në portin detar në Sevse ishte grumbulluar masë e madhe njerëzish. Pas fjalimit të emirit, para të pranishmëve foli edhe Esedi i cili nuk foli fjali ushtaraku e as që e kërcënoi armikun. E shfrytëzoi rastin dhe popullit iu drejtua me fjalët e mësuesit: "O ju të tubuar në këtë vend, pasha Allahun, këtë post nuk e kam trashëguar sepse nga të parët e mi nuk ka pasur sundimtarë. Këtë post e kam arritur me dijen time. Mësoni sa më tepër, lodheni trurin dhe trupin e juaj në përvetësimin e dijes. Me dije do ta fitoni dynjanë dhe ahiretin."

Imami në shkencat e fesë dhe në artet ushtarake. Sikur ju shoh se si e pyetni vetën, çfarë do të bën ky njeri me flotën detare? Ku ka mësuar për mënyrat e luftës dhe betejës në det...

Fitorja e tij e madhe është argument për aftësitë e udhëheqësit që nuk trem-

bet, emri i tij (Esed-Luan) përshtatet me të emëruarin. Ishte vërtet një luan.

Ditët e betejës u zgjatën, zahireja filloi të pakohet dhe përtacia filloi ti kaplon ushtarët. Në këto kushte filloi lëvizja e elementeve destruktive të rebelizmit, që kishin vendosur të shpallin mosdëgjueshmëri ndaj udhëheqësit. Koka e tyre, që e mbante të njëjtin emër si Esedi, komandantit ia shfaqti dëshirën e ushtarëve për kthim në vendlindje, një dëshirë që nga forma e jashtme duket e mirë e që në brendësinë përmban qëllimin e rebelizmit. Komandanti u mundua që me urtësi të qetëson situatën duke i përgëzuar me aftësinë e fitores dhe shpërblyerit të madh. Këto fjalë nuk ndikuan dhe rebelizmi vazhdoi të rritet. Esed ibën Kadimi që ishte në krye të rebelimit duke u kërcënuar tha: Halifeja Othmani është mbytur për gabim më të vogël se ky! Këto fjalë ishin deklarim publik i rebelimit. Çfarë mendoni, si do të përgjigjet dijetari sundimtar? A do ti nënshtrohet forcës duke u tërhequr? A do të lejon humbjen e fitores për shkak të trazirave apo do të tregon vendosmëri. Për komandantin në fjalë nuk kishte dilema. Vendosi t'ju kundërvihet rebelëve. Morri kamxhikun e rojës që e kishte afër, dhe me to goditi kundërshtarin e tij në fytyrë, dy herë. Bërtiti: Vazhdoni përpara drejtë fitores. Me këtë thirrje filloi beteja vendimtare përfundimi i së cilës ishte ngadhënjimi për myslimanët. Kjo fitore ishte fillimi i sundimit të Islamit na Sicili, që do të zgjatë shekuj me radhë. Çmimi i kësaj fitoreje ishte i shtrenjtë. Imami i dijes dhe luftës Esed ibën Furati rra shehid me flamurin e fitores në dorë.

Shkroi: Ali Tantavi

Marrë nga libri: Rixhalun Minet-tarih

Solli në shqip: Talha Kurtishi

Imam Muxhahid ibën Xhebr

Njëri prej tabi'inëve të njohur, nxënësi i Ibën Abbasit, radijall-llahu anhumā, dhe më i besueshmi kur janë në pyetje transmetimet prej mufesirit të sahabëve. Edhe pse transmetimet e tij janë të pakta, ato dëshmojnë qartë për dijen e tij të gjerë. Një kohë të gjatë nuk ndahej prej Ibën Abbasit prej të cilit e mësoi tefsirin e Kur'anit, fakt ky i cili e shtyri Buhariun që të mbështetet kryesisht në komentimet që i përcjellke prej mësuesit të tij. Kjo mbështetje mbi transmetimet e Muxhahidit flet qartë për besnikërinë e tij dhe pranimin e tij tek dijetarët.

Për vendin e lartë që e mban Muxhahidi në hierarkinë e dijetarëve të selefrit, dhe për dijen e tij të gjerë në lëminë e tefsirit flet ky transmetim: "Tre herë para Ibën Abbasit e lëxova tërë Kur'anin, dhe duke u ndalur në çdo ajet e pyetja për shkakun e shpalljes së tij dhe si është shpallur.

Ibën Ebi Mulejkete thotë: E kam parë Muxhahidin se si e pyeste Ibën Abbasin, radijall-llahu anhumā, për komentimin e Kur'anit dhe fjalët e tij i shënonte në pllakat që i kishte me vete. Kështu vepronte deri sa nuk e shënoi tërë tefsirin.

Për dijen e tij rreth tefsirit flet edhe transmetimi në të cilin qëndron: Nëse për ndonjë ajet të vjen komentimi i Muxhahidit, mos kërko tjetër, sepse komentimi i tij të mjafton. Kjo e shtyri imamin e biografëve, Imam Dhehebiun, që në fund të biografisë së Muxhahidit të shënon:

"Ummeti Islam është i pajtimit rreth faktit se Muxhahidi ka qenë një prej Imameve të dijes. Fjalët e tij pranoheshin si argument nga të gjithë. Të mjafton fakti se Imam Buhariu në sahihun e tij, dhe përmbledhës të tjerë të haditheve transmetimet e tij i kanë shënuar në librat e tyre."

Disa kritikues si vërejtje ndaj tij i përmendin pyetjet që ai ua bënte ithtarëve të Librit rreth disa ajeteve dhe komentimi racional për disa nga ajetet e Kur'anit.

Si përgjigje themi: Pyetjet e tij që ua parashtrohte ithtarëve të Librit nuk dilnin nga suazat e së lejuarës, sepse është larg mendjes që një nxënës i Ibën Abbasit të mbështetet në transmetimet e të krishterëve dhe hebrenjve.

Sa i përket komentimit racional pa mbështetje në të tekst të shpalljes, themi se çdo kush përpos të Dërguarit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka mundësi të gabon edhe pse gjurmët që Muxhahidi i ka lënë pas vete flasin qartë për dijen e tij të madhe. Nuk ka njeri që e mohon pozitën e tij në mesin e dijetarëve të gjeneratave të bekuara.

Transmetimet e tij rreth tefsirit janë tubuar në një libër që është i botuar dhe i pranuar si referencë nga dijetarët e kohës sonë.

All-llahun e lusim për mëshirë ndaj neve dhe ndaj këtij imami. O All-llah pranoe punën e tij, dhe ngrite në pozitë e larta të xhenetit. Amin!

Marrë nga: islamselect.com
Përktheu: Talha Kurtishi

Muaji Xhumadel Ahire

Kështu quhet muaji i gjashtë i vitit të Hixhretit. Emri i tij është marrë nga folja "xhemede" - "ngriu, u bë akull". Mori këtë emër, sepse edhe emërtimi i këtij muaji, ndodhi po ashtu në dimër. Ndërsa "ahireh" d.m.th. e fundit. Xhumadel Ahireh d.m.th. Dimri apo ngrija e fundit. Mund të hasni edhe përdorimin Xhumade Thanije - Dimri i dytë, por kjo nuk është e saktë, ngase kur thua "e dytë" nënkuptohet se ekziston edhe e tretë, gjë që nuk është realitet. Së paku, kështu është gjuhën arabe.

Muaji Xhumadel Ahireh, nuk ka ndonjë veçori nga muajt tjerë të zakonshëm, ndaj ne besojmë se të mirat dhe të ligat, nuk shtohen e as që pakësohen në këtë muaj, për dallim nga disa muaj tjerë, të cilët kanë veçori dhe për të cilët me siguri keni lexuar, siç janë muaji Sha'ban, Ramazan etj.

Në këtë muaj, gjatë historisë kanë ndodhur shumë ngjarje interesante, prej atyre, i kemi veçuar:

1. Në datën 16 të vitit 13 H (634 G) filloi beteja e Merexh Sufër, midis romakëve dhe myslimanëve, të cilët ishin nën udhëheqjen e Halid ibën Seidit. Kjo ishte në fillim të çlirimëve që bënin myslimanët në vendet e Shamit. Kjo betejë përfundoi me triumfin e romakëve, gjë e cila, e shtyri Ebu Bekrin, radijallahu anhu, të dërgojë katër ushtri të mëdhaja për ta çliruar Shamin.

2. Pesë ditë pas kësaj beteje, ndërroi jetë Ebu Bekër Siddiku, shoku i Resulullahut, salallahu alejhi ue selem, ai ishte prezent në çdo betejë që bëri Resulullahu, salallahu alejhi ue selem. E ka ndihmuar thirrjen

Islame me pasuri dhe shpirt. Pas Resulullahut, salallahu alejhi ue selem, udhëheqjen e shtetit Islam ia besuan atij. Ai e shoi rebelimin e renegatëve, i forcoi themelet e shtetit, bëri çlirime në Sham dhe Irak, e tuboi Kur'anin etj.

3. Të nesërmen, Omer ibën Hattabit iu besua udhëheqja e shtetit Islam. Ky ishte halifi i dytë dhe udhëheqja e tij zgjati mbi dhjetë vite. Gjatë udhëheqjes së tij, shteti Islam u zgjerua shumë. Ajo kohë ishte përplot përparime, dhe atë në sferën e qytetërimit, administratës, luftës dhe politikës.

4. Në datën 15, të vitit 96 H (715 G), ndodhi beteja "Dejrul Xhemaxhim", midis Haxhaxhit dhe Abdurahman ibën Esh'athit, i cili u rebelua ndaj hilafetit emevit, madje, i shpalli edhe luftë. Kjo betejë zgjati 100 ditë dhe përfundoi me triumf madhështor për Haxhaxhin. Me këtë u shua fitneja (rebelimi) e Abdurahmanit dhe u kthye stabiliteti i hilafetit emevit.

5. Në datën 3 të vitit 193 H (809 G), ndërroi jetë halifi i njohur abasit, Harun Reshidi.

6. Në datën 24 të vitit 392 H (1002 G), lindi dijetari i madh, Ebu Bekër Ahmed ibën Ali ibën Thabit, i njohuri Hatib el-Bagadi. Ky ishte njëri nga imamët e hadithit dhe historisë në shekullin e pestë hixhri. Ka të shkruara shumë libra, prej të cilëve më i njohuri është libri voluminoz: "Historia e Bagdadit".

7. Në datën 21 të vitit 658 H (1260 G), Kalaja e Damaskut ra në duar të tatarëve, pas një rezistimi të vdekshëm dhe pas një xhihadi të paparë. E kishin doemos ta dorëzojnë kalanë pas atij rrethimi të madh që e

bënë tatarët dhe pasi e gjuajtën me ka-tapulta. Me këtë, i tërë Shami ra në dorë të tyre.

8. Në datën 4 të vitit 885 H (1480 G), sulltan Mehmet Fatihu arriti të çlirojë qytetin Otranto të Italisë. Qëllimi i tij ishte që këtë ta bëjë bazë ushtarake dhe ashtu të arrijë në Romë dhe ta çlirojë, ashtu si e çliroi Kostantinopojën (Stambollin), mirëpo exheli ishte më i shpejtë, ashtu që ndërroi jetë në vitin 886 H (1481 G).

9. Në datën 12 të vitit 993 H (1527 G), sulltan Babër Shahu triumfon kundër një ushtrie të madhe induse, që përbëhej 100 mijë ushtarëve dhe 1000 elefantëve luftarakë. Babër Shahu vjen nga familja Tejmur, e cila sundoi Indinë tre shekuj.

10. Në datën 4 të vitit 950 H (1543 G) ushtria osmane rikthen kalanë e Beogradit, e cila ishte kala e fortifikuar dhe mjaft strategjike. Por, kjo ndodhi pas 15 ditë rrethimi dhe luftimi me ushtrinë gjermane.

11. Në datën 14 të vitit 1152 H (1739 G), shteti osman bën marrëveshjen e Beogradit me Gjermaninë dhe Rusinë. Aty u morën vesh që Gjermania t'ia dorëzojë Beogradin shtetit osman, pasi që e kishte okupuar 22 vite më parë, ndërsa Rusia, të rrënojë kalanë Azek dhe atë tokë t'ia dorëzojë shtetit osman, si dhe nuk do të guxojë asnjë anije e Rusisë të lundrojë në Detin e Zi.

12. Në datën 5 të vitit 1261 H (1845 G), forcat franceze zhdukin fisin Rebah të Algjerisë, duke i djegur të gjallë, ata dhe kafshët e tyre.

13. Në datën 5 të vitit 1298 H (1881 G), për së pari herë në gazetatat e Egjiptit, publikohet fotografi e njeriut. Kjo ishte në numrin 152 të gazetës "Ehram".

14. Në datën 17 të vitit 1320 H (1902 G), ushtria osmane arrin të shuajë një revolucion në Maqedoni. Atëbotë, Maqedonia ishte pjesë e shtetit osman dhe në të kishte kombe, kombësi dhe fe të ndryshme. Gati, sikur sot.

15. Në datën 25 të vitit 1334 H (1916 G), ushtria osmane i shkakton humbje të mëdha anglezëve në betejën "Kutul Imareh" në Irak. Ushtria osmane aty robëron batalion të plotë, që qe e përbërë nga 13 mijë ushtarë.

16. Në datën 7 të vitit 1389 H (1969 G), një ekstremist jehudi i Australisë i vë zjarrin xhamisë së bekuar të Aksasë. Ky zjarr gati do ta djegte tërë xhaminë. Jehuditë thonë se ky jehudi është i sëmure mentalisht.

17. Në datën 26 të vitit 1408 H (1988 G), Bashkimi Sovjetik braktisë Afganistanin pas një rezistimi shembullor që bënë myslimanët. Pas një xihadi të vërtetë që zgjati më shumë se tetë vite. Rusët u larguan duke lënë pas vete mbi 13 000 ushtarë të vrarë, si dhe humbja materiale që arrijnë miliarda të shumtë. Ndërsa, nga ana e Afganëve kishin rënë shehidë afër një milion njerëz dhe ishin larguar nga vendlindja mbi pesë milionë.

18. Në datën 22 të vitit 1420 H (1999 G), ndërroi jetë dijetari më i madh i këtij shekulli në shkencën e hadithit, shqiptari nga Shkodra, shejh Nasiruddin Albani. Ai ishte shpërngulur qysh në fëmijëri me prindërit e tij në Damask, ku edhe kishte bërë hapat e parë të dijes. Pas vete ka lënë vepra madhështore, për të cilat vepra ka nevojë secili shkencëtar i fesë. Fatkeqësia më e madhe është, që këtë kolos të tjerët e njohin dhe e respektojnë më shumë sesa ne shqiptarët. Allahu na drejtoftë.

Omer Berisha

Dëshmia e rrejshme

36. Ebu Bekrete, radijall-llahu anhu, transmeton se Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: A dëshironi që t'ju informoj për mëkatet më të mëdha? I thamë: Si jo o i Dërguar i Allahut! Ai tha: Shirku, mosdëgjimi i prindërve, pastaj sikur ishte mbështetur u drejtua dhe tha: Veni re: fjala e rrejshme dhe dëshmia e rrejshme, fjala e rrejshme dhe dëshmia e rrejshme, fjala e rrejshme dhe dëshmia e rrejshme, vazhdmisht e përsëritte derisa menduam se nuk do të hesht.” (Buhariu dhe Muslimi)

Allahu, subhanehu ve teala, thotë: “Largohuni fjalës shpifëse” (Haxh – 13), poashtu thotë: “Edhe ata që nuk dëshmojnë rrejshëm” (Furkan – 72)

Fjalë e rrejshme është për qëllim çdo fjalë përveç të vërtetës, pra çdo gënjeshter apo fjalë e kotë nënkuptohet nga hadithi i lartpërmendur.

Kurtubiu thotë: Dëshmi e rrejshme është dëshmia me të pavërtetë për të arritur deri te gjërat e kota sikur: vrasjen e të pafajshmit, marrjen e pasurisë, lejimin e haramit, ndalimin e hallallit. Nuk ka mëkat më të dëmshëm se sa ajo e as më shkatërruese pas shirkut.

Ibën Dekik El-Id thotë: Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, mund që t'i ketë kushtuar rëndësi ndalimit të dëshmisë së rrejshme për shkak lehtësisë së ndodhies së saj mes njerëzve dhe dëmit të saj sepse muslimani largohet prej shirkut si dhe natyra e shëndoshë nuk pranon mosrespektimin e prindërve kurse dëshmia e rrejshme ka nxitës të shumtë, mu për këtë i është dhënë më tepër rëndësi e jo që ky është mëkat më i madh se sa ato që u përmendën në hadith.

Ai që nuk largohet prej fjalës së kotë nuk ka shpërblim për agjërimin e tij për shkak këtij mëkati, Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, thotë: “Kush nuk e lë fjalën e kotë dhe të punuarit sipas saj dhe injorancën, Allahu nuk ka nevojë që ai të lë hajen dhe pijen.” (Buhariu).

Ahmed Muadh Hakkij

Përktheu: Agim Bekiri

(libri: Katërdhjet hadithe mbi moralin, NuN, Shkup, 2005)